RAPORTI I PARE

paraqitur nga

REPUBLIKA E SHQIPERISE

mbeshtetur ne Nenin 25, paragrafi 1, te

KONVENTES KUADER TE KESHILLIT TE EVROPES PER MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBETARE

2001

Pjesa I

Parathenie

Te dhena te pergjithshme mbi vendin

Pozita gjeografike
Veshtrim i shkurter historik
Popullsia
Organizimi shteteror
Gjendja ekonomike

Te dhena te pergjithshme mbi pakicat kombetare

Politika e shtetit shqiptar ndaj pakicave kombetare
Veshtrim i shkurter historik i pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi
Pakica kombetare greke
Pakica kombetare maqedonase
Pakica kombetare malazeze
Romet
Arumunet

Pjesa II

Neni 1	Neni 9	Neni 17
Neni 2	Neni 10	Neni 18
Neni 3	Neni 11	Neni 19
Neni 4	Neni 12	Neni 20
Neni 5	Neni 13	Neni 21
Neni 6	Neni 14	Neni 22
Neni 7	Neni 15	Neni 23
Neni 8	Neni 16	Neni 30

Aneks Dispozita kryesore te legjislacionit shqiptar per mbrojtjen e te drejtave te pakicave kombetare ne Shqiperi

Bibliografi.

Parathenie

Konventa Kuader e Keshillit te Evropes mbi Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare eshte nenshkruar nga Republika e Shqiperise me 29.06.1995. Ajo eshte ratifikuar nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise me Ligjin 8496, date 3.06.1999 dhe, pas depozitimit te instrumentave te ratifikimit me 28. 09.1999, ka hyre ne fuqi me 01.01 2000.

Ky Raport i Pare eshte hartuar ne perputhje me udhezimet e Komitetit te Ministrave te Keshillit te Evropes dhe ne kuadrin e raporteve te shteteve qe paraqiten ne baze te Nenit 25, paragrafit 1, te Konventes Kuader per Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare.

Pjesa e pare permban nje pershkrim te shkurter gjeografik, historik dhe ekonomik te vendit, te drejtimeve themelore te politikes dhe strategjise se shtetit shqiptar, lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e te drejtave te pakicave kombetare ne Shqiperi, si dhe nje pershkrim te shkurter historik te çeshtjes se pakicave kombetare qe jetojne ne territorin e saj, si: greke, maqedonase, malazeze, si dhe pakicave linguistike te romeve dhe arumuneve.

Pjesa e dyte perqendrohet ne zbatimin e dispozitave te Konventes Kuader te Keshillit te Evropes per Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare nga Republika e Shqiperise dhe eshte hartuar mbeshtetur ne materiale te shkruara, te pergatitura nga Ministria e Drejtesise, Ministria e Arsimit dhe Shkences, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve, Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Instituti i Statistikes (INSTAT), Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si dhe organizata te tjera joqeveritare.

Pjesa I

TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI VENDIN

Pozita gjeografike

Shqiperia ndodhet ne pjesen perendimore te Gadishullit te Ballkanit. Ajo kufizohet nga Mali i Zi dhe Kosova ne Veri, nga ish Republika Jugosllave e Maqedonise ne Verilindje dhe ne Jug nga Greqia. Ne Perendim dhe Jugperendim ajo laget nga deti Adriatik dhe Jon.

Shqiperia ka nje siperfaqe prej 28750 km^2. Gjatesia e pergjithshme e kufirit te saj eshte 1094 km, nga te cilat 316 km jane vije bregdetare, 657 km kufi tokesor, 48 km kufi lumor dhe 73 km kufi ne liqene. Eshte nje vend kryesisht malor, ku dy te tretat e territorit i zene malet dhe kodrat, kurse pjesa tjeter eshte fushe.

Veshtrim i shkurter historik

Paraardhesit e shqiptareve te sotem ishin iliret. Per shekuj me radhe Shqiperia ka njohur pushtimin romak dhe, me vone, ate osman. Shqiperia shpalli pavaresine e saj nga Perandoria Osmane me 28 nentor 1912.

Pas Luftes se Pare Boterore, ne vend u vendos nje republike parlamentare, e cila shpejt u shnderrua ne mbreteri konstitucionale. Mbreti Zog sundoi vendin deri ne vitin 1939, kur Shqiperia u pushtua nga fashistet italiane.

Me çlirimin e vendit nga pushtuesit naziste, ne nentor 1944, Shqiperia, per afro pesedhjete vjet, jetoi nen nje sistem monopartiak, e izoluar dhe ne varferi te plote.

Ndryshimet demokratike ne Evropen Lindore dhe kundershtimi e presioni ne rritje i popullit dhe veçanerisht i studenteve te Universitetit, detyruan qeverine komuniste te lejonte krijimin e partive te pavarura politike, gje qe i dha fund sundimit gjysme shekullor monopartiak.

Pas viteve 90, shqiptaret fituan te drejtat themelore civile e politike dhe vendi, permes nje tranzicioni te gjate dhe te veshtire, po ben hapa te rendesishem drejt krijimit dhe konsolidimit te institucioneve demokratike dhe shtetit ligjor.

Popullsia

Popullsia e Shqiperise eshte 3.182.417 banore (regjistrimi i vitit 1989), me nje dendesi prej 115.8 banore per km^2. Numri i lindjeve eshte 0.97% lindje per 1.000 njerez. Rritja vjetore e popullsise eshte rreth 2%.

Perpara vitit 1990 dy te tretat e popullsise se vendit jetonin ne fshat. Sot ky raport ka ndryshuar, si rezultat i levizjes se lire te njerezve nga fshati drejt zonave urbane ose jashte shtetit.

Nga pikepamja etnike, 98% e popullsise eshte shqiptare dhe vetem 2% perbehet nga pakica kombetare greke, maqedonase dhe malazeze.

Gjuha shqipe eshte nje nga gjuhet indo-evropiane dhe nje nga me te vjetrat ne Evrope.

Ne Shqiperi bashkejetojne ne menyre paqesore dy fe: islamike dhe krishtere, me kater bashkesi fetare kryesore, myslimane, bektashiane, orthodokse dhe katolike.

Organizimi shteteror

Shqiperia eshte republike parlamentare. Republika e Shqiperise eshte shtet unitar. Sistemi i qeverisjes bazohet ne ndarjen dhe balancimin ndermjet pushteteve: ligjvenes, ekzekutiv dhe gjyqesor.

Kuvendi i Shqiperise eshte organi me i larte i pushtetit shteteror dhe legjislativ. Ai ka 140 deputete, te cilet zgjidhen per kater vjet. 100 deputete zgjidhen me votim te drejtperdrejte, ne zona njeemerore, me numer te perafert zgjedhesish. 40 deputete zgjidhen nga listat shumeemerore te partive ose koalicioneve te partive.

Kryetari i shtetit eshte Presidenti, i cili zgjidhet nga Kuvendi per pese vjet.

Keshilli i Ministrave eshte organi me i larte ekzekutiv dhe perbehet nga Kryeministri, zevendeskryeministri dhe ministrat.

Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutes dhe ben interpretimin perfundimtar te saj.

Pushteti gjyqesor ushtrohet nga Gjykata e Larte, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkalles se pare.

Avokati i Popullit (Ombudsmani) mbron te drejtat, lirite dhe interesat e ligjshem te individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administrates publike.

Çdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj perben pjese te sistemit te brendshem juridik. Ajo zbatohet ne menyre te drejtperdrejte, perveç rasteve kur nuk eshte e vetezbatueshme dhe zbatimi i saj kerkon nxjerrjen e nje ligji. Nje

marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te. Gjithashtu normat e nxjerra prej nje organizate nderkombetare kane epersi, ne rast konflikti, mbi te drejten e vendit, kur ne marreveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqiperise per pjesemarrjen ne ate organizate, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtperdrejte i tyre.

Ndarja administrativo-territoriale bazohet ne komunat, bashkite dhe qarqet. Shqiperia ndahet ne 12 qarqe, 65 bashki dhe 309 komuna. Secila komune ose bashki dhe qark ka organet e veta te qeverisjes vendore. Organi ekzekutiv i bashkise ose komunes eshte kryetari, i cili zgjidhet me votim te fshehte, drejtperdrejt nga populli. Po ne kete menyre zgjidhet edhe keshilli, qe eshte organi perfaqesues i njesise se qeverisjes vendore. Perfaqesues i qeverise ne qarqe eshte prefekti.

Gjendja ekonomike

Sistemi ekonomik ne Shqiperi bazohet ne pronen private e publike, si dhe ne ekonomine e tregut dhe lirine e veprimtarise ekonomike. Reformimi i ekonomise se centralizuar ne nje ekonomi tregu ne Shqiperi, si pasoje e konseguencave katastrofale te lena pas nga komunizmi dhe politikave konfliktuale, qe jane ndjekur ne mjaft raste, perben nje proces te zgjatur dhe te veshtire, qe eshte karakterizuar nga luhatje te shumta, te shoqeruara me konflikte sociale.

Ne vitet e fundit, ne Shqiperi, jane bere perpjekje te vazhdueshme e te sukseshme per stabilizimin e treguesve makroekonomike. Pas renies se menjehershme te PBB (Produktit te Brendshem Bruto) gjate vitit 1997 ne nivelet e vitit 1992, u vu re nje rritje me 8% çdo vit gjate periudhes 1998-1999.

Ne vitin 1999 u arrit qe inflacioni te ishte pothuajse zero, e cila eshte vlera me e ulet e inflacionit qe nga viti 1990. Rritja e vazhdueshme e defiçitit buxhetor u arrit te frenohej ne vitin 1999. Pas zhvleresimit te menjehershem te vitit 1997, monedha ka pasur nje tendence vleresimi e qendrueshmerie.

Ndihma e huaj mbetet pjesa kryesore e financimeve per investimet publike. Gjate dy viteve te fundit jane financuar rreth 680 milione dollare, por, per shkaqe qe lidhen me kapacitetin absorbues te ndihmave dhe per dobesi te kontraktoreve te huaj, vetem 50% e tyre jane shpenzuar.

Ndonese Shqiperia eshte nje vend me burime te shumta natyrore, rritja ekonomike, megjithese reale dhe e dukshme, nuk ka arritur te ndryshoje ndjeshem jeten e shqiptareve. Familja shqiptare mbetet e varfer, me te ardhura te pakta dhe me kushte jo te pershtatshme jetese. Vetem nje familje nder pese e konsideron veten te kete burime te mjaftueshme per te jetuar si duhet. Niveli mesatar i deklaruar eshte rreth 17.000 leke ne muaj per familje. Siperfaqja mesatare e banimit eshte rreth 62

m^2 per familje, ose 14.6 m^2 per person dhe mundesite per te blere shtepi jane te kufizuara.

Papunesia, per shkak te levizjes se popullsise fshatare drejt zonave urbane, mungeses se investimeve te medha dhe mjaft faktoreve te tjere, mbetet e larte. Ne kuadrin e programit te mbrojtjes sociale, gjate vitit 1999, jane trajtuar me ndihme ekonomike rreth 140.000 familje. Po kete vit, numri i pensionisteve qe marrin pension pleqerie, arriti ne 260.000 persona me nje vlere pensioni ne rreth 4.000 deri 5.000 leke.

Kushtet e veshtira ekonomike kane detyruar shume shqiptare, duke perfshire edhe nje pjese te rendesishme te elites intelektuale shqiptare, te emigrojne per nje jete me te mire e me te sigurte. Emigracioni ka ndikuar dukshem ne uljen e shkalles se papunesise ne vend, veçanerisht ne pjesen jugore te Shqiperise, ku numri i emigranteve eshte me i madh. Te ardhurat nga emigrantet jane sa rreth 1/5 e PBB-se.

TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI PAKICAT KOMBETARE

Pakicat kombetare ne Shqiperi jane identifikuar nga pikepamja numerike vetem ne rastet e regjistrimeve te pergjithshme te popullsise se te gjithe vendit.

Numri i popullsise se pakicave kombetare krahasuar me popullsine e pergjithshme te vendit

Viti	Numri i popullsise minoritare	Perqindja e tyre ndaj gjithe popullsise se vendit
1960	44.570	2.7%
1979	54.687	2.1%
1989	64.816	2.0%

Burimi: Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, botim i Drejtorise se Statistikes

Informacioni me i fundit zyrtar per madhesine numerike te popullsise se pakicave kombetare ne Shqiperi eshte Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, botuar nga Drejtoria e Statistikes (nga viti 1993 i emeruar Instituti i Statistikes – INSTAT, organ ne vartesi te Keshillit te Ministrave), ku pakicat kombetare, sipas rretheve ku banojne, jane regjistruar si vijon:

Numri i popullsise se pakicave kombetare sipas rretheve:

Gjithsej	Gjirokaster	Sarande	Korçe	Tirane	Rrethe te.tjera
64.816	20.395	36.773	4.706	852	2.090

Burimi: Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, botim i Drejtorise se Statistikes

Shenojme se ne tabelen e mesiperme nuk figuron numri i popullsise rome dhe arumune, per regjistrimin e te cileve, ne vitin 1989, nuk ekzistonte ndonje rubrike e veçante.

Theksojme se me 1 prill 2001, ne Shqiperi filloi regjistrimi i popullsise dhe banesave. Regjistrimi u zhvillua mbi bazen e Kushtetutes se Shqiperise dhe Ligjit Nr. 8669, date 26.10.2000, qe jane akte ligjore, te hartuara me asistencen dhe nen monitorimin e drejtperdrejte te institucioneve nderkombetare respektive. Ai u zhvillua, gjithashtu, mbeshtetur ne elemente te tille, qe i pergjigjen konventave nderkombetare qe Shqiperia ka nenshkruar dhe ratifikuar dhe rekomandimeve te Komisionit Ekonomik Evropian te OKB-se dhe Eurostat per vendet qe realizojne regjistrimin e popullsise dhe banesave per vitin 2000, si dhe kerkesave dhe standarteve me te perparuara dhe me liberale evropiane. Edhe procesi i pergatitjes se strukturave organizative e teknike, eshte bere me asistencen financiare te disa vendeve, si: Italia, Zvicra, Greqia dhe Keshilli i Evropes dhe nen monitorimin e drejteperdrejte te eksperteve te ardhur nga vendet anetare te Bashkimit Evropian.

Ne kete regjistrim, per vete natyren e tij, nuk u perfshi deklarimi i kombesise dhe fese. Procesi i regjistrimit u zhvillua normalisht. Pjesmarrja e pjestareve te pakicave ne regjistrim eshte pozitive. Tani ata jane prezent ne program dhe kjo krijon kushtet qe ne nje te ardhme te afert, te shihet mundesia e plotesimit te ketij regjistrimi edhe me te dhena te tjera, siç eshte kombesia, feja dhe gjuha amtare.

Politika e shtetit shqiptar ndaj pakicave kombetare

Shqiperia u kushton nje vemendje te veçante marredhenieve te mira, tolerances, bashkepunimit, bashkejeteses dhe mirekuptimit te shqiptareve me pakicat kombetare qe jetojne ne territorin e saj. Shoqeria shqiptare, ne historine e saj, si ne te kaluaren, ashtu edhe ne ate te tanishme, nuk ka njohur probleme apo konflikte etnike, racore apo fetare. Ky fakt eshte njohur edhe nga organizmat nderkombetare.

Angazhimet e Shqiperise ne drejtim te mbrojtjes se pakicave kombetare i kane fillesat e tyre pas Luftes se Pare Boterore, me pranimin e saj ne Lidhjen e Kombeve ne dhjetor 1920. Me 2 tetor 1921, Shqiperia beri nje deklarate te posaçme para Keshillit te Lidhjes, me ane te se ciles mori persiper te respektonte

te drejtat e pakicave kombetare brenda territorit te saj ne perputhje me dispozitat e traktateve te paqes te lidhura pas Luftes se Pare.

Edhe mbas Luftes se Dyte Boterore, regjimi komunist, ne funksion te synimeve te veta ideologjike dhe politike per t'u paraqitur si nje mbrojtes shembullor i pakicave kombetare, ka bere nje politike te veçante favorizuese per pakicat kombetare ne Shqiperi e, ne menyre te veçante, per ate greke e maqedonase.

Me ndryshimet demokratike ne Shqiperi, trajtimi i pakicave kombetare mori nje dimension te ri, i cili shprehet qarte ne anetaresimin e Shqiperise ne organizatat nderkombetare, si OSBE, Keshilli i Evropes etj., ne ratifikimin apo aderimin ne pothuaj te gjitha konventat nderkombetare per te drejtat e njeriut dhe, ne menyre te veçante, ne ratifikimin pa asnje rezerve te Konventes Kuader per Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare.

Respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombetare Qeveria shqiptare e konsideron si nje detyrim qe buron nga orientimi themelor i Republikes se Shqiperise per te mbrojtur e respektuar te drejtat dhe lirite themelore te individit. Keto te drejta dhe liri jane sanksionuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni ne fuqi, te hartuara ne perputhje te plote me standartet e njohura nderkombetare. Njekohesisht, Qeveria shqiptare konsideron respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombetare edhe si nje element thelbesor, qe i sherben krijimit te urave te miqesise midis popujve dhe vendeve fqinje, si dhe integrimit te saj te plote ne Evrope. Ne kete kuptim, politika e shtetit shqiptar ngrihet mbi dy boshtet themelore qe percaktojne instrumentat nderkombetare per mbrojtjen e pakicave kombetare:

- garantimin ligjor dhe zbatimin ne praktike te se drejtes per nje trajtim jodiskriminues te personave qe u perkasin pakicave kombetare ne gezimin e plote te te gjitha te drejtave njerezore, si dhe te drejtave civile e lirive politike qe Kushtetuta dhe legjislacioni u njohin te gjithe shtetasve shqiptare;

- garantimin ligjor dhe marrjen e masave konkrete per te mbrojtur dhe respektuar te drejtat e personave qe u perkasin pakicave kombetare, si: e drejta per te shprehur lirisht perkatesine e tyre, per te ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, duke ushtruar lirisht e ne menyre te papenguar ato elemente te veçanta qe karakterizojne jeten e komunitetit te tyre si pakice, mesimin e gjuhes amtare, veprimtarine kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

Kushtetuta e Republikes se Shqiperise e vitit 1998, sanksionon parimet e njohura universale te te drejtave te njeriut dhe "*pluralizmin, identitetin kombetar dhe trashegimine kombetare, bashkejetesen fetare, si dhe bashkejetesen dhe mirekuptimin e shqiptareve me pakicat*" (neni 3), e konsideron si baze te shtetit shqiptar. Ajo i cileson te drejtat dhe lirite themelore te njeriut si "*te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qe qendrojne ne themel te te gjithe rendit juridik*" (neni 15), duke sanksionuar keshtu barazine pa asnje lloj diskriminimi te te gjithe shtetasve qe jetojne ne territorin e Republikes se Shqiperise, shqiptare,

pjestare te pakicave kombetare, te huaj apo persona pa shtetesi, si ne gezimin e te drejtave dhe lirive themelore, ashtu dhe ne zbatimin e detyrimeve qe lindin nga kushtetuta dhe ligje te tjera. Parimet qe lidhen me lirite dhe te drejtat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, te sanksionuara ne aktet e ndryshme nderkombetare, jane bere pjese perberese e tere korpusit kushtetues e ligjor shqiptar.

Kushtetuta e Republikes se Shqiperise i konsideron pakicat kombetare pjese te pandare te shoqerise shqiptare. Ajo u garanton atyre barazi te plote para ligjit ne ushtrimin e lirive dhe te drejtave te tyre dhe u njeh te drejten "*te shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore",* si dhe te drejten *"per t'i ruajtur e zhvilluar ato, te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare, si dhe te bashkohen ne organizata dhe shoqata per mbrojtjen e interesave dhe identitetit te tyre*".

Shteti shqiptar, duke punuar per krijimin dhe konsolidimin e institucioneve te shtetit demokratik, per krijimin e legjislacionit dhe te shtetit ligjor, perpiqet per zbatimin dhe realizimin praktik te te gjitha te drejtave dhe lirive themelore te njeriut ne Shqiperi, perfshire dhe ato te pakicave.

Nje paraqitje me e detajuar e dispozitave kushtetuese, e akteve ligjore dhe nenligjore per te drejtat dhe mbrojtjen e pakicave kombetare, gjendet ne informacionin e dhene sipas neneve te Konventes Kuader, si dhe ne Aneksin 1.

Veshtrim i shkurter historik i pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi

Ne Shqiperi tradita historike ka ecur ne rrugen e njohjes si pakica kombetare te atyre pakicave qe kane nje komb ame, me te cilin kane karakteristika te perbashketa, si: konstitucionin shpirteror, gjuhen, kulturen, zakonet e traditat, besimin fetar etj. Si pakica te tilla jane konsideruar pakica greke, maqedonase dhe malazeze.

Romet dhe arumunet jane njohur dhe respektuar si pakica linguistike.

Pakica kombetare greke

Ne jug te Shqiperise, ne kufi me Greqine, jeton nje popullsi greke, qe perben pakicen kombetare me te madhe ne numer. Sipas te dhenave nga Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, numri i kesaj popullsie eshte 58.758 banore, i shperndare gjeografikisht si me poshte:

Shperndarja gjeografike dhe numri popullsise se pakices kombetare greke krahasuar me popullsine e pergjithshme shqiptare:

Nr.	Rrethet	Pakica Grek	Popullsia e Pergjithshme
1.	Saranda dhe Delvina	36.531	87.768
2.	Gjirokastra	19.921	66.373
3.	Berati dhe Kuçova	49	179.398
4.	Fieri dhe Mallakastra	123	245.062
5.	Gramshi	13	43.565
6.	Kolonja	20	24.781
7.	Korça dhe Devolli	158	215.221
8.	Lushnja	51	134.280
9.	Permeti	442	39.775
10.	Pogradeci	19	71.446
11.	Skrapari	16	46.503
12.	Tepelena	57	49 850
13.	Vlora	202	176.788
14.	Dibra	17	149.650
15.	Elbasani dhe Peqini	131	241 950
16.	Durresi dhe Kavaja	192	245.499
17.	Kruja dhe Laçi	17	106.852
18.	Kukesi dhe Hasi	17	101.302
19.	Lezha	15	62.001
20.	Librazhdi	33	71.982
21.	Mati	22	76.674
22.	Mirdita	16	50.447
23.	Puka	17	48.969
24.	Shkodra dhe Malesia e Madhe	53	236.289
25.	Tirana	610	368.213
26.	Tropoja	16	44.779
	Totali i gjithe Shqiperise	**58.758**	**3.182.417**

Burimi: Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, botim i Drejtorise se Statistikes

Sikurse shihet nga tabela e mesiperme, pjesa dermuese e pakices kombetare greke ne Shqiperi jeton ne rrethet jugore te Sarandes, Delvines dhe Gjirokastres.

Saranda, si rreth, perbehet nga 64 fshatra, prej te cileve 35 banohen kryesisht nga anetare te pakices greke dhe, pjesa tjeter, eshte popullsi shqiptare. Pothuajse ne te gjitha fshatrat, veçanerisht ne ato ku banon pakica greke, kane emigruar per ne Greqi 50-70% e popullsise.

Sipas vezhgimit te realizuar vitin e kaluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, rezulton se, deri ne vitin 1990, ne qytetin e Sarandes, numeroheshin rreth 17 mije banore, prej te cileve rreth 7.500 ishin pjestare te pakices kombetare greke. Aktualisht qyteti ka rreth 30 mije banore. Banoret e ardhur vitet e fundit jane kryesisht nga fshatrat e rretheve Vlore, Gjirokaster, te krahines se Kurveleshit, etj. Arsyet e ardhjes ne Sarande jane thjesht ekonomike. Si qytet bregdetar, Saranda ofron mundesi me te shumta punesimi, sidomos ne fushat e turizmit dhe ne tregti. Sipas ketij vezhgimi, faktikisht, ne kete qytet, pjestaret e kesaj pakice kombetare nuk jane me shume se 3.500 vete. Pjesa tjeter, per arsye ekonomike, ka emigruar ne Greqi.

Ne rrethin e Delvines ka 37 fshatra, nga te cilet 18 fshatra banohen pothuaj krejt nga pakica greke dhe 4 fshatra jane me popullsi te perzier, shqiptare dhe greke. Ne kete rreth, popullsia e pakices kombetare greke eshte rreth 15 mije banore dhe e perqendruar kryesisht ne qytetin e Delvines. Vitet e fundit kane emigruar per ne Greqi me shume se gjysma e popullsise shqiptare dhe rreth 2/3 e popullsise se pakices greke. Vetem ne qytetin e Delvines, krahasuar me vitin 1990, popullsia eshte pergjysmuar, nga 8.000 ne 4.000 banore, ndersa popullsia e pakices greke e qytetit nga 2.000 ne 1990, aktualisht eshte 500 banore. Shumica e personave te larguar i ruajne kontaktet me familjet e tyre.

Ne rrethin e Gjirokastres eshte perqendruar grupi tjeter i madh i pakices kombetare greke ne Shqiperi, i ndare ne zonen e Dropullit te Poshtem dhe ne zonen e Dropullit te Siperm.

E gjithe zona e Dropullit shtrihet menjehere pas qytetit te Gjirokastres, deri ne kufi me Greqine. Pothuajse te 34 fshatrat e kesaj zone banohen teresisht nga pakica greke. Dropulli i Poshtem ka gjithsej 16 fshatra me rreth 8 mije e 100 banore dhe, disa prej tyre, jane: Derviçani, Vanistera, Sofratika, Terihati, Grapshi, Glina etj. Ndersa Dropulli i Siperm ka gjithsej 18 fshatra me rreth 8 mije e 400 banore, nga te cilet mund te permenden Jergucati, Bularati, Sotira, Vriseraja, Kakavija, Koshovica, Agjionikolla etj.

Se fundi permendim se 2 fshatra te tjera, te banuara nga pjestare te pakices kombetare greke, ndodhen ne rrethin e Permetit.

Pakica kombetare greke eshte pakica e pare e njohur nga Shteti shqiptar. Madje mund te thuhet se çeshtja e pakicave kombetare ne Shqiperi ka qene identifikuar per nje kohe te gjate me pakicen kombetare greke. Kjo lidhet me angazhimin qe pati marre Shteti i ri shqiptar pas Luftes se Pare Boterore, per te njohur standartet e percaktuara nga Lidhja e Kombeve lidhur me mbrojtjen e pakicave kombetare. Sipas ketij angazhimi, pakices kombetare greke ne jug te vendit iu njoh e drejta e hapjes se shkollave ne gjuhen greke, te cilat funksiononin si "shkolla private" te financuara nga Qeveria greke.

Situata e pakices kombetare greke gjate periudhes gati gjysmeshekullore te regjimit komunist ka qene objekt diskutimesh dhe komentesh te ndryshme. Megjithate, duhet theksuar se pjestaret e pakices greke kane ndare fatin e shumices se popullsise dhe kane vuajtur te njejtat kufizime te imponuara nga regjimi. Por pjestaret e pakices greke nuk kane qene objekt i nje diskriminimi te posaçem. Ndikim pozitiv ne kete drejtim ka patur atmosfera paqesore dhe tradita e bashkeekzistences normale dhe miqesore qe ka mbizoteruar prej kohesh midis shumices se popullsise dhe pakices greke . Kjo eshte konsideruar si nje arritje e rendesishme e shoqerise shqiptare, qe u ka rezistuar rrethanave te ndryshme.

Ndryshimet demokratike ne Shqiperi gjate dekades se fundit kane sjelle ndryshime thelbesore edhe ne poziten e pakices kombetare greke. Ajo eshte permiresuar dhe sot kjo pakice gezon te gjitha te drejtat, ne perputhje me standartet me liberale evropiane dhe vlerat qe rregullojne jeten e nje shoqerie te hapur demokratike dhe pluraliste.

Mbas viteve 90, numri i pergjitheshem i pakices kombetare greke ne Shqiperi eshte zvogeluar ndjeshem. Per shkak te hapjes se kufijve, prapambetjes dhe veshtiresive te shumta ekonomike te periudhes se tranzicionit ne Shqiperi, veçanerisht nje pjese e mire e popullsise se zonave te jugut te vendit, ka gjetur mundesine te punesohet dhe te jetoje ne Greqi.

Eshte fakt se, nder te tjera, ata favorizohen nga qeveria greke ne dhenien e vizave (deri ne 5 vjet), apo edhe te kartave te qendrimit, ne gjetjen e vendeve te punes, ne shkollimin e femijeve, trajtimin mjekesor, etj. Kjo eshte nje nga arsyet kryesore qe, momentalisht, numri i pakices kombetare greke ne Shqiperi eshte pakesuar ne menyre te ndjeshme. Ne mjaft fshatra me popullsi kryesisht te pakices greke, numri i te emigruarve ne Greqi shkon nga 40-70% te banoreve te fshatit. Sidoqofte, ato ruajne rregullisht dhe pa asnje pengese kontaktet me te afermit e tyre ne Shqiperi dhe here pas here kthehen per te qendruar ne shtepite e tyre per disa dite. Ka mjaft raste qe, me te ardhurat e fituara nga puna ne Greqi, ata ndertojne edhe shtepi te reja banimi per veten e tyre, ndermarrin biznese te vogla, si: ndertimi i hoteleve apo restorantave, veçanerisht ne bregdetin e jugut etj. Pjestaret e pakices greke, pothuajse ne asnje rast, nuk preferojne te shesin shtepite apo pasurite e tjera te paluajteshme qe kane ne Shqiperi.

Nje faktor tjeter qe ka luajtur nje rol pozitiv ne permiresimin e pozites se pakices greke eshte, padyshim, edhe fryma e re, qe karakterizon marredheniet midis Shqiperise dhe Greqise, te cilat jane zhvilluar dhe zgjeruar vazhdimisht.

Pakica kombetare maqedonase

Pakica kombetare maqedonase ndodhet e perqendruar ne zonen e Prespes. Kjo zone eshte e shtrire ne skajin juglindor te Shqiperise, ne kufi me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe Greqine. Siperfaqja e zones se Prespes eshte 213.9

km^2. Popullsia e kesaj zone eshte 4.878 banore, qe do te thote 240 banore per km^2. Vija liqenore e liqenit te Prespes me kufirin shqiptar eshte e gjate 35 km. Gjate kesaj vije shtrihen nente fshatra te zones se Prespes, qe jane: Lajthiza, Pusteci, Zaroshka, Cerja, Shulini, Gollomboqi, Gorica e Vogel, Bezmishti dhe Gorica e Madhe dhe nje fshati ne Devoll. Nga pikepamja administrative, te nente fshatrat ku banon pakica kombetare maqedonase, perbejne nje komune me emrin Komuna e Prespes. Qendra e kesaj Komune eshte fshati Pustec.

Banoret e zones se Prespes merren kryesisht me bujqesi, blegtori e peshkim.

Pas viteve 90, ne zonen e Prespes nuk ka patur levizje te medha te popullsise, siç ka ndodhur me zonat e tjera ku banojne pakicat kombetare ne Shqiperi. Nisur nga afersia me qendrat e banuara maqedonase, mjaft pjestare te kesaj pakice shkojne gjate dites per te punuar atje dhe, ne mbremje, kthehen ne fshatrat e tyre.

Shqiperia ka pasur nje politike te hapur, korrekte dhe miqesore ndaj FYROM, duke qene shteti i pare qe e ka njohur ate, pas shperberjes se ish Jugosllavise. Marredheniet midis dy vendeve kane njohur nje zhvillim te vrullshem, qe shfaqet ne aspektin politik, ekonomik e tregtar.

Pakica kombetare malazeze

Pakica kombetare malazeze eshte e perqendruar kryesisht ne disa fshatra te vegjel ne zonen e Vrakes (fshatrat Gril, Omaraj, Borici i Vogel), ne veri te qytetit te Shkodres (ne Veriperendim te Shqiperise), prane liqenit me te njejtin emer dhe prane kufirit me Malin e Zi. Te dhena statistikore mbi numrin e kesaj pakice ne regjistrimin e vitit 1989 nuk jane te specifikuara dhe te sakta. Gjithesesi, sipas te dhenave nga vezhgimi i bere vitin e kaluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kjo pakice perbehet nga rreth 2000 vete dhe ka ruajtur kompaktesine e vet si pakice kombetare, gjuhen, kulturen, fene, traditat e shtetit ame etj.

Me fillimin e proceseve demokratike ne Shqiperi, ne vitin 1990, pakica malazeze u largua pothuajse plotesisht per ne Malin e Zi. Veshtiresite ekonomike dhe tensionet e krijuara ne ish Jugosllavi i shtyne nje pjese te te larguarve te rikthehen ne shtepite e tyre ne Shqiperi. Sot mund te thuhet se, nga 2 mije te larguar, jane rikthyer ne shtepite e tyre rreth 600 prej tyre. Te tjeret, ose vazhdojne te jetojne ne Mal te Zi (shumica), ose jane larguar ne vende te tjera te Evropes Perendimore, SHBA apo Kanada. Sidoqofte, ne shumicen e rasteve, ata mbajne kontakte te rregullta me familjaret dhe te afermit e tyre dhe vazhdojne t'i ruajne dhe mbajne shtepite dhe pronat e tyre ne Shqiperi.

Romet

Sikurse eshte theksuar edhe me lart, te dhena stastistikore lidhur me numrin e romeve qe jetojne ne Shqiperi, mungojne, pasi nje regjistrim i pergjithshem i tyre nuk eshte bere asnjehere.

Ardhja e romeve ne Shqiperi mendohet se daton rreth shekullit XV me pushtimin otoman. Ngulimet e romeve jane me teper ne Shqiperine e mesme e ate jugore, per shkak te klimes se bute qe kane keto krahina. Ata perbehen nga kater fise kryesore: Kallbuxhinj (Tirane, Elbasan, Pogradec, Korce, Bilisht, Gjirokaster, Sarande); Meçkare (Lushnje, Fier, Vlore); Kurtofet - te shperndare; Cergaret - nomade. Pergjithesisht ato kane familje numerore. Mesatarja e femijeve te lindur eshte 5-6, por ka dhe familje qe kane nga 12 deri ne 17 femije.

Deri ne vitet 1960 romet e Shqiperise benin jete nomade. Sipas stineve, ata shtegtonin nga nje krahine ne tjetren. Kjo menyre jetese krijonte probleme per regjimin ne fuqi, pasi njerzit mund t'i dilnin jashte kontrollit. Per keto arsye, duke filluar nga vitet 1960, autoritetet e kohes filluan t'i perqendronin romet ne ndermarrjet bujqesore, duke i detyruar te futen ne pune, ndersa ne qytete ata u futen kryesisht ne ndermarjet e pastrim gjelberimit ose te sherbimeve komunale.

Me ndryshimet demokratike, shume familje rome kane ardhur nga qytetet dhe rrethet e tjera te Shqiperise dhe jane perqendruar kryesisht ne periferi te qytetit te Tiranes. Tirana, si kryeqendra e Shqiperise, u ofron atyre shanse me te medha, vecanerisht per tregeti, e cila ka qene dhe mbetet angazhimi kryesor i romeve. Ndersa nje pjese mjaft e madhe e romeve ka filluar perseri te beje nje jete nomade. Familje te tera per 6-7 muaj ne vit emigrojne ne Greqi ose ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise.

Ne Shqiperi, romet kane mundur te ruajne gjuhen e tyre tradicionale, te cilen e flasin ne mjedisin e tyre, por e shkruajne ne raste teper te rralla, pasi ne Shqiperi nuk ka patur shkolla rome.

Romet e Shqiperise, ashtu si romet e gjithe botes, merren kryesisht me zejtari, si: nallbane, thuprapunues, rrites kuajsh, kovaçe, karrociere, tregtare ambulante, zbutes kafshesh, muzikante, valltare.

Persa i perket pozites se romeve, mund te thuhet se ata nuk jane objekt i nje trajtimi diskriminues si komunitet me vete. Por, gjithsesi, problemi i romeve eshte problemi i nje komuniteti me nje nivel teper te ulet jetese. Ne nje kuptim, çeshtja e romeve paraqet probleme te njellojta me ato qe shtrohen ne shkalle rajonale.

Arumunet

Midis pakicave, ne Shqiperi jetojne edhe arumunet (te njohur kryesisht si vllehe). Trevat shqiptare, ne hapesira dhe ne kohe te caktuara, kane ndjere popullimin e nomadeve arumune. Ky popullim eshte shfaqur ne forma te ndryshme, si ne

aspektin kohor, ashtu dhe nga menyra e jeteses. Nga aspekti kohor, popullimi i arumuneve vleresohet si popullim i hershem, ndoshta rreth shekullit VI dhe popullim i vonshem, ndoshta fillimi i shekullit te kaluar.

Gjate dy etapave kohore te popullimit, arumunet jane shfaqur si mase nomade blegtorale, e cila, me vone, me stabilizimin gradual, kaloi ne veprimtari te tjera ekonomike, ne bujqesi dhe, neper qytete, ne zejtari.

Popullsia e hershme arumune (vllahe), u stabilizua ne zonat rurale te Myzeqese se Fierit dhe te Vlores, te Frasherit ne Permet, ne Moker te Pogradecit, ne Kolonje etj., si dhe disa qytete, si ne Korçe, Berat, Tirane, Elbasan dhe Durres.

Ne malesine e Voskopojes, popullsia arumune (vllehe) u vendos ne qytetin e Voskopojes, ne fshatin Shipcke etj. Me shkaterimin e qytetit te Voskopojes popullsia arumune u largua dhe u vendos ne Manastir e, pjeserisht, ne qytetet e tjera te Shqiperise.

Popullimi i vendit me arumune te vonshem eshte bere nga popullsia e ardhur nga pllajat malore te Pindit ne Greqi. Kjo dege njihet ne Shqiperi me emrin "kucovllahe" ose "sarakaçane". Kjo popullsi ruajti deri ne vitet 1950, karakterin e saj nomad blegtoral dhe stabilizimi i saj eshte i lidhur me te ashtuquajturin "perfundim i kooperimit socialist te bujqesise" gjate diktatures komuniste ne Shqiperi.

Pas kesaj kohe, levizja e popullsise arumune ne Shqiperi dhe gjithe evolucioni demografik i saj iu nenshtrua ligjesive demografike dhe ekonomiko-sociale, si dhe e gjithe popullsia e vendit, me te cilin ajo u integrua plotesisht.

Per here te pare te dhenat per numrin e pakices arumune ne Shqiperi jepen ne regjistrimin e vitit 1950. Ne kete regjistrim shenohen 2381 banore te popullsise vllahe. Kurse, ne regjistrimin e vitit 1955, numri i popullsise vllehe rezulton ne 4249 banore. Ne regjistrimet e mevonshme nuk rezultojne me te dhena per numrin e arumuneve ne Shqiperi.

Mbas viteve 1990, arumunet (vllehet) jane organizuar ne shoqatat e tyre "Armeni-Alban", "Shoqata e Vllehve Voskopoje" dhe "Aefallofisi". Keto shoqata luajne nje rol te rendesishem ne ruajtjen e gjuhes, kultures dhe traditave te tyre. Ata kane gjithashtu gazeten e tyre "Fratia-Vellazeria", qe del nje here ne muaj, ne gjuhen shqipe dhe arumune.

Arumunet, si nje popullsi e integruar plotesisht ne shoqerine shqiptare, japin kontributin e tyre ne te gjitha sferat e jetes politike, ekonomike, shoqerore e kulturore ne Shqiperi. Shumica e tyre jane vendosur neper qytete dhe, nje pjese e mire e tyre, punon ne vende te rendesishme te administrates shteterore, arsimit, kultures apo ne bizneset e tyre private. Po keshtu, mund te thuhet se edhe pjesa e voneshme e popullsise arumune (kucovllahet dhe sarakaçanet), qe eshte vendosur kryesisht ne vendbanime fshatare, paraqitet ne nje gjendje ekonomike te kenaqeshme. Pjesa dermuese e tyre, e favorizuar nga lehtesite e krijuara nga pala

greke ne dhenien e vizave afatgjata, ka shkuar per te punuar ne Greqi dhe tani, nje pjese e madhe e tyre, kane ndertuar shtepi te reja, kane hapur linja te ndryshme prodhimi ushqimore apo veshmbathjeje dhe, disa here, jane angazhuar edhe ne biznese te rendesishme. Per arsimimin e femijeve te tyre, te dy grupet e arumuneve, kane perfituar, si nga te drejtat e studimit dhe bursat e akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ne Shqiperi, ashtu dhe nga bursat e ofruara nga Rumania dhe Greqia.

Pjesa II

ZBATIMI I DISPOZITAVE TE KONVENTES KUADER PER MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBETARE

Seksioni I

Neni 1

*Mbrojtja e pakicave kombetare dhe e te drejtave dhe lirive te personave qe iu perkasin ketyre pakiceve jane pjese perberese e mbrojtjes nderkombetare te **te drejtave te njeriut**, dhe, si te tilla, **perfshihen ne kuadrin e bashkepunimit nderkombetar.***

Me renien e sistemit te kaluar komunist, Shqiperia ka qene vazhdimisht e angazhuar per t'iu bashkuar familjes se madhe te vendeve europiane dhe gjithe vendeve te tjera te komunitetit nderkombetar, qe respektimin dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe pakicave kombetare e kane vendosur ne themel te sistemeve te tyre shteterore. Ky orientim i qarte i shtetit shqiptar pasqyrohet edhe nga pranimi dhe ratifikimi prej tij i nje numri te madh konventash nderkombetare ne kete fushe.

Shqiperia eshte anetare e OKB-se qe nga 14 dhjetori 1955 dhe ka ratifikuar pothuaj te gjitha konventat kryesore te kesaj organizate lidhur me mbrojtjen e te drejtave te njeriut. Disa nga keto dokumente jane:

- *DeklarataUuniversale e te Drejtave te Njeriut, 1948, (aderuar me 1955);*
- *Konventa Nderkombetare per Eleminimin e te gjitha Formave te Diskriminimit Racial, 1969, (aderuar me 1994);*
- *Pakti Nderkombetar mbi te Drejtat Civile dhe Politike, 1966, (aderuar me 1991);*
- *Pakti Nderkombetar mbi te Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore1976, (aderuar me 1991);*
- *Konventa per Eleminimin e te gjitha Formave te Diskriminimit ndaj Grave, 1980, (aderuar me 1996);*

- *Konventa mbi te drejtat e femijeve 1989, (aderuar me 1992);*
- *Konventa kunder diskriminimit ne arsim, 1960, (aderuar me 1963)* etj.

Shqiperia, gjithashtu, qe nga qershori i vitit 1991, eshte anetare e OSBE-se dhe ka nenshkruar te gjitha dokumentat e saj, si:

- *Aktin Final te Konferences se Helsinkit, 1975;*
- *Deklaraten e Kopenhagenit, 1990;*
- *Karten e Parisit per nje Evrope te re, 1990,*
- *Dokumentin e Konferences se Moskes*, 1991 etj.

Po keshtu, qe nga 13 korriku i vitit 1995, Shqiperia eshte anetare e Keshillit te Evropes, me te cilen ajo ka vendosur nje bashkepunim te ngushte. Ajo ka nenshkruar dhe ratifikuar nje numer te madh dokumentesh te rendesishme te adoptuara nga Keshilli i Evropes, nder te cilat mund te permendim:

- *Konventen per mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore,* 1951, *(ratifikuar me Ligjin 8137, date 31.07.1996)* dhe *Protokollet 1, 2, 4, 6, 7, 11 te kesaj Konvente*,
- *Konventen Kuader per Mbrojtjen e Pakicave Kombetare 1995 (ratifikuar me Ligjin 8496, date 3.06.1999*, pa asnje rezerve);
- *Konventa Europiane per Televizionin Nderkufitar 1999 (ratifikuar me Ligjin Nr.8525, date 9.9.1999);*
- *"Marreveshjen e Pjesshme te Zgjeruar te Qendres Evropiane te Gjuheve Moderne" ne Graz te Austrise (ratifikuar me Ligjin Nr.8706, date 01.12.2000)*, etj.

Kushtetuta shqiptare parashikon nje status te veçante per instrumentat nderkombetare, ne te cilat Republika e Shqiperise eshte pale. Mund te permendim veçanerisht nenet 121 dhe 122 te saj, te cilat parashikojne se çdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj, perben pjese te sistemit te brendshem juridik. Ato zbatohen ne menyre te drejtperdrejte, perveç rasteve kur nuk jane te vetzbatueshme dhe zbatimi i tyre kerkon nxjerrjen e nje ligji. Marreveshjet nderkombetare kane epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me to dhe normat e nxjerra prej nje organizate nderkombetare, kur ne marreveshje parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtperdrejte i tyre, kane epersi ne rast konflikti mbi te drejten e vendit.

Pare ne kete kendveshtrim, me pranimin e dokumentave nderkombetare te siperpermendura, Shqiperia eshte e vendosur dhe e angazhuar per respektimin dhe realizimin e te drejtave njerezore, pa diskriminim, per te gjithe shtetasit shqiptare, perfshi edhe personat qe u perkasin pakicave kombetare.

Duke ju referuar Ligjit Nr 8137, date 31.07.1996, "*Mbi ratifikimin e Konventes per mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore",* ne nenin 5 te ketij ligji Shqiperia njeh *"ne kushtet e reciprocitetit juridiksionin e Gjykates Evropiane per te Drejtat e Njeriut per interpretimin dhe zbatimin e Konventes per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirite Themelore, si dhe te Protokolleve Shtese Nr.1, Nr.4 dhe Nr.7, per rastet kur shkelja e te drejtave te garantuara ne keto dokumente ka ndodhur pasi ato kane hyre ne fuqi per Republiken e Shqiperise".* Ndersa ne nenin 4, te po ketij ligji, Shqiperia njeh "*kompetencen e Komisionit Evropian te te Drejtave te Njeriut per te pranuar peticione nga çdo person, organizate jo qeveritare apo grup personash, qe pretendojne te jene viktima te nje shkelje te te drejtave te garantuara ne Konventen per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe ne Protokollet Shtese Nr.1, Nr.4 dhe Nr.7, per rastet kur shkelja e te drejtave te garantuara ne keto dokumente ka ndodhur pasi ato kane hyre ne fuqi per Republiken e Shqiperise*".

Ne te njejten menyre, ajo eshte e angazhuar edhe per mbrojtjen specifike ndaj pjestareve te pakicave kombetare, sic percaktohet dhe garantohet nga Konventa Kuader per Mbrojtjen e Pakicave Kombetare, duke pranuar, gjithashtu, monitorimin nderkombetar lidhur me plotesimin e detyrimeve te saj ne kete fushe. Ne kete kuader, mund te permendim se qeveria shqiptare ka organizuar 8 vizita ne Shqiperi te Komisionerit te Larte per Pakicat Kombetare te OSBE[se]. Vizita e fundit eshte organizuar ne shkurt te vitit 1999.

Shqiperia, gjithashtu, ka pranuar te drejten e individit per t'u ankuar ne te gjitha shkallet e gjykatave shqiptare, Gjykaten Kushtetuese, ne institucionin e Avokatit te Popullit (Ombudsmani) etj.

Neni 2

Dispozitat e kesaj Konvente Kuader do te zbatohen me vullnet te mire, ne frymen e mirekuptimit dhe tolerances dhe ne perputhje me parimet e ***fqinjesise se mire, marredhenieve miqesore dhe bashkepunimit midis shteteve****.*

Siç eshte permendur edhe ne parathenien e ketij raporti, Shqiperia beson se mbrojtja e pakicave kombetare u sherben jo vetem aspiratave te natyrshme dhe te drejtave te ketyre pakicave, por edhe ndertimit te urave te miqesise midis popujve dhe vendeve fqinje. Nisur nga orientimi i saj strategjik per integrimin euro-atlantik, qeveria shqiptare eshte e vendosur te punoje per vendosjen e besimit, zhvillimin e vazhdueshem te marredhenieve te partneritetit te ngushte me te gjitha shtetet e, ne menyre te veçante, me fqinjet e saj, ne frymen e mirekuptimit dhe

tolerances dhe ne perputhje me parimet e fqinjesise se mire, marredhenieve miqesore dhe bashkepunimit midis shteteve, duke zbatuar dhe respektuar keshtu edhe detyrimet dhe angazhimet e veta, qe burojne nga neni 2 i kesaj Konvente. Ne kete aspekt, Shqiperia ka nenshkruar nje sere marreveshjesh shumepaleshe, qe permenden ne komentet e nenit 1, si dhe traktate te miqesise, bashkepunimit, fqinjesise se mire dhe sigurise apo marreveshje e protokolle bashkepunimi dypaleshe me vendet fqinje ne fushen e arsimit, shkences, bashkepunimit ekonomik, tregtise nderkufitare etj., te cilat indirekt ose drejtpersedrejti, i sherbejne mireqenies se pakicave kombetare qe jetojne ne territorin e saj. Shqiperia luan, gjithashtu, nje rol aktiv dhe jep kontributin e vet ne procesin e stabilizimit, sigurise dhe paqes ne rajon edhe ne kuadrin e nismave rajonale, si Pakti i Stabilitetit per Evropen Juglindore, Procesi i Bashkepunimit te Evropes Juglindore (SEECP) etj.

Neni 3

1. *Çdo person qe i perket nje pakice kombetar do te kete te drejten **te zgjedhe lirisht, nese deshiron qe te trajtohet si i tille ose jo**, dhe nuk do te kete asnje dizavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i te drejtave qe lidhen me kete zgjedhje.*
2. *Personat qe u perkasin pakicave kombetare mund te ushtrojne te drejtat dhe te gezojne lirite qe burojne nga parimet e parashikuara ne kete Konvente Kuader ne menyre **individuale, si dhe se bashku me te tjeret**.*

3. 1. Sipas Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, neni 20, paragrafi i dyte, personat qe u perkasin pakicave kombetare *"kane te drejte te shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesine e tyre etnike*, *kulturore, fetare e gjuhesore*". Mbi kete baze, te gjithe anetaret e pakicave kombetare ne Shqiperi, kane te drejte te zgjedhin lirisht, nese deshirojne, te trajtohen si te tille ose jo.

E drejta per te shprehur lirisht (ose jo) perkatesine e tyre etnike si dhe zgjedhja per t'u trajtuar ose jo si anetar i nje pakice, u njihet te gjithe individeve qe u perkasin pakicave kombetare, pavaresisht nese ata jetojne ne komunitet, ne vendbanimet e tyre tradicionale apo kudo tjeter, ne territorin e Republikes se Shqiperise.

E drejta e çdo individi, qe i perket nje pakice kombetare, per te shprehur lirisht ose jo perkatesine e tij etnike dhe zgjedhja per t'u trajtuar ose jo si anetar i nje pakice, nuk krijon asnje dizavantazh. "*Askush,* thuhet ne paragrafin e dyte te nenit 18 te Kushtetutes, *nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike,*

arsimore, sociale ose perkatesia prinderore". Legjislacioni shqiptar, gjithashtu, ndalon te gjitha politikat dhe praktikat qe do te vinin ne disavantazh pjestaret e pakicave kombetare ne çdo fushe te jetes.

3. 2 Te gjithe personat qe u perkasin pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi, gezojne dhe ushtrojne ne barazi te plote para ligjit dhe pa asnje diskriminim te gjitha te drejtat dhe lirite e garantuara per shtetasit shqiptare, individualisht ose se bashku me te tjeret. Ata kane te drejte te bashkohen ne organizata e shoqata; te zgjidhen apo te zgjedhin perfaqesuesit e tyre ne organet e zgjedhura te pushtetit qendror apo vendor; te drejten per te propozuar ligje, nese perbejne 20 mije zgjedhes; te ushtrojne lirisht ritet e tyre fetare; te mesojne e te mesohen ne shkolla ne gjuhen e tyre amtare, si dhe te drejtat specifike, qe burojne nga parimet e Konventes Kuader per Mbrojtjen e Pakicave Kombetare.

Seksioni II

Neni 4

1 *Palet angazhohen t'iu garantojne personave qe u perkasin pakicave kombetare te drejten e* ***barazise perpara ligjit*** *dhe te mbrojtjes se barabarte nga ligji. Lidhur me kete, ndalohet çdo* ***diskriminim*** *bazuar ne perkatesine ne nje pakice kombetare.*

2 *Palet angazhohen qe te miratojne, kurdohere qe eshte e nevojshme, masa te pershtatshme, me qellim qe te nxisin, ne te gjitha fushat e jetes* ***ekonomike, shoqerore, politike dhe kulturore, barazi te plote dhe efektive*** *midis personave qe i perkasin nje pakice kombetare dhe atyre qe i perkasin shumices. Lidhur me kete, ata do te marrin parasysh ne menyren e duhur kushtet e veçanta te personave qe u perkasin pakicave kombetare.*

3 *Masat e miratuara ne perputhje me paragrafin 2 nuk do te konsiderohen se jane nje akt* ***diskriminimi****.*

4. 1. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise garanton barazine e te gjitheve para ligjit (neni 18, paragrafi 1) dhe ndalon diskriminimin e padrejte per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindja politike, fetare a filozofike, gjendja

ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore (neni 18, paragrafi 2). Mbrojtja e barabarte ligjore ne Shqiperi eshte bazuar ne keto parime. Por ne kete nen, ne paragrafin 3 te tij, parashikohet gjithashtu se "*Askush nuk mund te diskriminohet per shkaqet e permendura ne paragrafin 2, nese nuk ekziston nje perligjje e arsyeshme dhe objektive*". Kjo krijon mundesine per zbatimin e diskriminimit pozitiv per marrjen e masave specifike favorizuese, duke u dhene mundesi te veçanta trajtimi apo perkrahje individeve apo kategorive te caktuara individesh apo grupesh, kur per kete ekziston nje perligjie e arsyeshme dhe objektive.

Po keshtu, persa i perket mbrojtjes se pjestareve te pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi apo denoncimit te akteve diskriminuese ndaj tyre, ekzistojne nje sere dispozitash ligjore. Ne Kodin Penal, ne nenin 265, denohet "*nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe pergatitja, perhapja ose ruajtja me qellim perhapjeje e shkrimeve me permbajtje te tille*", kurse neni 266 denon "*venien ne rrezik te paqes publike, duke bere thirrje per urrejtje kunder pjeseve te popullsise, duke i fyer apo duke shpifur per to, duke kerkuar perdorimin e dhunes ose te veprimeve arbitrare kunder tyre"* etj. Po keshtu, ne nenin 73, denohet krimi i genocidit, ndersa ne nenet 131, 132 denohet shkaterrimi i objekteve te kultit, krijimi i pengesave per organizatat fetare dhe ushtrimin e lire te veprimtarise se tyre. Pika f e nenit 131 te Kushtetutes parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos per gjykimin perfundimtar te ankesave te individeve per shkeljen e te drejtave te tyre kushtetuese, per nje proces te rregullt ligjor, pasi jane shterur te gjitha mjetet juridike per mbrojtjen e ketyre te drejtave.

Garanci tjeter per mbrojtjen e te drejtave te ligjeshme te pjestareve te pakicave kombetare eshte edhe institucioni i Avokatit te Popullit (Ombudsmani - zgjedhur nga Kuvendi ne shkurt te vitit 2000). Sipas ligjit Nr. 8454, date 04.02.1999 "Mbi Avokatin e Popullit", "*Avokati i Popullit mbron te drejtat, lirite dhe interesat e ligjshem te individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administrates publike, si dhe te te treteve qe veprojne per llogari te saj.*

Avokati i Popullit i udhehequr nga parimet e paanesise, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavaresise ushtron veprimtarine ne mbrojtje te te drejtave dhe te lirive te njeriut, te parashikuara ne dispozita kushtetuese dhe ne ligje. Dispozitat e ketij ligji zbatohen edhe per mbrojtjen e te drejtave te te huajve, te cilet jane ose jo rezidente te rregullt ne Shqiperi, te refugjateve, si dhe te personave pa shtetesi qe ndodhen ne territorin e Republikes se Shqiperise, sipas kushteve te parashikuara ne ligj".

Trajtim te barabarte, ne fushen e marredhenieve me administraten publike, pjestareve te pakicave kombetare, u garanton edhe neni 11 i Kodit te Procedurave Administrative, ne paragrafin e tij te pare, ku parashikohet: "*Ne marredheniet me personat private administrata publike udhehiqet nga parimi i barazise, ne*

kuptimin qe askush nuk duhet te privilegjohet apo diskriminohet per shkak te gjinise, races, fese, etnise, gjuhes, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesise prinderore".

Mbrojtje nga aktet diskriminuese ndaj pjestareve te pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi, ekziston edhe ne fushen e punes dhe sigurimeve shoqerore. Keshtu, neni 9 i Kodit te Punes, qe mbulon marredheniet ne fushen e punes, si ne ate publike, ashtu edhe ate ne private, ndalon çdo lloj diskriminimi ne punesim apo ne jeten profesionale. Ndersa legjislacioni per sigurimet shoqerore, sikurse jane sigurimet shendetsore apo sigurimet per te gjitha llojet e pensioneve (invaliditetit apo pleqerise), ofron te drejta te barabarta per te gjithe, pavaresisht nga kombesia apo raca. Per zgjidhjen e shkeljeve ne kete fushe eshte ngritur nje Komision Apeli, vendimet e te cilit jane te detyrueshme.

Kodi Penal shqiptar parashikon, gjithashtu, si krim edhe diskriminimin ne sferen publike. Keshtu, neni 253 i tij, denon me burgim deri ne 5 vjet nje punonjes "*ne funksion shteteror apo ne sherbim publik, kur per shkak te detyres e ne ushtrim te saj, kryen dallime mbi baze origjine, seksi, gjendje shendetesore, bindjeve fetare, politike, te veprimtarise sindikale ose per shkak te perkatesise ne nje etni, komb, race apo fe te caktuar, qe konsiston ne krijimin e privilegjeve te padrejta ose ne refuzimin e nje te drejte ose perfitimi qe buron nga ligji*".

Te drejta te barabarta per te gjithe ofron edhe legjislacioni ne fushen e arsimit. Neni 3 i Ligjit 7952, date 21.06.1995, "Per Sistemin e Arsimit Parauniversitar", "*garanton te drejta te barabarta per te gjithe shtetasit per t'u arsimuar ne te gjitha nivelet e arsimimit qe percaktohen nga ky ligj, pavaresisht nga gjendja sociale, kombesia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shendetsore dhe niveli ekonomik*".

Mbrojtje nga aktet e diskriminimit ndaj pjestareve te pakicave kombetare ofron edhe neni 14 i Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut, e cila eshte ratifikuar nga Shqiperia.

Perveç organit legjislativ dhe organeve te ndryshme ekzekutive, per monitorimin dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut, perfshire edhe ato te pakicave kombetare, tashme ne Shqiperi veprojne edhe nje numer i madh organizatash joqeveritare.

4. 2. Shqiperia, ne kuadrin e perpjekjeve te saj per marrjen e masave te pershtatshme, qe te nxise ne te gjitha fushat e jetes ekonomike, shoqerore, politike dhe kulturore, barazine e plote dhe te efektshme midis personave qe u perkasin pakicave kombetare dhe atyre qe iu perkasin pjeses tjeter te popullsise, po punon per permiresimin dhe plotesimin e legjislacionit te saj, ne perputhje me Kushtetuten e re. Meqenese dispozitat e Konventes se Keshillit te Evropes per Mbrojtjen e Pakicave Kombetare nuk jane drejtperdrejt te zbatueshme, mbi bazen e parimeve te saj, si dhe mbeshtetur ne legjislacionin e brendshem, ne Shqiperi po

behen pergatitjet e nevojshme per amendimet dhe pershtatjet e nevojshme ose per te filluar hartimin e nje ligji te veçante mbi pakicat, i cili do te rregulloje te gjitha raportet dhe marredheniet juridike te pjestareve te pakicave kombetare qe jetojne ne territorin e saj me shtetin dhe pjesen tjeter te popullsise.

Po ne kete kuader, gjate vitit 2000, prane Ministrise se Puneve te Jashtme eshte krijuar Zyra e Pakicave Kombetare, e cila, nder detyrat e saj themelore, duke respektuar ligjet e brendeshme, ka ndjekjen e zbatimit te detyrimeve dhe angazhimeve nderkombetare te vendit ne fushen e te drejtave te personave qe i perkasin pakicave kombetare. Ajo mban dhe zhvillon dialogun zyrtar me komunitetet e pakicave kombetare, organizatat dhe perfaqesuesit e tyre dhe paraqet para Qeverise problemet konkrete dhe ankesat qe ngrihen prej tyre. Zyra, gjithashtu, nxit dhe mbeshtet veprimtarite e tyre te ligjshme, qe synojne ruajtjen dhe zhvillimin e metejshem te identitetit te tyre gjuhesor, kulturor, fetar dhe kombetar, si dhe ndihmon ne krijimin e nje klime te pershtatshme per nje mirekuptim nderetnik gjithnje e me te mire.

Nje Sektor per pakicat kombetare eshte krijuar dhe funksionon, qe nga viti 1998, ne Drejtorine e Prefekturave prane Ministrise se Pushtetit Lokal, qellimi i se ciles eshte trajtimi i problemeve qe lidhen me pjesmarrjen efektive te pakicave ne procesin e vendim-marrjes ne nivelin e qeverisjes vendore dhe administrates publike.

Nje nga inspektoret ne Drejtorine e Arsimit 8-Vjeçar ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences, trajton problemet e shkollimit te femijeve te pjestareve te pakicave kombetare.

Dhe se fundi, nje nga keshilltaret prane Kryeministrit ndjek dhe trajton problemet sociale dhe ato te pakicave kombetare.

Neni 5

1. *Palet angazhohen te nxisin kushtet e nevojshme per personat qe iu perkasin pakicave kombetare per **te ruajtur dhe zhvilluar kulturen** e tyre, si dhe per **te ruajtur elementet themelore te ketij identiteti, konkretisht** besimin fetar, gjuhen, traditat dhe trashegimine kulturore.*
2. *Pa cenuar masat e marra per realizimin e politikes se tyre **te integrimit te pergjithshem**, Palet nuk do te ndermarrin politika apo praktika qe synojne asimilimin e personave qe iu perkasin pakicave kombetare kunder vullnetit te tyre dhe do te mbrojne keta persona nga çdo akt qe synon nje **asimilim** te tille.*

5. 1. Ndryshimet demokratike ne Shqiperi, gjate dekades se fundit, krijuan nje mjedis te favorshem per zhvillimin dhe nismat e sektorit joqeveritar, ne kuadrin e shtetit ligjor. Te gjitha pakicat kombetare qe jetojne ne Shqiperi e kane shfrytezuar kete mundesi per t'i dhene nje impuls te ri ruajtjes dhe zhvillimit te elementeve kryesore te identitetit te tyre: gjuhes, traditave, fese dhe trashegimise se tyre kulturore.

Duhet thene se ne familjet e pjestareve te pakicave kombetare, qofshin keto greke, maqedonase apo malazeze, por edhe ne familjet e pakicave linguistike te romeve dhe arumuneve, gjuha amtare eshte transmetuar nga brezi ne brez. Ndonese sipas Kushtetutes (neni 14), "*gjuha zyrtare ne Shqiperi eshte gjuha shqipe*", pakicat kombetare, sipas nenit 20 te Kushtetutes, kane te drejte te ruajne, te zhvillojne e "*te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare*". E drejta per te perdorur gjuhen amtare privatisht dhe ne publik eshte e garantuar edhe ne praktike. Individet nga pakicat kombetare e perdorin gjuhen e tyre lirisht ne jeten e perditshme, me njeri-tjetrin, ne mbledhjet publike, ne shoqatat e tyre, ne fushatat elektorale, ne shtypin e tyre, ne botimet e tyre me karakter kulturor, letrar, historik apo shkencor, ne media, si dhe ne ceremonite fetare. Nje faktor i rendesishem per ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhes amtare te pakicave jane edhe shkollat e shumta publike apo private qe funksionojne per shkollimin e femijeve te pjestareve te ketyre pakicave.

Edhe romet ne Shqiperi kane mundur te ruajne gjuhen e tyre tradicionale, te cilen e flasin ne mjedisin e tyre. Romet e shkruajne gjuhen e tyre ne raste teper te rralla, pasi ne Shqiperi nuk ka patur shkolla romesh.

Ne kuadrin e perpjekjeve, qe behen sot ne Shqiperi, per integrimin ekonomik e shoqeror te romeve ne shoqerine shqiptare dhe kryesisht per ngritjen e nivelit te tyre arsimor e kulturor, ne Tirane, Shkoder, Korçe, Elbasan, Fier, Gjirokaster e rrethe te tjera, ne lagje qe banohen kryesisht nga familjet rome, jane ndertuar apo ka filluar ndertimi ose rinovimi i shkollave te sistemit kombetar te arsimit ku femijet e tyre mesojne sebashku me femijet shqiptare. Nje kontribut te madh ne kete drejtim, krahas shtetit shqiptar, ka dhene edhe Fondacioni "Soros". Vetem gjate vitit 2000, shkolla ku femijet rome perbejne pjesen me te madhe te nxenesve, filluan nga funksionimi ne Tirane, ne Korçe, ne Gjirokaster dhe se shpejti pritet te filloje edhe nje tjeter ne qytetin e Shkodres. Nje pune e veçante eshte bere ne Gjirokaster ku, ne kuadrin e Programit Hap pas Hapi (Soros), jane krijuar kurse kunder analfabetizmit per te rinjte rome dhe klasa multietnike parashkollore per femije rome dhe shqiptare prej moshes 4 – 6 vjeç. Hap pas Hapi eshte nje metodologji e bazuar ne idene e nje shoqerie te hapur ku mesimi zhvillohet mbi baza individuale ne nje mjedis miqesor femijesh. Nje program tjeter pilot po realizohet nga Soros ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe Shkences ne shkollen "Bajram Curri"ne Tirane.

Gjuhen e tyre tradicionale, te cilen e flasin ne mjediset e tyre, e kane ruajtur edhe arumunet. Ajo eshte ruajtur me shume e me mire veçanerisht ne grupet kompakte, qe jetojne ne fshatra dhe, deri diku, ne brezin e vjeter dhe te mesem te atyre qe jetojne ne qytete. Kurse brezi i ri ne qytete e flet shume pak, per te mos thene aspak, gje qe flet qarte se arumunet kane arritur nje shkalle te caktuar te integrimit te tyre me shumicen vendase, ndonese ende ruajne disa karakteristika te veçanta, qe i kemi permendur edhe me pare, si: traditen, kulturen dhe gjuhen ne familje. Eshte per kete arsye qe populli shqiptar i ka njohur dhe respektuar arumunet si nje pakice linguistike dhe nuk i ka njehsuar me grupet e tjera te pakicave kombetare.

Nje zhvillim te dukshem pas viteve 90 ka marre edhe veprimtaria kulturore e artistike e pjestareve te pakicave kombetare. Ne te gjitha pakicat jane krijuar dhe veprojne aktivisht organizata e shoqata te ndryshme, te cilat luajne nje rol te madh ne njohjen e historise, traditave dhe kultures se ketyre pakicave.

Ne Dropull, ne Prefekturen e Gjirokastres, zhvillon veprimtarine e saj "Shoqata e Krijuesve Minoritare", ku marrin pjese shkrimtare, poete, piktore e artiste te njohur minoritare, te cilet jane te njohur jo vetem ne mjediset minoritare, por ne gjithe Shqiperine e me gjere. Kjo Shoqate ka realizuar shume veprimtari, si ekspozita te piktures, ekspozita fotografike, ekspozita me objekte te kultures materiale popullore etj. Ansambli Folkorik "Dropulli", qe eshte nje nga ansamblet me ne ze ne Shqiperi, merr pjese aktive jo vetem ne jeten kulturore e artistike te vendit, por ajo, me perkrahjen e drejtperdrejte te Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sporteve, Bashkise, Qendres Kulturore dhe sponsoreve te ndryshem private, ka dhene nje numer te madh koncertesh edhe jashte vendit, ku me te spikaturat, padyshim, kane qene ato te dhena ne Greqi.

Shoqata "Druzhba Prespa" ne Komunen e Liqenasit ne Prefekturen e Korçes, drejton dhe organizon veprimtarine e grupeve popullore te fshatrave minoritare maqedonase. Kjo shoqate ka organizuar Festivalin e Liqenasit dhe nje sere turnesh artistike ne Shqiperi dhe ne rrethinat fqinje te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise, ku me kenget, melodite, vallet dhe sidomos me kostumet popullore, kane deshmuar vlerat e tradites popullore dhe ruajtjen e saj.

Ne Komunen e Vrakes, ne Prefekturen e Shkodres, zhvillon veprimtarine e saj shoqata kulturore e pakices malazeze "Moraça Rozafa", e cila ka realizuar nje sere veprimtarish kulturore e artistike, duke mbajtur gjalle kenget, vallet, ritet e veshjet tradicionale te tradites popullore malazeze.

Romet jane te organizuar ne shoqatat e tyre "Amaro - Drom", themeluar ne mars 1991, "Amaro Divas", themeluar me 1996, "Romani Baxt", themeluar me 1991 dhe "Grupi per Zhvillimin e Kultures Rome", themeluar ne fillim te ketij viti.

Shoqata "Amaro-Drom" eshte e perbere nga nje berthame qendrore ne Tirane dhe, sipas informacionit nga zyra e tyre ne Tirane, veprimtarite e tyre mbeshteten nga kater qendra koordinuese, kryesisht ne Fushe Kruje, Lushnje, Fier, Korçe. Me

rendesi eshte te permendim se kjo shoqate ka, gjithashtu, Forumin e Gruas dhe Forumin e Rinise. Shoqata ka gazeten e saj "Ylli i Karvanit" qe del njehere ne muaj. Shoqata luan nje rol te madh ne ruajtjen e gjuhes, folklorit te tyre te pasur dhe artit te muzikes. Ajo ka krijuar nje sere grupesh me instrumentiste, kengetare dhe valltare te talentuar, qe kane marre pjese ne shume veprimtari kombetare dhe nderkombetare. Shoqata "Amaro Drom" ka aktivizuar gjithashtu edhe nje ekip futbolli, i cili ka marre pjese ne disa veprimtari kombetare.

Veprimtari te ngjashme zhvillon edhe shoqata "Amaro Divas". Ajo, gjithashtu, ka grupin e saj artistik dhe ka hapur nje kurs per mesimin e instrumentave muzikore. Edhe kjo shoqate boton revisten e saj mujore, qe mban te njejtin emer sikurse edhe vete shoqata.

Shoqata "Romani Baxt" ka hapur nje kopesht per femijet rome.

Edhe arumunet kane shoqatat e tyre "Armeni-Alban", themeluar ne vitin 1991, "Aefallofisi" dhe "Shoqata e Vllehve Voskopoje", te themeluara me vone. Shoqata "Armeni-Alban" (Arumunet e Shqiperise), ka nje veprimtari te gjere, qe synon te mbaje gjalle gjuhen, kulturen dhe traditat e tyre. Per realizimin e synimeve te tyre, ajo ka organizuar nje sere veprimtarish, nder te cilat mund te permendim: Festivalin e Kenges Arumune, qe u zhvillua ne Voskopoje ne shtator 1996, pjesmarrjen e grupit te saj folklorik ne Festivalin vjetor te Arumuneve te Ballkanit, ne Konstanca te Rumanise, me 1997 dhe 1999 dhe kane organizuar konferenca perkujtimore per ngjarje historike, sikurse eshte 23 maji, etj.

Ndryshimet demokratike gjate dekades se fundit bene te mundur rivendosjen e lirise se ndergjegjes dhe besimit fetar. Ne kete kuader ne vend u rihapen te gjitha objektet fetare te kultit dhe njerezit u lane te lire te praktikojne fene dhe ritet e tyre fetare.

Sot liria e ndergjegjes dhe e fese per minoritaret, ashtu si edhe per te gjithe shtetasit e tjere shqiptare, eshte e garantuar ne nenin 24 te Kushtetutes. Ata jane te lire te marrin pjese ne bashkesite fetare ose ne praktikat e saj, si dhe te bejne publike bindjet dhe besimin e tyre. Ne objektet e tyre te kultit te gjitha sherbesat fetare kryhen ne gjuhen e tyre amtare. (komente me te hollesishme ne nenin 8).

Ne ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit te pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi, krahas faktoreve qe permendem me siper, rol te rendesishem kane luajtur edhe hapja e kufijve, qarkullimi i lire i njerezve dhe zhvillimi i marredhenieve me vendet fqinje, qe perbejne kombet ame, me te cilat pakicat kane karakteristika te perbashketa, si: konstitucionin shpirteror, gjuhen, kulturen, zakonet e traditat, besimin fetar etj. Keto vende kane krijuar mundesi te gjera ne:

- lirine e levizjes pertej kufirit dhe avantazhet qe u jepen pjestareve te pakicave kombetare nepermjet vizave afatgjata per te shkuar ne shtetin ame;
- favorizimet ne shkembimet tregtare;
- mjekimin falas te tyre ne vendet e tyre,

- akordimin e te drejtave te studimit per ne shkollat e mesme e te larta;
- botimin e teksteve shkollore, qe u jepen falas nxenesve, letersise artistike etj.;
- pajisjen me baze materiale mesimore te shkollave te pakicave kombetare dhe ne kualifikimin e mesuesve te tyre falas;
- mbeshtetjen financiare, qe iu jepet per te nxitur sportin dhe veprimtarite kulturore e artistike;
- avantazhet per punesim afatgjate apo sezonal.

5. 2. Sikurse kemi vene ne dukje edhe ne parathenien e ketij Raporti, historikisht shqiptaret jane dalluar per mirekuptim dhe tolerance ndaj pjestareve te pakicave kombetare, gje qe ka ka qene percaktuese ne bashkejetesen shembullore ndermjet tyre dhe komuniteteve fetare. Shqiperia punon qe kjo bashkejetese te ruhet e te zhvillohet me tej. Ajo, nder te tjera, ndjek sot dy drejtime themelore ne politiken e saj:

- Mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave dhe lirive njerezore, si dhe zhvillimin e identitetit te veçante te pakicave,
- Integrimin e tyre te plote ne shoqerine shqiptare.

Nisur nga klima e pergjitheshme e bashkejeteses midis shqiptareve dhe pakicave kombetare dhe drejtimet e saj politike per nje integrim multikulturor, per shtetin shqiptar jane te huaja politikat apo praktikat, qe synojne asimilimin e personave qe iu perkasin pakicave kombetare. Kujdesi qe shteti shqiptar tregon, brenda mundesive modeste ekonomike te vendit, ne drejtim te zhvillimit te identitetit te pakicave kombetare, ne fushen e arsimit, kultures, ushtrimit te besimit fetar, zhvillimit ne te gjitha sferat e jetes ekonomike, shoqerore e politike, etj., vertetojne kete. Ai ka ndjekur gjithashtu nje politike favorizuese ne drejtim te vendosjes se kontakteve midis perfaqesuesve te pakicave dhe institucioneve te vendeve fqinje, qe ndihmojne ne zhvillimin dhe forcimin e identitetit te tyre.

Edhe ne kushtet kur, per shkak te tranzicionit te veshtire ne Shqiperi dhe gjendjes se rende ekonomike, ne mjaft fshatra me popullsi kryesisht minoritare, nje numer i konsiderueshem i tyre eshte larguar per te punuar ne vendet fqinje, jo vetem qe nuk mund te behet fjale per asimilim por perkundrazi per ruajtjen e perkatesise etnike. Te gjithe minoritaret e larguar ruajne pa u penguar dhe rregullisht kontaktet me te afermit e tyre ne Shqiperi dhe, here pas here, kthehen per te qendruar dhe pushuar ne shtepite e tyre. Ne mjaft raste, me te ardhurat e fituara nga puna e tyre ne emigracion, ata ndertojne edhe shtepi te reja banimi per veten e tyre, ndermarrin biznese te vogla, si ndertimi i hoteleve, restorantave, njesive tregtare etj. Pozitive eshte se ata pothuajse ne asnje rast nuk preferojne te shesin shtepite apo pasurite e tjera te paluajtshme qe kane ne Shqiperi.

Sanksionimi juridik dhe administrativ i mbrojtjes se identitetit te pakicave kombetare: fese, gjuhes, traditave dhe trashegimise se tyre kulturore, vertetojne

me se miri se politikat e ndjekura nga shteti shqiptar jane politika te integrimit te pjestareve qe ju perkasin pakicave kombetare ne te gjitha fushat e jetes politike, ekonomike, shoqerore e kulturore dhe jo politika asimilimi.

Neni 6

1. *Palet do te inkurajojne* ***frymen e tolerances dhe dialogut nderkulturor*** *dhe do te marrin masa efektive per te nxitur respektin e ndersjellte, mirekuptimin dhe bashkepunimin midis te gjithe personave qe jetojne ne territorin e tyre, pa dallim per sa i perket identitetit etnik, kulturor, gjuhesor apo fetar te ketyre personave, veçanerisht ne fushen e arsimit, kultures dhe te medias.*
2. *Palet angazhohen qe te marrin masa te pershtatshme per te mbrojtur personat qe mund t'u nenshtrohen kercenimeve apo akteve te* ***diskriminimit, armiqesise apo dhunes,*** *si pasoje e identitetit te tyre etnik, kulturor, gjuhesor apo fetar.*

6. 1. Ne Shqiperi, pergjithesisht, nuk rezultojne raste te intolerances, urrejtjes dhe grindjeve etnike. Perkundrazi, ekziston nje tradite e mire mirekuptimi dhe tolerance midis shumices se popullsise dhe pakicave. Kjo tradite duket ne respektin e ndersjellte, marredheniet e bashkepunimit dhe bashkejetesen paqesore midis tyre, jo vetem ne zonat dhe fshatrat me popullsi etnike te perzier, por edhe ne planin e pergjithshem kombetar. Por mund te thuhet se, ndonese romet ne Shqiperi nuk jane objekt i nje trajtimi diskriminues, si komunitet me vete, raste te shfaqjes se ndonje paragjykimi racist ne drejtim te tyre ka patur.

Shteti, krahas hartimit te legjislacionit dhe perpjekjeve per zbatimin korrekt ne praktike te ketij legjislacioni, per parandalimin e diskriminimit dhe intolerances, ka marre nje sere masash, te cilat synojne nxitjen e respektit te ndersjellte, mirekuptimit dhe bashkepunimit ndermjet te gjithe personave qe jetojne ne Shqiperi.

Ne sistemin arsimor shqiptar jane bere hapa te ndjeshme ne drejtim te edukimit te brezit te ri me ndjenjen e vleresimit te diversitetit kulturor, te vleresimit te kontributit qe pakicat kane dhene per shoqerine shqiptare. Mesimi i te drejtave te njeriut eshte pjese e programit te detyrueshem mesimor te te gjithe shkollave te ciklit te ulet dhe te mesem te ketij sistemi. Ne tekstet mesimore te shkollave, si ne lenden e Edukates, Etikes etj., trajtohen probleme te marredhenieve nderpersonale midis pjestareve te shumices dhe pjestareve te pakicave kombetare, ku nxenesit edukohen me ndjenjat e respektit, miqesise, bashkepunimit dhe ndihmes reciproke.

Ne lendet e Historise, Gjeografise apo Letersise, sipas programit mesimor, mesohet gjeresisht historia, traditat dhe kultura e atyre vendeve qe perbejne kombet ame te pakicave qe jetojne ne Shqiperi. Ne keto tekste behen analiza te gjera e komente per veprat letrare apo historike te autoreve te shquar te letersise dhe kultures se ketyre vendeve.

Ne tekstet e reja per shkollat e pakicave kombetare greke e maqedonase, "Gjuhe e lexim letrar", "Gjuhe shqipe e lexim letrar", te pergatitura e botuara nga Shtepia Botuese e Librit shkollor, ne gjuhet e pakicave dhe ne gjuhen shqipe, jane perfshire pjese te zgjedhura nga folklori i pakices greke dhe maqedonase, nga shkrimtare e poete te ketyre pakicave, si dhe nga shkrimtare e poete te shquar te letersise greke dhe maqedonase te periudhave te ndryshme. Gjithashtu, jane shtuar botimet per lexime jashteshkollore nga letersia e pakicave dhe letersise greke dhe maqedonase.

Ne kuadrin e Procesit te Bashkepunimit te Evropes Juglindore (SEECP), Shqiperia sebashku me vendet e tjera pjesmarrese, eshte e angazhuar te ndermarre nje studim te plote me synim eleminimin e nocionit "*fqinje te keqinj*" nga tekstet e historise se ketyre vendeve.

Nje kontribut te rendesishem japin edhe Biblioteka dhe Qendra e Kultures Greke, te cilat, mbeshtetur ne marreveshjen midis qeverise shqiptare dhe greke, jane hapur e funksionojne ne Tirane. Ato krahas organizimit te veprimtarive te ndryshme, sherbejne si qendra, ku te gjithe personat e interesuar per fusha te ndryshme te jetes ne Greqi, mund te gjejne nje literature mjaft te pasur.

Botime jane bere edhe nga shoqatat arumune, te cilat kane botuar nje guide per bashkebisedim ne gjuhen shqip-arumune, libra me poezi e vjersha te autoreve te tyre ne gjuhen shqipe e arumune ose te perkthyera nga arumanishtja ne shqip etj.

Organizata te ndryshme joqeveritare, Lidhja e Shkrimtareve dhe Artisteve te Shqiperise, Muzeu Kombetar, Galeria e Arteve, kane organizuar here pas here veprimtari te ndryshme me nje pjesmarrje te gjere te personaliteteve me te shquara shqiptare dhe te pakicave nga fushat e letersise, artit, kultures, historise etj., per te perkujtuar ngjarje te rendesishme te jetes se pakicave dhe kombeve ame te tyre, te personaliteteve te tyre te shquara, per te promovuar botime e libra etj.

Ne kete aspekt, Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve organizoi gjate ketij viti ne Tirane Festivalin e Grupeve Folklorike e Popullore te vendeve te Ballkanit, shfaqjet e te cilave u transmetuan drejtperdrejt nga disa kanale televizive private shqiptare. Gjithashtu, ne bashkepunim me agjensine "Karabashi", ne qershor te vitit 2000, u organizua ne Tirane Festivali i Femijve te Pakicave Kombetare, i titulluar "Pellumbi i Bardhe", ku u perfaqesuan me grupet e tyre artistike te femijeve te gjitha pakicat kombetare dhe pakicat linguistike qe jetojne ne Shqiperi. Gjate ketij viti, me mbeshtetjen e drejtperdrejte te kesaj Ministrie, nga vendet fqinje kane ardhur per koncerte edhe mjaft kengetare te muzikes se lehte. Trupa e

Teatrit Kombetar, si dhe trupat teatrale profesioniste, veçanerisht ajo e Korçes dhe Gjirokastres, kane vene ne skene pjese teatrale me autore nga vendet fqinje.

Nje numer projektesh, organizuar ne rrethe te ndryshme te vendit nga Qeveria shqiptare, ne bashkepunim me organizata te ndryshme nderkombetare dhe, ne menyre te veçante, me Fondacionin "Soros", synojne te permiresojne pjesmarrjen dhe integrimin e femijeve te familjeve rome ne shkolle. Keto projekte, qe perfshijne organizimin e tyre ne veprimtari kulturore e sportive, ne te cilat marrin pjese se bashku, si femijet shqiptare, ashtu edhe ata rome, kane kontribuar, gjithashtu, ne promovimin e respektit, e ndjenjave te miqesise dhe bashkepunimit midis tyre.

E kenaqeshme eshte pergjithesisht edhe puna qe kryhet nga media e shkruar dhe elektronike ne drejtim te promovimit te tolerances dhe mosdiskriminimit te pakicave kombetare. Shpesh ato kane sensibilizuar publikun dhe organet perkatese shteterore, duke ndihmuar ne zgjidhjen e problemeve te ndryshme qe kane preokupuar pakicat. Media elektronike ka pergatitur here pas here reportazhe, emisione apo lajme te zgjeruara mbi jeten, veprimtarine dhe problemet e pakicave. Po keshtu, ato kane transmetuar dokumentare mbi natyren, historine, arkeologjine, zhvillimin ekonomik e shoqeror te vendeve fqinje, koncerte te grupeve te tyre folklorike e popullore, te muzikes se lehte etj.

Por, megjithate, ne kete drejtim ka pasur edhe ndonje rast kur media, nisur nga interesa te çastit, nuk ka mbajtur nje qendrim te balancuar dhe te paanshem dhe i ka fryre nxitjes se pasioneve momentale nacionaliste. Ndonjehere ajo nxit edhe stereotipe dhe paragjykime negative ndaj pjestareve te pakicave, sidomos ndaj romeve, te cilet, ndonjehere, konsiderohen prej saj si njerez te prirur ndaj krimeve te vogla ordinere. Sidoqofte, keto qendrime nuk perbejne ndonje fenomen shqetesues dhe fryma e pergjithshme e medias per krijimin e nje mjedisi tolerant dhe bashkejetese paqesore me pakicat kombetare eshte pozitive.

6. 2. Mbrojtja ligjore ne Shqiperi, e garantuar si nga legjislacioni i brendshem, ashtu edhe nga instrumentat nderkombetare te adoptuara, mbron çdo individ nga akte te diskriminimit, armiqesise apo dhunes dhe parashikon sanksione te renda penale per ata qe i kryejne ato.

Ne paragrafin e dyte te nenit 18 te Kushtetutes thuhet: "*Askush, nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore*".

Per te mbrojtur personat qe mund t'u nenshtrohen kercenimeve apo akteve te diskriminimit, armiqesise apo dhunes, si pasoje e identitetit te tyre etnik, kulturor, gjuhesor apo fetar, Kodi Penal i Republikes se Shqiperise, ne pjesen e tij te posaçme, ne nenin 73, parashikon se "*Zbatimi i nje plani te paramenduar qe synon*

shkaterrimin teresisht apo pjeserisht te nje grupi nacional, etnik, racial apo fetar i drejtuar kunder anetareve te grupit dhe i shoqeruar me veprat qe vijojne, si: vrasje me dashje te anetareve te grupit, demtime te renda fizike dhe psikike, vendosja ne kushte jetese te renda qe shkaktojne shkaterrimin fizik, zbatimi i masave qe synojne pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshem i femijeve te nje grupi ne nje grup tjeter,denohet me burgim jo me pak se dhjete vjet ose me burgim te perjetshem a me vdekje". Ndersa neni 74, i ketij Kodi, parashikon se *"Vrasjet, shfarosjet, kthimi ne skllever, internimet dhe debimet, si dhe çdo lloj torture apo dhune tjeter çnjerezore te kryera per motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare, denohen jo me pak se pesembedhjete vjet ose me burgim te perjetshem a me vdekje*". (Shenojme se me nenshkrimin e Protokollit 6, denimi me vdekje eshte hequr nga Shqiperia.)

Çdo individ, i cili eshte viktime e diskriminimit etnik apo racial, qofte ky i hapur apo i fshehte, mund t'i drejtohet gjykates per mbrojtje juridike. Gjithashtu, kushdo ka te drejte te rehabilitohet dhe/ose te zhdemtohet ne perputhje me ligjin, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi ose mosveprimi te paligjshem, te organeve shteterore.

Ne praktiken gjyqesore shqiptare nuk ka ndonje padi te ngritur nga pjestare te pakicave kombetare lidhur me akte diskriminimi, armiqesie apo dhune, per shkak te perkatesise se tyre etnike, kulturore, gjuhesore apo fetare.

Ne kete aspekt, gjithashtu, mund te permendim programet e formimit profesional te punonjesve te rendit publik, per pajisjen e tyre me kulturen e nevojshme ne drejtim te njohjes dhe mbrojtjes se te drejtave te njeriut, perfshire ato te pakicave kombetare. Mesimi i te drejtave te njeriut tashme eshte perfshire ne programet mesimore te Akademise se Rendit ne Tirane. Ndersa per pergatitjen dhe pajisjen me njohurite e nevojshme ne kete aspekt te oficerve dhe punonjesve aktive te policise, ne bashkepunim me Keshillin e Evropes dhe organizma te tjera nderkombetare, jane organizuar dhe vazhdojne te organizohen kurse te shkurtra kualifikimi, nga 15 dite deri ne nje muaj. Ne keto kurse, ku duhet te kalojne te gjithe kuadrot dhe punonjesit e rendit publik, punohet me programe te veçanta per njohjen me standartet nderkombetare te mbrojtjes se te drejtave te njeriut dhe, nje ndihme te veçante ne kete drejtim, po jep edhe MAPE. Nje formim i tille do te ndikoje ne respektimin dhe zbatimin sa me te mire te mbrojtjes nga aktet e diskriminimit etnik apo racial, qe ofron legjislacioni shqiptar. Kohet e fundit, Ministria e Rendit, nen okelion "Policia dhe te Drejtat e Njeriut", ka botuar ne te gjitha gazetat me qarkullim kombetar, pjese nga ligji per Policine, pjese nga Konventa Evropiane per te Drejtat e Njeriut dhe Lirite Themelore, si neni 3 i saj mbi ndalimin e tortures, neni 5 mbi te drejten per liri dhe siguri, pjese nga Protokolli Nr. 6, per heqjen e denimit me vdekje etj.

Neni 7

Palet do te sigurojne respektimin e te drejtes se çdo personi qe i perket nje pakice kombetare per ***lirine e grumbullimeve paqesore, lirine e organizimit, lirine e shprehjes dhe lirine e mendimit, ndergjegjes dhe besimit fetar****.*

Sipas Kushtetutes se Shqiperise, te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne themel te te gjithe rendit juridik (neni 15). Ato vlejne njelloj, jo vetem per pjestaret e pakicave kombetare si shtetas shqiptare, por edhe per te huajt dhe per personat pa shtetesi ne territorin e Republikes se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur ushtrimin e te drejtave e te lirive te caktuara Kushtetuta e lidh ne menyre te pasaçme me shtetesine shqiptare. (neni 16).

Liria e tubimeve paqesore dhe pa arme, si dhe pjesmarrja ne to eshte e garantuar nga Kushtetuta (neni 47). Gjithashtu, ne ligjin Nr.8145, date 11.9.1996, "Per te Drejten e Tubimeve", ne nenin 1, thuhet se: "*Ne Republiken e Shqiperise gjithe shtetasit, pa asnje dallim per shkak te seksit, races, ngjyres, gjuhes, besimit, etnise, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, te bindjeve politike, perkatesise prinderore ose te çdo lloj rrethane tjeter vetjake, kane te drejte per tubime publike*".

Ndersa sipas nenit 46 te Kushtetutes, "*kushdo ka te drejte te organizohet kolektivisht per çfaredo qellimi te ligjshem"*. Ligji Nr.8580, date 17.02.2000, "Per Partite Politike", mbeshtetur mbi kete te drejte kushtetuese te shtetasve, le hapesire edhe per krijimin e partive politike mbi baza etnike. Neni 7 i ketij ligji ndalon regjistrimin e partive ne rastet kur organizimi i tyre i brendshem eshte ne kundershtim me parimet demokratike, kur krijimi i tyre bie ndesh me dispozitat kushtetuese, nxisin dhe perkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, mbeshteten ne metoda totalitariste etj. Nje nder kushtet e tjera te ketij ligji per krijimin e partive politike, eshte qe kerkesa per regjistrim duhet te nenshkruhet nga jo me pak se 500 shtetas shqiptare, anetare themelues te saj me vendbanim te perhershem ne Republiken e Shqiperise. Regjistrimi i partive politike behet ne gjykaten e shkalles se pare te rrethit te Tiranes, e cila mban regjistrin e partive politike.

Pakicat kombetare ne Shqiperi nuk kane partite e tyre politike. Megjitheate, interesat e tyre politike, ekonomike e sociale pergjithesisht mbrohen nga te gjitha partite politike shqiptare, ne te cilat aderojne nje numer i konsiderueshem individesh, qe u perkasin pakicave kombetare ne Shqiperi.

Por nuk mund te leme pa permendur faktin se, me ndryshimet demokratike ne Shqiperi, perfaqesues te pakices kombetare greke, themeluan ne janar te vitit 1991,

ne fshatin Derviçan, organizaten e tyre "Omonia", nje organizate politike-shoqerore, e cila, qe prej ketij viti, vazhdon te zhvilloje veprimtarine e saj.

Ne nenin 3 te statutit te saj thuhet se anetare te organizates mund te jene te gjithe individet qe kane ndergjegje dhe kombesi greke, pa diskriminim seksi, ngjyre, race dhe gjuhe, me perjashtim te atyre qe jane bartes te ideve fashiste, shoviniste dhe racore.

Qellimi i krijimit dhe veprimtarise se saj eshte: mbrojtja e te drejtave te pakices kombetare greke, ne perputhje me aktet dhe marreveshjet nderkombetare per mbrojtjen e te drejtave te pakicave kombetare.

Organizata ka 4 dege ne Sarande, Delvine, Gjirokaster dhe Tirane, dhe disa nendege ne Korçe, Vlore dhe Permet. Ajo drejtohet nga nje Keshill i Pergjithshem, i perbere prej 45 vetesh, i cili zgjidhet nga Konferenca e Pergjithshme, qe mbahet ne çdo dy vjet.

Ne zgjedhjet e para pluraliste qe u mbajten ne Shqiperi me 1991, organizata "Omonia" mori pjese si subjekt elektoral me vete dhe fitoi 5 vende ne parlamentin e pare pluralist shqiptar te perbere prej 250 deputetesh.

Ne zgjedhjet e vitit 1992, mbeshtetur ne ligjin e ri elektoral, sipas te cilit ne zgjedhje mund te merrnin pjese parti, grupime partish dhe individe, dhe ne ligjin e atehershem "Mbi Partite", kjo organizate nuk mundi te paraqitej me si subjekt elektoral. Konflikti i krijuar u zgjidh me miratimin nga Ministria e Drejtesise te Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut, parti e themeluar kryesisht me minoritare greke, por qe perfshin edhe shqiptare, si dhe anetare te pakicave te tjera ne Shqiperi. Kjo parti ne keto zgjedhje fitoi 1 vend ne parlament, i perbere tashme prej vetem 140 deputetesh. Ndersa ne zgjedhjet e majit 1996, kjo parti fitoi 2 vende.

Bashkepunimi i organizates "Omonia" me partine Bashkimi per te Drejtat e Njeriut vazhdon edhe sot. Aktualisht, kjo parti, qe ben pjese ne koalicionin qeveritar, ka 4 deputete nga 155 deputete qe ka aktualisht parlamenti shqiptar, te fituara ne zgjedhjet e fundit te qershorit 1997.

Me Kushtetute, gjithashtu, jane te garantuara liria e shprehjes (neni 22) dhe liria e ndergjegjes dhe e fese (neni 24).

Neni 8

Palet angazhohen te pranojne se çdo person qe i perket nje pakice kombetare ka te drejten te manifestoje ***fene apo besimin e vet*** *dhe* ***te krijoje institucione, organizata dhe shoqata fetare****.*

Ne Shqiperi, historikisht, kane bashkejetuar ne menyren me paqesore dy fe: islamike dhe krishtere, me kater bashkesi fetare kryesore, myslimane, bektashiane, orthodokse dhe katolike. Bashkejetesa paqesore dhe mirekuptimi midis komuniteteve fetare, ne te cilat bejne pjese edhe persona apo komunitete te pakicave kombetare, ne planin individual deshmohet me se miri ne rastet e shumta te martesave midis personave me fe te ndryshme, si dhe ne ndjenjat e respektit dhe ndihmes reciproke qe ata i japin njeri-tjetrit ne raste fatkeqesish, ne mungesen e akteve te dhunes kunder pjestareve te nje besimi ndaj pjestareve te nje besimi tjeter apo ndaj objekteve te kultit. Ne nivelin e funksionareve dhe perfaqesuesve te kultit, bashkejetesa dhe mirekuptimi shfaqet ne mungesen e deklaratave qe mund te nxitin mbivleresimin e nje feje ndaj nje tjetre apo perçmimin e besimtareve te tjere, madje dhe ne vizitat reciproke ne raste festash te natyres fetare.

Shqiperia, gjate 50 vjeteve te diktatures komuniste, ka qene i vetmi vend ne bote qe ndalonte me kushtetute lirine e ndergjegjes dhe te fese, ku nje pjese e mire e kishave dhe xhamive u shkateruan ne menyre barbare. Kjo beri qe edhe besimtareve shqiptare apo minoritare t'u hiqej edhe praktikisht mundesia per te praktikuar besimin e tyre. Vetem pas ndryshimeve demokratike ne vend te gjitha objektet fetare te kultit u rihapen dhe njerezit u lane te lire te praktikojne fene dhe ritet e tyre fetare.

Te dhena statistikore per numrin e sakte te popullsise sipas besimeve fetare nuk ekzistojne, per vete faktin e thjeshte se gjate regjistrimit te fundit zyrtar te popullsise ne vitin 1989, e gjithe popullsia konsiderohej ateiste. Gjithesesi, sipas statistikes me te fundit zyrtare te vitit 1953, popullsia ne Shqiperi perbehet nga muslimane (perfshire edhe komunitetin bektashian) 70%, orthodokse 20% dhe katolike 10%.

Sot liria e ndergjegjes dhe e fese ne Shqiperi, ashtu si per te gjithe shtetasit shqiptare, edhe per pjestaret e pakicave kombetare, eshte e garantuar ne nenin 24 te Kushtetutes. Sipas saj, "*secili eshte i lire te zgjedhe apo te ndryshoje fene ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes se riteve. Te gjithe jane te lire te marrin pjese ne bashkesite fetare ose ne praktikat e saj, si dhe te bejne publike bindjet dhe besimin e tyre*"

Mbi kete baze, sot ne Shqiperi, krahas kater komuniteteve fetare kryesore, veprojne edhe rreth 62 shoqata te krishtere Protestante, Evangjeliste, Adventiste, Bahai, Mormone, te ardhura kryesisht nga Evropa Perendimore dhe SHBA, si dhe shoqata bamirese fetare islamike.

Sikurse kemi permendur ne komentet e bera ne nenin 5, per te praktikuar besimin e tyre, ne te gjitha fshatrat minoritare greke jane rihapur, rinovuar e ndertuar kisha te shumta ortodokse. Biles ka fshatra, si Leshnica, ne kufi me Greqine, ku funksionojne gjashte kisha ortodokse te rinovuara ose te rindertuara. Per ringritjen

dhe funksionimin e kishave, nje ndihme financiare e konsiderueshme eshte dhene nga Greqia dhe nga vete minoritaret.

Po keshtu, edhe ne shumicen e fshatrave minoritare maqedonase, jane rinovuar ose ndertuar kisha ortodokse. Nje kishe e re mjaft e madhe, kisha e Shen Merise, po ndertohet ne qender te Komunes ne Pustec. Per sa me siper, nje ndihme e konsiderueshme eshte dhene dhe jepet nga Kisha ortodokse e ish Republikes Jugosllave te Maqedonise.

Pakica malazeze, me mbeshtetjen financiare qe i eshte dhene nga Mali i Zi dhe Kisha Ortodokse Greke, ka ndertuar tri kisha ortodokse.

Edhe arumunet kane riçelur, rinovuar e ndertuar kishat e tyre. Nje kishe e re mjaft e madhe, po ndertohet ne hyrje te parkut me te madh dhe me te bukur te qytetit te Korçes.

Ne te gjitha kishat minoritare sherbesat dhe ritet fetare zhvillohen ne gjuhen e tyre amtare.

Shenojme se komuniteti orthodoks, ku bejne pjese edhe pjestaret e pakicave kombetare ne Shqiperi, praktikon besimin e vet ne me shume se 350 – 400 kisha nga 320 xhami qe ka sot i gjithe komuniteti musliman, i cili, sikurse permendem me siper, perben rreth 70% te popullsise ne Shqiperi.

Pergatitja e kuadrove fetare orthodokse, dhe te atyre te pakicave, behet ne Shkollen e Mesme dhe Akademine Teologjike ne Tirane. Gjithashtu, nje pjese e madhe e prifterinjeve te pakicave kombetare jane pergatitur ne shkollat teologjike ne Greqi dhe ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe here pas here ata shkojne ne keto vende per te marre pjese ne kurse te ndryshme kualifikimi.

Ne Republiken e Shqiperise, ndonese nuk ka fe zyrtare dhe ne çeshtjet e besimit e te ndergjegjes shteti eshte asnjanes, ai njeh barazine e bashkesive fetare dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike (neni 10 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise). Diskriminimi per shkak te fese apo bindjeve fetare eshte antikushtetues (neni 18 i Kushtetutes, neni 253 i Kodit Penal). Nxitja e urrejtjes dhe grindjeve fetare perben veper penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dhjete vjet (Kodi Penal, neni 265). Gjithashtu, ne Seksionin X te Kodit Penal, ne nenet 131,132 dhe 133, pengimi i veprimtarive te organizatave fetare, shkaterrimi ose demtimi i objekteve te kultit dhe pengimi i ceremonive fetare, parashikohen si vepra penale te denueshme.

Shteti shqiptar, brenda mundesive te tij, krahas fondeve qe i jep nga buxheti i shtetit Institutit te Monumenteve te Kultures per restaurimin dhe mirembajtjen e tyre, jep kontributin e vet nepermjet krijimit te lehtesive doganore e fiskale, kthimit te pronave (aty ku ka qene e mundur) apo nepermjet dhenies falas ose me çmime simbolike te trojeve ne pronesi publike per ndertimin e objekteve fetare te kultit, shkollave, spitaleve, azileve etj. Tani afer, Qeveria shqiptare i ktheu kishes orthodokse dhe komunitetit musliman, trojet per ndertimin e nje kishe orthodokse

dhe nje xhamije ne qender te Tiranes, nderkohe qe po ne qender ka filluar dhe po ndertohet edhe nje kishe katolike.

Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 341, date 07.07.2000, perjashton nga taksat doganore te gjitha "materialet dhe pajisjet per ndertimin dhe rikonstruksionin e objekteve fetare te kultit, te institucioneve me karakter fetar, dhe mallra te tjera, te nevojshme per t'u perdorur nga keto institucione, vetem per zhvillimin e veprimtarive fetare".

Ai, gjithashtu, ka krijuar nje sere lehtesish per lincensimin e shkollave fetare te te gjitha llojeve (Vendim i Keshillit te Ministrave Nr. 248, date 28.05.1999).

Per trajtimin e problemeve qe lidhen me lirine e besimit fetar dhe ushtrimin e tyre, prane Keshillit te Ministrave eshte krijuar dhe vepron Komiteti Shteteror i Kulteve.

Neni 9

1. *Palet angazhohen te njohin se e drejta e lirise se shprehjes se çdo personi qe i perket nje pakice kombetare perfshin* ***lirine per te pasur mendime dhe per te marre dhe shperndare informacion e ide ne gjuhen e pakices****, pa nderhyrjen e autoriteteve publike dhe pavaresisht nga kufijte. Palet do te sigurojne, brenda kuadrit te sistemeve te tyre ligjore, qe personat qe u perkasin nje pakice kombetare te mos diskriminohen lidhur me raportet e tyre me median.*
2. *Paragrafi 1 nuk i ndalon Palet qe te kerkojne, pa diskriminim dhe mbi bazen e kritereve objektive****, qe ndermarrjet e radioperhapjes televizionit apo kinemase t'i nenshtrohen regjimit te liçencave****.*
3. *Palet nuk do te pengojne krijimin dhe perdorimin* ***e medias se shkruar*** *nga personat qe iu perkasin pakicave kombetare. Ne kuadrin ligjor te sistemit te radioperhapjes dhe televizionit, ato do te kujdesen, per aq sa eshte e mundur dhe duke pasur parasysh dispozitat e paragrafit 1, qe personave qe u perkasin pakicave kombetare t'u jepen mundesi per te pasur dhe perdorur* ***median e tyre.***
4. *Ne kuadrin e sistemit te tyre ligjor, Palet do te miratojne masa te pershtatshme per te lehtesuar* ***kontaktet me shtypin dhe mediat*** *per personat qe u perkasin pakicave kombetare dhe per te nxitur tolerancen dhe lejuar* ***pluralizmin kulturor****.*

9. 1. Me qellim ruajtjen dhe forcimin e identitetit kulturor te pakicave kombetare dhe qe ato te jene ne kontakt te vazhdueshem me zhvillimet politike, shoqerore, ekonomike e kulturore dhe, jo vetem me ato brenda vendit, por edhe me ato ne fushen nderkombetare, legjislacioni shqiptar parashikon akses te plote ne gjuhen e tyre amtare, si ne median e shkruar, ashtu edhe ne ate elektronike.

Liria e shprehjes, sikurse parashikohet ne Konventen Kuader, perben nje te drejte themelore kushtetuese ne Shqiperi. Neni 22 i Kushtetutes *garanton lirine e shprehjes dhe lirine shtypit, radios dhe televizionit per te gjithe, perfshire edhe pakicat kombetare dhe ndalon censuren paraprake te mjeteve te komunikimit*.

9. 2. "Ligji per Shtypin" Nr.7756, date 11.10.1993, eshte ndryshuar me Ligjin Nr.8239, date 3.9.1997, dhe aktualisht ka vetem nje nen, ne te cilin thuhet: "*Shtypi eshte i lire. Liria e shtypit mbrohet me ligj*". Nje projekt i ri, i titulluar "Akti i Lirise se Shtypit", eshte botuar keto dite ne shtypin shqiptar, per t'iu nenshtruar nje diskutimi te hapur dhe per te marre konsensusin e nevojshem politik dhe ate profesional. Ne kete kuader, edhe perfaqesuesit e pakicave kombetare do te bejne verejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Mbi bazen e ligjit ekzistues te siperpermendur, anetaret e pakicave kombetare, ashtu sikurse te gjithe shtetasit shqiptare, kane te drejte, pa asnje pengese, te krijojne median e tyre te shkruar ne gjuhen amtare. Shtypi i pakicave kombetare, ashtu si edhe i gjithe shtypi ne Shqiperi, nuk i nenshtrohet censures paraprake.

Aktualisht pakica greke, qe jeton ne rrethet e Gjirokastres, Sarandes, Delvines etj., ka keto revista e gazeta : "Lajko Vima", gazete qe e ka zanafillen e vet qe nga viti 1945; "I Foni tis Omonias" (Zeri i Omonias), e perjavshme; "2000", gazete ne tre gjuhe greqisht, anglisht, shqip; "Oaz" dhe "Progres".revista te ilustruara. Gazetat dhe revistat e permendura me siper shperndahen falas ne çdo fshat. Gjithashtu, ne zonen e kesaj pakice hyjne nga Greqia dhe 15 tituj te tjere gazetash e revistash ne gjuhen greke.

Shtypi maqedonas dhe ai malazez, gjithashtu, vjen pa asnje pengese ne pakicat maqedonase apo ate malazeze ne Shqiperi.

Arumunet kane gazeten e tyre "Fratia- Vellazerimi", e cila del njehere ne muaj ne gjuhen shqipe dhe ate arumune.

9. 3. Akses ne median elektronike, pakicave kombetare u garanton Ligji Nr. 8410, date 30.09.1998 "Mbi Radio Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise". Ligji shpall lirine e veprimtarise se Radio-televizionit dhe pavaresine editoriale te tyre (neni 4 dhe 5). Ne nenin 39 te ketij ligji ndalohet "*transmetimi i programeve qe nxisin dhunen, luften agresive, urrejtjen kombetare dhe raciale"*

etj., ndersa ne nenin 36 kerkon qe "*programet radiotelevizive te respektojne dinjitetin personal dhe te drejtat themelore te njeriut, paaneshmerine, plotesine dhe pluralizmin e informacionit, te drejtat e femijeve dhe te adoleshenteve, rendin publik dhe sigurine kombetare, gjuhen dhe kulturen shqiptare, te drejtat kushtetuese e njerezore te shtetasve, te pakicave kombetare ne perputhje me konventat nderkombetare qe ka nenshkruar Republika e Shqiperise, diversitetin fetar shqiptar"*

Kurse ne nenin 37 thuhet: "*Perdorimi i gjuhes shqipe eshte i detyruar per te gjithe programet, perveç veprave muzikore me tekst ne gjuhe te huaj, emisioneve per mesimin e gjuheve te huaja, emisioneve drejtuar posaçerisht pakicave kombetare dhe programeve te subjekteve radiotelevizive lokale te liçensuara per transmetim ne gjuhen e pakicave*".

Mbi kete baze, hapja e stacioneve lokale radiofonike apo televizive nga pjestaret e pakicave kombetare ne gjuhet e tyre amtare, eshte e garantuar. Liçensimi i tyre behet nga Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit dhe kerkesat per licensim mbeshteten ne ligj, i cili mbeshtetet ne standartet e njohura nderkombetare.

Aplikimi per marrjen e licenses per transmetime radio televizive perfshin: emrin, vendndodhjen, formen ligjore te subjektit qe aplikon, emrat dhe nenshkrimet e personit qe ka te drejte ta paraqise ate, vertetimi zyrtar i bankes per kapitalin financiar te personit juridik apo fizik qe aplikon, emrin e programit dhe te stacionit te transmetimit, objektin dhe karakteristikat e pergjithshme te sherbimit, informacion mbi kohezgjatjen e programit, territori qe do te mbuloje, plani teknik per instalimin dhe perdorimin e pajisjeve, kontraten e nenshkruar me "Shoqaten e Autoreve", lidhur me te drejtat e autorit, si dhe lista e administratoreve, parashikimi i shpenzimeve dhe te ardhurave, origjina dhe shuma e parashikuar per mbulimin e shpenzimeve per kohezgjatjen e licenses. Lincensa mund te mos jepet vetem per rastet e parashikuara ne ligj. Sipas nenit 26, ajo ju "*refuzohet personave qe u eshte hequr zotesia per te vepruar me vendim te formes se prere te gjykates, partive, organizatave politike e fetare dhe autoriteteve shteterore te çdo niveli, enteve publike me karakter ekonomik si dhe institucioneve te kreditit*".

Ne Keshillin Kombetar te Radios dhe Televizionit *nuk ka pasur dhe nuk ka* ndonje kerkese per licensim nga pjestare te pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi per hapjen e stacioneve lokale radiofonike apo televizive.

Sipas nenit 69 te ligjit Nr. 8410, programi i RTSH (Radio Televizioni Shqiptar), midis te tjerash, ne transmetimet e studiove qendrore dhe atyre rajonale, eshte i

detyruar te siguroje dhenien e informacioneve edhe per pakicat kombetare. Ndonese ky detyrim i Radio Televizionit Shqiptar parashikohet shprehimisht, ligji nuk vendos raporte konkrete ne vlera nominale apo ne perqindje lidhur me vellimin dhe kohen qe duhet te zere ne programacionin e saj detyrimi ne dhenien e informacionit per pakicat kombetare. Shenojme se ne Keshillin Drejtues te RTSH, nje nga 15 anetaret e tij, qe, sipas ligjit mbi median elektronike (neni 88), zgjidhen nga Kuvendi, eshte perfaqesues nga pakicat dhe, normalisht, me kete cilesi ai duhet te ndjeke vendosjen e raporteve lidhur me vellimin dhe kohen qe duhet te zere ne programin e RTSH informacioni per pakicat.

Gjithesesi, mund te thuhet se veprimtaria e pakicave ne te gjitha fushat e jetes, arritjet e tyre dhe problemet, kane zene nje vend te rendesishem dhe jane pasqyruar gjeresisht ne programet kryesore te Radiotelevizionit shqiptar, si ne emisionet informative te saj, ashtu edhe ne emisionet e tjera me karakter kulturor, ekonomik e social.

Aktualisht, per pakicen greke ne Shqiperi, perveç emisionit ne gjuhen greke, qe transmetohet 30 minuta dy here ne dite nga Radio Tirana, funksionon edhe Radio Gjirokastra, e cila transmeton çdo dite 45 minuta ne gjuhen greke (nga ora 17 – 17.45).

Gjithashtu, vlen te theksohet se organet e pushtetit vendor, me fondet shteterore, kane vendosur ne territorin e Republikes se Shqiperise perseritesa televizive, nepermjet te cileve minoritaret greke mund te shohin programet e stacioneve televizive greke si NET, ANT1, MEGA, ET1 etj. Shenojme se edhe ne Tirane, me vendim te Keshillit Drejtues te RTSH, nepermjet perseritesit te saj ne malin e Dajtit, mund te shihet lirshem stacioni televiziv grek ET1.

Edhe per pakicen maqedonase, radioja lokale e qytetit te Korces (Radio Korça) transmeton tri here ne jave lajme ne gjuhen maqedonase. Po keshtu, edhe televizioni lokal transmeton emisione te veçanta nga kjo zone. Ndersa stacionet publike dhe private te radios apo televizionit maqedonas shihen lirshem drejtpersedrejti dhe pa nevojen e perseritesave televizive.

E njejta gje mund te thuhet edhe persa i perket pakices se vogel malazeze, lidhur me stacionet publike dhe private te radios apo televizionit te Malit te Zi. Per kete pakice transmeton radioja lokale e qytetit te Shkodres (Radio Shkodra).

Gjate vitit 2000 edhe ne drejtim te jetes, veprimtarise dhe problemeve te pakicave linguistike te romeve dhe arumuneve, nga media e shkruar apo edhe ajo elektronike ka pasur nje mbulim me te gjere dhe sensibilizim me te madh te opinionit publik ne drejtim te tyre. Nje gje e tille eshte arritur ne saje te disa veprimtarive te zhvilluara nga organizatat jo qeveritare e sidomos te seminareve te organizuara me mbeshtetjen e Fondacionit Shoqeria e Hapur Civile (Soros) ne bashkepunim me Ministrine Arsimit dhe Shkences.

Neni 10

1. *Palet angazhohen te njohin qe çdo person qe i perket nje pakice kombetare ka te drejte te* ***perdore lirisht dhe pa pengesa gjuhen e vet te pakices, ne menyre personale dhe publike, me goje dhe me shkrim****.*
2. *Ne zona ku personat qe u perkasin pakicave kombetare banojne tradicionalisht ose ne numer thelbesor, ne qofte se keta persona parashtrojne kerkese dhe kur ajo i pergjigjet nje nevoje reale, Palet do te perpiqen qe te sigurojne, per aq sa eshte e mundur, kushtet qe te mundesojne* ***perdorimin e gjuhes se pakices ne marredheniet midis ketyre personave dhe organeve administrative.***
3. *Palet angazhohen te garantojne te drejten e çdo personi qe i perket nje pakice kombetare* ***per t'u informuar menjehere****, ne nje gjuhe qe ai/ajo e kupton, mbi arsyet e arrestimit te tij/saj, si dhe per natyren dhe shkakun e çdo akuze kunder tij/saj, si dhe* ***per te mbrojtur veten e tij/saj ne kete gjuhe****, dhe ne se eshte e nevojshme, me ndihmen pa pagese te nje perkthyesi.*

10. 1. Ne familjet minoritare, qofshin keto greke, maqedonase apo malazeze, por edhe ne ato te pakicave linguistike te romeve dhe arumuneve, gjuha amtare eshte transmetuar nga brezi ne brez.

Ndonese sipas Kushtetutes (neni 14) gjuha zyrtare ne Shqiperi eshte gjuha shqipe, pakicat kombetare, sipas nenit 20 te Kushtetutes, kane te drejte *"... te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare*". Keshtu, njohja e te drejtes per te perdorur gjuhen amtare privatisht dhe ne publik, me goje dhe me shkrim, eshte e garantuar ne praktike.

Pjestaret e pakicave kombetare e perdorin gjuhen e tyre lirisht ne jeten e perditeshme, me njeri-tjetrin, ne mbledhjet publike, ne shoqatat e tyre, ne fushatat elektorale, ne botimin e dokumentave dhe periodikeve, si dhe ne ceremonite fetare. Ne arsimin parashkollor, ne kopshtet e femijeve, ne zonat minoritare, si ne ato te pakices greke apo maqedonase, femijet, mesohen, komunikojne me njeri-tjetrin dhe me edukatoret e tyre ne gjuhen amtare. Mesimi i gjuheve te tyre eshte, gjithashtu, i garantuar, si ne arsimin 8-vjeçar, ashtu edhe ne ate te mesem, dhe realizohet ne shkollat qe funksionojne ne zonat minoritare apo edhe ne zonat ku banojne nje numer i konsiderueshem minoritaresh. (Shih komentet ne nenin 14).

10. 2. Sikurse permendem ne komentet e paragrafit te pare te ketij neni, sipas Kushtetutes (neni 14) *gjuha zyrtare ne Shqiperi eshte gjuha shqipe*. Keshtu qe i

gjithe dokumentacioni ne organet e pushtetit qendror dhe organet e njesive administrative te pushtetit lokal perpilohet ne gjuhen zyrtare.

Ndersa komunikimi verbal midis pjesetareve te pakicave dhe autoriteteve te administrates se pushtetit lokal ne zonat e banuara prej tyre, duke qene se edhe keto autoritete, ne shumicen dermuese jane minoritare, sipas zgjedhjes se tyre te lire, mund te behet ne gjuhen amtare.

10. 3. Ndonese Shqiperia nuk ka aderuar ne "Karten Evropiane mbi Gjuhet Rajonale ose Minoritare", ajo, mbeshtetur ne parimet e standartet e parashikuara prej saj, ne nenin 28, pika 1 te Kushtetutes, parashikon se kujtdo "*..qe i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen qe i behet*". Ndersa ne nenin 31 te saj, pika c, parashikohet se gjate procesit penal kushdo ka te drejte "*te kete ndihmen pa pagese te nje perkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhen shqipe*".

Keto parime jane pasqyruar edhe ne Kodin e Procedures Penale dhe atij te Procedures Civile.

Kodi i Procedures Penale ne piken 2, te nenit 8, parashikon se ne te gjitha fazat e procedimit gjyqesor "*Persona qe nuk dine shqip perdorin gjuhen e tyre dhe, me anen e perkthyesit, kane te drejte te flasin e te marrin dijeni per provat e aktet, si dhe per zhvillimin e procedimit*". Gjithashtu, ne nenin 98, pika 2, lidhur me perpilimin e akteve te procedures penale, parashikon se "*Personi qe nuk flet gjuhen shqipe pyetet ne gjuhen amtare dhe procesverbali mbahet edhe ne kete gjuhe. Ne te njejten gjuhe perkthehen aktet procedurale, qe i jepen me kerkese te tij*". E drejta per te deponuar ne gjuhen e vet i njihet edhe nje deshmitari ne proces.

E drejta per perdorimin e gjuhes se tyre apo e perpilimit te akteve ne gjuhen e tyre amtare, iu njihet personave qe nuk dine gjuhen shqipe edhe ne procesin gjyqesor civil. Ne nenin 27, paragrafi i dyte, te Kodit te Procedures Civile parashikohet se "*Personat qe nuk dine shqip, perdorin gjuhen e tyre. Ata marrin dijeni per provat dhe per gjithe zhvillimin e gjykimit me ane te perkthyesit*". Ndersa ne nenin 116, ne paragrafin e dyte, thuhet se "*Gjykata, per pyetjen e personave qe nuk dine gjuhen shqipe ose per perkthimin e dokumentave te shkruara ne gjuhe te huaj, therret perkthyesin*".

Per garantimin e te drejtave te personave qe nuk dine gjuhen shqipe, ne procesin gjyqesor penal dhe civil, legjislacioni shqiptar parashikon rregulla te percaktuara hollesisht lidhur me ndihmen falas te perkthyesit, te caktimit te tij edhe ne rastet kur gjykatesi, prokurori ose oficeri i policise gjyqesore njohin gjuhen qe duhet perkthyer, te detyrimeve te perkthyesit per saktesine e perkthimit dhe ruajtjes se sekretit, rastet e pazotesise dhe papajtueshmerise per te kryer detyren, perjashtimit, heqjes dore dhe zevendesimit te perkthyesit, afatet e perkthimeve me shkrim, si dhe sjelljen me detyrim te perkthyesit qe, pa shkaqe te perligjura, nuk paraqitet duke ngarkuar ate me pergjegjesi penale dhe civile, njelloj sikurse edhe ekspertin.

Se fundi, permendim se sipas nenit 5, te Ligjit Nr. 8328, date 16.04.1998, Mbi te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim", "*trajtimi i te denuarve nuk duhet te kete diskriminim per shkak te seksit, kombesise, races, gjendjes ekonomike dhe shoqerore, pikpamjet politike dhe besimeve fetare*". Rregullorja e Burgjeve te Republikes se Shqiperise, miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.96, date 09.03.2000, ne nenet 13, 45, 53 dhe 63, gjithashtu parashikon njoftimin e personave te denuar ne gjuhen qe ata kuptojne mbi rregullat e burgut, menyren e vuajtjes se denimit, te drejtat dhe detyrimet e te burgosurve etj.

Neni 11

1. *Palet angazhohen te njohin se çdo person qe i perket nje pakice kombetare ka te drejten te perdore* ***mbiemrin (atesine) dhe emrat e pare*** *ne gjuhen e pakices, si dhe te drejten per njohjen e tyre zyrtarisht, sipas rregullave te parashikuara ne sistemin e tyre juridik.*
2. *Palet angazhohen te njohin se çdo person qe i perket nje pakice kombetare ka te drejten te ekspozoje ne gjuhen e tij/saj te pakices* ***shenja, mbishkrime dhe informacione*** *te tjera te nje natyre personale ne menyre te dukshme per publikun.*
3. *Ne zonat e banuara tradicionalisht nga nje numer thelbesor personash te nje pakice kombetare, Palet do te perpiqen, ne kuadrin e sistemit te tyre legjislativ, perfshire ketu eventualisht edhe marreveshjet me shtetet e tjera dhe duke marre parasysh kushtet e tyre specifike,* ***te caktojne emertimet tradicionale vendore, emrat e rrugeve dhe tregues te tjere topografike per publikun*** *edhe ne gjuhen e pakices, kur ka nje kerkese te mjaftueshme per keta tregues.*

11.1. Pjestaret e pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi jane te lire te vendosin dhe mbajne emrat dhe mbiemrat e tyre sipas traditave ne gjuhen e tyre dhe gezojne te drejten e njohjes zyrtare te tyre. Regjistrimin e emrave te tyre dhe te anetareve te familjeve te tyre, pjestaret e pakicave kombetare e bejne ne Zyrat e Gjendjeve Civile te Bashkive apo Komunave ku ato jetojne. Sipas ligjit, regjistrimi ne regjistrat e Zyres se Gjendjes Civile behet nga nepunesi i kesaj zyre sipas prononcimit fonetik prej tyre, por gjithmone mbi bazen e ortografise te alfabetit latin, sikurse shkruhet gjuha shqipe, qe eshte njekohesisht edhe gjuha zyrtare ne Shqiperi. Ky rregull zbatohet gjithashtu edhe per faktin se te tre pakicat kombetare, qe jetojne ne territorin e Shqiperise, gjuhet e tyre amtare i shkruajne mbi bazen e ortografise se alfabetit cirilik. Per pasoje, regjistrimi i emrave dhe

mbiemrave te pjestareve te tyre, te mbeshtetur ne ortografine cirilike, do te krijonte probleme te shumta dhe peshtjellim ne marredheniet e tyre me pjesen tjeter te administrates publike dhe institucioneve te tjera te ndryshme ne Shqiperi.

11. 2. Per sa ju perket shenjave te karakterit privat ne jeten private te anetareve te pakicave kombetare, sikurse jane leterkembimi midis tyre, me te afermit e tyre brenda dhe jashte vendit, njoftimet e ndryshme midis tyre, shkrimet mbi pllakat e varrezave, emertimet e njesive te tyre tregetare, mbishkrimeve te dyqaneve apo ndermarrjeve, te shkollave, reklamave dhe etiketave etj., pjestaret e pakicave jane te lire t'i zgjedhin dhe t'i vendosin lirisht, qofte edhe per perdorim publik. Aktualisht, ne te gjitha komunat apo fshatrat ku jetojne pjestaret e pakicave kombetare, por edhe ne qytete te tilla si Delvina, Gjirokastra apo Saranda, qe banohen kryesisht nga pjestaret e pakices kombetare greke ne Shqiperi, nje pjese e mire e emertimeve dhe mbishkrimeve te dyqaneve, restoranteve, bareve apo hoteleve, qe jane ne pronesi te pjestareve te ketyre pakicave, jane te shkruara ne gjuhet e tyre amtare.

11. 3. Te gjitha toponimet dhe emertimet e fshatrave, ne zonat e banuara nga pakicat kombetare ne Shqiperi, ruajne emrat e mirefillta qe minoritaret kane perdorur tradicionalisht ne gjuhen e tyre amtare. Ndonje perpjekje qe eshte bere gjate regjimit komunist ne Shqiperi, per ndryshimin e emrave te disa fshatrave, e veçanerisht te atyre me permbajtje fetare, mbas viteve 90 eshte korrigjuar.

Vendosja dhe perdorimi per publikun i emrave tradicionale vendase, emrave te rrugeve dhe shenjave te tjera topografike, nuk rregullohet me ndonje ligj te veçante. Por, per vendosjen dhe perdorimin e tyre, de facto nuk ka pengesa, qofshin keto edhe ne gjuhen e pakicave. Autoritetet lokale te zonave minoritare, kur e shohin te arsyeshme, apo kur ju kerkohet nje gje e tille, jane te lire te vendosin, duke marre, sigurisht, parasysh kufizimet qe vijne per shkak te rregullave te menaxhimit urbanistik.

Mungesa faktike e tabelave treguese nominative te fshatrave, e paneleve te qarkullimit rrugor, e emrave te rrugeve etj., aktualisht nuk eshte pasoje e ndonje pengese ligjore apo administrative, por rezultat i mungeses se tyre ne pergjithesi edhe ne gjuhen shqipe.

Sidoqofte, nje rregullim i plote ligjor i te gjitha çeshtjeve te trajtuara ne kete nen, i mbetet se ardhmes.

Neni 12

1. *Palet, kur eshte e nevojshme, do te marrin masa ne fushen e* ***arsimit dhe te studimeve,*** *per te nxitur njohjen e* ***kultures, historise, gjuhes dhe besimit fetar*** *te pakicave kombetare te tyre, si dhe te shumices.*
2. *Ne kete kuader, Palet do te krijojne, nder te tjera, mundesi per* ***kualifikimin e mesuesve*** *dhe* ***pajisjen me tekste shkollore*** *dhe do te lehtesojne kontaktet midis nxenesve dhe mesuesve te komuniteteve te ndryshme.*
3. *Palet angazhohen te nxisin* ***mundesi te barabarta per ndjekjen e arsimimit ne te gjitha nivelet*** *per personat qe u perkasin pakicave kombetare.*

12. 1. Ne Shqiperi eshte bere dhe behet kujdes i veçante e i vazhdueshem per arsimimin e pakicave kombetare.

Ky kujdes reflektohet ne arritjet konkrete ne legjislacionin demokratik te shtetit tone dhe veçanerisht ne fushen e arsimit. Institucionet tona demokratike i kushtojne vemendje prioritare mbrojtjes, inkurajimit dhe zhvillimit te njerit prej elementeve baze te identitetit te pakicave kombetare, te drejtave arsimore ne gjuhen amtare.

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise ne nenin 20, ne paragrafet 1 dhe 2, per pakicat kombetare thuhet: "*Personat qe u perkasin pakicave kombetare ushtrojne ne barazi te plote para ligjit te drejtat dhe lirite e tyre. Ata kane te drejte te shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore. Ata kane te drejte t'i ruajne e zhvillojne ato te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare*".

Ne Ligjin "Mbi te drejtat dhe lirite themelore te njeriut", neni 26, thuhet: "*Personat qe u perkasin pakicave kombetare kane te drejte te ushtrojne pa asnje lloj diskriminimi dhe ne barazi para ligjit te drejtat dhe lirite themelore te njeriut. Ata kane te drejte te shprehin, ruajne dhe zhvillojne lirisht identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar, gjuhesor, te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare"*.

Te drejta te barabarta per te gjithe ofron edhe legjislacioni ne fushen e arsimit. Neni 3 i Ligjit Nr.7952, date 21.06.1995, "Per Sistemin e Arsimit Parauniversitar", i cili garanton te drejta te barabarta per te gjithe shtetasit "*per t'u arsimuar ne te gjitha nivelet e arsimimit qe percaktohen nga ky ligj, pavaresisht nga gjendja sociale, kombesia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shendetsore dhe niveli ekonomik*".

Kurse ne nenin 10, pika 1, te po ketij Ligji thuhet: "*Personave qe u perkasin pakicave kombetare u krijohen mundesi te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen*

amtare, te mesojne historine dhe kulturen e tyre brenda kuadrit te planeve dhe programeve mesimore". Kuadri ligjor per kete qellim plotesohet edhe me akte te tjera nenligjore, si me Vendimet e Keshillit te Ministrave "Per Arsimin 8-vjeçar ne Gjuhen Amtare te Personave te Pakicave" dhe "Mbi Fillimin e Mesimit ne Gjuhen Greke ne disa Shkolla te Mesme", si dhe udhezime perkatese te Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Keto dokumente baze te legjislacionit shqiptar, qe, nder te tjera, pasqyrojne garantimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e te drejtave arsimore te pakicave, u jane bere te njohura ne kohen e duhur jo vetem organeve te pushtetit lokal, por edhe drejtorive arsimore te rretheve ku jane pakicat, si edhe drejtuesve e mesuesve te shkollave te te dy pakicave greke e maqedonase, per orientimin e drejte te tyre ne veprimtarine e perditshme arsimore.

Gjithashtu, jane bere dhe behen perpjekje te vazhdueshme per njohjen edhe te dokumentacionit ligjor nderkombetar, konventave e rekomandimeve te posaçme, parimeve dhe standarteve te parashikuara tek "Karta Evropiane mbi Gjuhet Rajonale ose Minoritare", "Koventa Kuader per Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare" etj., te cilat u propaganduan ne seminarin e organizuar nga Keshilli i Ministrave dhe Keshilli i Evropes, ne mars te vitit 1996, ne Tirane.

12. 2. Pakica me kombesi greke shtrihet ne 34 fshatra te rrethit Gjirokaster, 35 fshatra te Sarandes, 18 fshatra te Delvines dhe 2 fshatra ne Permet. Ndersa pakica maqedonase shtrihet ne 9 fshatra te rrethit te Korçes (zona e Prespes) dhe ne nje fshat te Devollit.

Arsimimi i ketyre pakicave kombetare perfshin tre nivele shkollimi, njesoj si edhe per shqiptaret: ai parashkollor, 8-vjeçar dhe te mesem te pergjithshem.

Per pakicen greke: ne rrethin e Gjirokastes jane 18 shkolla 8-vjeçare dhe 14 shkolla vartese te ciklit fillor (klasa I-IV) dhe 2 shkolla te mesme te pergjithshme; ne rrethin e Sarandes jane 17 shkolla 8-vjeçare dhe 4 vartese; ne rrethin e Delvines jane 7 shkolla 8-vjeçare dhe 7 vartese dhe ne rrethin e Permetit vetem 2 shkolla vartese te ciklit fillor (klasa I-IV).

Per pakicen maqedonase: ne rrethin e Korçes jane 2 shkolla 8-vjeçare dhe 7 vartese dhe ne rrethin e Devollit vetem 1 shkolle vartese e ciklit fillor.

Keto shkolla qe permendem me lart funksionojne ne zona qe banohen tradicionalisht nga pakicat kombetare, nderkohe qe me kujdesin e shtetit shqiptar dhe duke u bazuar ne legjislacionin qe kemi permendur me lart, jane hapur qe ne shtatorin e vitit 1996, klasa per femije minoritare, prane shkollave 8-vjeçare me nxenes shqiptare, ne qytetet Gjirokaster, Sarande dhe Delvine, ku ka banore te pakicave kombetare greke, te cilet gezojne te drejten te arsimohen ne gjuhen e

tyre. Ne keto klasa zhvillohet mesimi njelloj si ne te gjitha shkollat e tjera te pakicave kombetare.

Ne qytetin e Gjirokastres, prane Shkolles se Mesme Pedagogjike, eshte dhe dega "Mesuesi per Pakicat", e vetmja e llojit te saj ne vendin tone, ku pergatiten mesues per pakicen greke. Gjithashtu, ne Universitetin "Eqerem Çabej", po ne Gjirokaster, eshte edhe dega e gjuhes greke. Ne vitin 1995, ne Universitetin e Tiranes, ne Fakultetin e Gjuheve te Huaja, eshte hapur dega per gjuhen greke.

Shume bij dhe bija te te dy pakicave, pa asnje dallim dhe me te gjitha te drejtat, ndjekin studimet ne shkollat e mesme dhe universitetet e vendit tone, ne te gjitha deget, si edhe studimet pasuniversitare.

Ne shkollat 8-vjeçare te te dy pakicave, per vitin shkollor 2000-2001, mesojne gjithsej 1845 nxenes, qe perbejne 0,37% te te gjithe nxenesve te arsimit 8-vjeçar dhe japin mesim 297 mesues gjithsej, nga te cilet 267 jane minoritare. Gjithashtu, ne zonen ku jeton pakica kombetare greke dhe ajo maqedonase, funksionojne 35 kopshte me 628 femije. Ne keto kopshte per femijet kujdesen 43 edukatore minoritare. Te dhena te hollesishme per shkollat, mesuesit dhe numrin e mesuesve gjenden ne pasqyrat e detajuara me poshte:

Shkolla te Arsimit 8 Vjeçar (*pakica kombetare greke*)

Rrethi	Shkolla 8-vjeçare I - VIII	Shkolla C. Fillor I - IV	Shkolla te Perziera	Klasa te veçanta	Klasa Kolektive	Numri. i nxenesve	Mesues minoritare	Mesues shqiptare
Gjirokaster	18	14	3	14	62	586	110	9
Sarande	16	7	4	13	56	609	88	9
Delvine	7	9	4	6	41	355	51	12
Permet	-	2	-	-	2	14	2	-
Gjithesej	**41**	**32**	**11**	**33**	**161**	**1564**	**251**	**30**

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkences - Viti shkollor 1999- 2000

Arsimi Parashkollor (*pakica kombetare greke*)

Rrethi	Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Numri i edukatoreve
Gjirokaster	15	213	18
Sarande	6	119	6
Delvine	5	81	7
Permet	-	-	-
Gjithesej	**26**	**413**	**31**

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkences - Viti shkollor 1999- 2000

Shkollat e Arsimit 8 Vjeçar (*pakica kombetare maqedonase*)

Rrethi	Shkolla 8-vjeçare I - VIII	Shkolla C. Fillor I - IV	Klasa te veçanta	Klasa Kolektive	Numri. i nxenesve	Mesues minoritare
Korçe	2	7	15	11	511	42
Devoll	-	1	-	1	11	1
Gjithesej	**2**	**8**	**15**	**12**	**522**	**43**

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkences - Viti shkollor 1999- 2000

Arsimi Parashkollor (*pakica kombetare maqedonase*)

Rrethi	Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Numri i edukatoreve
Korçe	8	202	11
Devoll	1	13	1
Gjithesej	**9**	**215**	**12**

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkences - Viti shkollor 1999- 2000

Shkollat e Arsimit te Mesem (*pakica kombetare greke dhe maqedonase*)

Rrethi	Shkolla te mesme te pergjithshme	Numri. i nxenesve	Mesues minoritare	Mesues shqiptare
Gjirokaster	2	81	110	9
Sarande	2	95	88	9
Delvine	-	-	51	12
Korçe	1	182	2	-
Gjithesej	**5**	**358**	**251**	**30**
Shkolla e mesme Pedagogjike (dega mesuesi – pakica)		**81**	**8**	**2**

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkences - Viti shkollor 1999- 2000

Raporti nxenes-mesues, per te dy pakicat, eshte 6 nxenes per mesues, nderkohe qe ky raport per shkollat shqiptare te arsimit 8 vjecar eshte 19 nxenes per mesues. Ky raport eshte i vogel per shkollat e pakicave per arsye se megjithese ka rene shume numri i nxenesve neper shkolla, per shkak te largimit te tyre ne emigracion, ato jane mbajtur hapur.

Drejtorite arsimore te rretheve ku jane shkollat e pakicave kombetare vazhdimisht

kane synuar ruajtjen e kontigjenteve te nxenesve, me qellim qe te mbahen hapur, siç e thame me lart, te gjitha shkollat e pakices edhe ato qe rezikohen te mbyllen nga renia e theksuar e numrit te nxenesve, ne menyre qe asnje femije minoritar te mos mbetet i pashkolluar. Megjithate, renia vazhdimisht e numrit te nxenesve dhe vijimesia me nje kosto te larte e shkollave te tilla te ciklit fillor, si ne fshatrat Rodat, Vodhino e Hllomo, Dhuvjan, Pepei, apo shkollat 8-vjeçare ne Sotire e Gline, te rrethit te Gjirokastres; Jerme, Italo, Komat, Lefter Talo e Memoraq te Sarandes; Brajlat, Fitore, Dhrovjan e Krane te Delvines e ndonje tjeter, qe frekuentohen vetem me 1, 2, 3 deri 5 nxenes, deshmon tolerancen dhe kujdesin e shtetit shqiptar per mbajtjen hapur te ketyre shkollave, me qellimin e mire, si e theksuam edhe me siper, qe asnje femije minoritar te mos mbetet i paarsimuar. Renia e numrit te femijeve eshte shoqeruar edhe me renien e numrit te mesuesve.

Renia e numrit te nxenesve, si dhe i mesuesve, nga viti ne vit, duket qarte ne krahasimin qe mund t'u behet tabelave bashkengitur ketij materiali, per 5 vitet e fundit shkollore.

12. 3. Ne arsimin e pakicave kombetare ne Shqiperi, me vendosjen e demokracise, jane shenuar arritje te dukshme, konkrete. Se pari, keto arritje pasqyrohen ne strukturen e arsimit te pakicave, ne planet, programet mesimore dhe tekstet e posacme per keto shkolla.

Mes shume akteve ligjore e nenligjore theksojme Vendimin Nr.396, date 22. 08. 1994 te Keshillit te Ministrave "Per Arsimin 8-Vjeçar ne Gjuhen Amtare te Personave te Pakicave", si dhe Udhezimin Nr. 14, date 03.09.1994 te Ministrise se Arsimit, ku, nder te tjera, percaktohen qarte kriteret e hapjes dhe te funksionimit te njesive te shkollimit te personave te pakicave, raportet e perdorimit te gjuhes amtare dhe te gjuhes shqipe, ku ne planin mesimor dhe programet lendore, krijohen mundesi qe nxenesit e pakicave ne keto njesi shkollimi te studiojne historine, traditat dhe kulturen e tyre.

Nxenesit qe u perkasin pakicave greke e maqedonase, krahas arsimimit ne gjuhen zyrtare, mesojne ne shkolle edhe gjuhen amtare, sipas planit mesimor te posaçem per keto shkolla dhe programeve lendore te miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.

Lendet mesimore qe zhvillohen ne gjuhen amtare ne shkollat 8-vjecare te pakicave kombetare jane:

1. Leximi dhe Gjuha Amtare
2. Historia
3. Gjeografia
4. Dituria e Natyres

5. Matematika (ne klasat I - IV)
6. Biologjia
7. Edukata shoqerore
8. Vizatimi
9. Muzika
10. Mesimi i Punes
11. Edukata Fizike

Ndersa ne gjuhen shqipe zhvillohen lendet:

1. Leximi dhe Gjuha Shqipe
2. Historia e Shqiperise
3. Gjeografia e Shqiperise
4. Nga lenda e Edukates Shoqerore, Njohuri mbi Kushtetuten dhe qeverisjen ne Republiken e Shqiperise
5. Nga lenda e muzikes, kenget me karakter kombetar shqiptar
6. Matematika (ne klasat V-VIII)
7. Fizika
8. Kimia

Raportet e zhvillimit te lendeve mesimore ne shkollat 8-vjecare te pakicave kombetare, jane: 40% ne gjuhen shqipe dhe 60% ne gjuhen amtare te pakices, ndersa per ciklin fillor ky raport eshte 90% ne gjuhen amtare dhe 10 % ne gjuhen shqipe.

Gjate viteve te fundit, kujdes i vazhdueshem eshte bere per permiresimin cilesor te programeve dhe teksteve mesimore. Jane hartuar tekstet ne gjuhen amtare greke e maqedonase. Veçanerisht eshte punuar me kujdes ne pergatitjen e teksteve te reja te lendes “Gjuhe e Lexim Letrar" ne gjuhen amtare greke e maqedonase, "Gjuha Shqipe e Leximi Letrar", si dhe te teksteve te tjera ne gjuhen e pakices dhe ne gjuhen shqipe, te posaçme per shkollat e pakicave.

Ne vitin 1998, ne shkollat e pakicave u futen edhe lendet e reja: Njohuri per Historine e Popullit Grek dhe Njohuri per Historine e Popullit Maqedon.

Keto raporte lendore, ne gjuhen amtare te pakices dhe ne gjuhen shqipe, u krijojne

kushte e mundesi nxenesve per te pervetesuar me lehtesi jo vetem programet e tekstet e shkolles 8-vjeçare, por edhe programet mesimore te shkolles se mesme, te cilat zhvillohen te gjitha ne gjuhen shqipe, perveç lendes "Gjuha Greke", ku kjo e fundit zhvillohet 2 ore ne jave, vitin e pare e te dyte te shkollave te mesme te pergjitheshme (ne pjesen e pakices greke) qe nga viti shkollor 1995-1996 e ne vazhdim.

Ne shkollat e te dy pakicave, ne shumicen e lendeve, punohet me programe te reja mesimore dhe programe te permiresuara. Jane botuar tekste te reja ne gjuhen amtare greke dhe ate maqedone. Po keshtu, jane pergatitur te reja edhe tekste ne giuhen shqipe.

Te tjera tekste jane ne proces pergatitjeje dhe botimi.

Me kujdes eshte punuar veçanerisht ne pergatitjen e teksteve te reja per lendet: Lexim dhe gjuhe amtare, Lexim dhe gjuhe shqipe, si dhe te teksteve te tjera ne gjuhen e pakices dhe ne gjuhen shqipe, te posaçme per shkollat e pakices. Tekstet e gjuhes shqipe, leximit dhe leximit letrar jane konceptuar e hartuar posaçerisht per shkollat e pakices. Pra, ato nuk jane te njejta me tekstet e shkolles kombetare.

Vlen te permendim ketu ndihmesen qe kane dhene Greqia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonise, ne botimin e teksteve per shkollat e pakicave, ne kuadrin e bashkepunimit midis ketyre dy vendeve fqinje.

Ne Leximet letrare, jane perfshire pjese te zgjedhura nga folklori i pakices greke dhe maqedonase, nga shkrimtare te ketyre dy pakicave, si dhe nga shkrimtare te letersise greke e maqedonase te periudhave te ndryshme.

Gjithashtu, jane shtuar botimet per lexime jashteshkollore nga letersia e pakicave dhe letersia greke e maqedonase.

Neni 13

1. *Ne kuadrin e sistemit te tyre arsimor, Palet u njohin personave qe u perkasin nje pakice kombetare te drejten e* ***krijimit dhe drejtimit te institucioneve te tyre private per arsimimin dhe kualifikimin****.*
2. *Ushtrimi i kesaj te drejte nuk sjell asnje detyrim financiar per Palet.*

13. 1 Ne Shqiperi, deri me tani, nuk eshte hapur asnje institucion arsimor jo publik (privat) per femije minoritare. Nderkohe qe funksionojne shkolla jopublike te arsimit 8-vjeçar, ne te cilat ka edhe femije te minoritareve. Ne Tirane funksionon Institucioni Arsimor Jopublik "ARSAKEIO". Ky institucion jopublik i

nivelit te arsimit 8-vjeçar, eshte miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 404, date 1.7.1998. Ne kete shkolle, krahas planit mesimor e programeve lendore te detyrueshme ne gjuhen shqipe, zhvillohen edhe lende te tjera ne gjuhen greke si: Gjuhe Greke; Studim Ambjenti/Gjeografi; Edukate Shendetesore; Mitologji - Histori; Loje Teatrale; Tradite Popullore. Keto lende zhvillohen me 9 ore ne jave shtese nga klasa I - IV.

Kjo shkolle nuk eshte vetem per femije te pakices greke, por aty jane regjistruar edhe shume femije shqiptare.

Ky institucion administrohet nga Fondacioni "Filekpedheftiqi", i themeluar qe ne vitin 1836 dhe qe ka si objekt te veprimtarise se tij zhvillimin e arsimit e, ne pergjithesi, edukimin e femijeve e te te rinjve.

Neni 14

1. *Palet angazhohen t'i njohin çdo personi qe i perket nje pakice kombetare* ***te drejten te mesoje gjuhen e vet te pakices****.*
2. *Ne zona ku personat qe u perkasin pakicave kombetare, banojne tradicionalisht apo ne numer thelbesor, ne se ka nje kerkese te mjaftueshme, Palet do te perpiqen te sigurojne, per aq sa eshte e mundur dhe ne kuadrin e sistemit te tyre arsimor, qe personat qe u perkasin ketyre pakicave te kene mundesine* ***te mesojne gjuhen e pakices ose te marrin arsim ne kete gjuhe****.*
3. *Paragrafi i dyte i ketij neni do te zbatohet* ***pa cenuar mesimin e gjuhes zyrtare apo arsimin ne kete gjuhe****.*

14. 1. Drejtorite arsimore te rretheve ku funksionojne edhe shkollat e pakicave kane bere dhe bejne kujdes te vazhdueshem per pajisjen e institucioneve arsimore te pakicave me personel mesimor me arsim perkates e te kualifikuar. Kjo perparesi eshte realizuar ku me shume e ku me pak, brenda mundesive qe ka pasur dhe ka aktualisht çdo rreth, pasi duhet theksuar se shume mesues me arsim te larte, veçanerisht nga keto zona, jane larguar ne emigracion.

Nje kujdes i veçante tregohet ne perzgjedhjen dhe sistemimin e mesuesve qe japin mesimin e gjuhes amtare te pakices, (greke dhe maqedonase) dhe te gjuhes shqipe.

Gjithashtu, kujdes eshte treguar edhe per kualifikimin shkencor e pedagogjik te mesuesve dhe drejtuesve te shkollave te pakicave. Kualifikimi i tyre ka qene nje

nga detyrat paresore te drejtorive arsimore te rretheve ku jane zonat minoritare, por edhe nen kujdesin e Ministrise se Arsimit dhe Institutit te Studimeve Pedagogjike, jane kryer nje sere seminare kualifikuese ne baze zone e rrethi, ku jane perfshire te gjithe mesuesit minoritare te gruprretheve, sipas perkatesise se pakices. Seminaret jane organizuar ne Gjirokaster, Derviçan, Sarande e Delvine per pakicen greke dhe ne Liqenas dhe Gorice e Vogel te zones se Prespes ne rrethin e Korces per pakicen maqedonase.

Dy kane qene drejtimet kryesore te ketyre veprimtarive kualifikuese:

a) Kualifikimi i pergjithshem, unik, mbi bazen e programeve dhe teksteve te shkolles sone kombetare;

b) Kualifikimi specifik per programet e posaçme dhe tekstet perkatese per shkollat e pakicave kombetare.

Kualifikimi i pergjithshem unik, ka synuar dhe synon zbatimin e kurrikules se re, organizimin cilesor te ores se mesimit mbi bazen e modeleve, metodave dhe terminologjive bashkekohore, punen me grupe nxenesish, te mesuarit me objektiva, zhvillimin e mesimit ne klasa kolektive, organizimin e mesimit nepermjet lojes dhe me role, aktivizimin e nxenesve per pune te pavarur etj.

Kualifikimi specifik, nepermjet veprimtarive te shumta teoriko-praktike, ka synuar ne:

- pervetesimin ne sensin praktik aftesiformuese te gjuhes amtare e te gjuhes shqipe;
- pervetesimi i terminologjise shkencore bashkekohore ne tekstet e posaçme per shkollat e pakicave apo ato te lendeve te shkencave natyrore;
- perdorimi i teknikave e teknologjive te reja, i metodave bashkekohore ne shkollat e pakicave per formimin dygjuhesor te nxenesve.

Nje pjese e veprimtarive kualifikuese jane kryer ne bashkepunim me institucionet arsimore homologe te shtetit grek dhe atij maqedonas, si ne rrethet ku ndodhen shkollat e pakicave, ashtu edhe ne vendet fqinje. Mesuesit e te dy pakicave, kane shkuar ne seminare kualifikuese disaditeshe ne universitete te Greqise dhe ato te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise.

Gjithashtu, specialiste dhe pedagoge nga institucione arsimore greke dhe maqedonase kane ardhur ne vendin tone dhe kane bashkepunuar me specialiste, pedagoge dhe mesues shqiptare e minoritare, per organizimin e seminareve kualifikuese. Keshtu, psh., seminare te tilla jane organizuar ne shtator te vitit 1996 ne Derviçan te rrethit te Gjirokastres dhe Sarande; ne mars - prill 1998 prane Universitetit te Janines; ne Liqenas dhe Gorice te Vogel, ne zonen e Prespes te

rrethit te Korces etj.

Ndihmese per organizimin e veprimtarive kualifikuese dhe per pajisjen e shkollave me baze materiale e mesimore kane dhene edhe fondacione, shoqata dhe institucione brenda dhe jashte vendit tone, te cilat jane te interesuara per mbarevajtjen dhe zhvillimin e metejshem te arsimit te pakicave kombetare.

Neni 15

Palet angazhohen te krijojne kushtet e nevojshme per ***pjesemarrjen aktive*** *te personave qe u perkasin pakicave kombetare* ***ne jeten kulturore, shoqerore dhe ekonomike, si dhe ne çeshtjet publike****, veçanerisht ne ato qe kane te bejne me ta.*

Pjesemarrja e personave qe u perkasin pakicave kombetare ne jeten kulturore, shoqerore dhe ekonomike, si dhe ne çeshtjet publike, realizohet nepermjet pjesmarrjes se perfaqesuesve te tyre ne organet legjislative dhe ekzekutive te vendit, si ne ato qendrore, ashtu edhe ne ato vendore.

Pakicat kombetare e, ne menyre te veçante ai grek, nepermjet Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut, ne zgjedhjet e qershorit 1997 fitoi 4 vende ne parlament. Por pakicat kombetare kane edhe 3 vende te tjera ne Parlament te fituara nepermjet pjesmarrjes se tyre ne partite e tjera politike qe veprojne ne Shqiperi, gje qe flet per tendencen ne rritje ne rradhet e minoritareve, per te mos mbetur pakice edhe ne politike dhe me nje rol vetem periferik, por per te marre nje rol me te madh ne kete aspekt.

Pjestaret e pakicave kombetare jane te perfaqesuar edhe ne qeveri dhe disa prej tyre mbajne edhe poste ministrore. Shume te tjere jane vendosur ne poste te rendesishme ne Ministrite apo punojne prej nje kohe mjaft te gjate ne institucione te tjera te rendesishme shteterore. Sidoqofte, te dhena te sakta statistikore per numrin e tyre, funksionet qe mbajne etj., nuk jane te disponueshme.

Pjesmarrja efektive e pjestareve te pakicave kombetare ne procesin e vendim-marrjes, realizohet nepermjet pjesmarrjes se tyre ne organet e pushtetit vendor.

Pjestaret e pakicave kombetare moren pjese normalisht ne zgjedhjet vendore te 1 tetorit 2000, duke kandiduar dhe zgjedhur me voten e tyre te lire perfaqesuesit e tyre. Sipas te dhenave me te fundit nga Ministria e Pushtetit Lokal, rezulton se ne zonat qe banohen nga pjestare te pakicave greke, maqedonase dhe malazeze, jane zgjedhur ne organet e qeverisjes vendore perfaqesuesit e tyre, si me poshte:

Kryetare Komune te Pakices Greke

Ne Rrethin e Sarandes	**3 kryetare komune**
• Komuna Dhiver	kryetar komune
• Komuna Livadhja	kryetar komune
• Komuna Aliko	kryetar komune
Ne Rrethin Delvine	**1 kryetar komune**
• Komuna Mesopotam	kryetar komune

Keshilltare te Pakices Greke

Ne Rrethin e Sarandes	**32 keshilltare**
• Bashkia Sarande	3 keshilltare
• Komuna Xarre	4 keshilltare
• Komuna Dhiver	7 keshilltare
• Komuna Ksamil	12 keshilltare
• Komuna Aliko	7 keshilltare
• Komuna Livadhja	9 keshilltare
Ne Rrethin e Delvines	**16 keshilltare**
• Bashkia Delvine	2 keshilltare
• Komuna Finiq	6 keshilltare
• Komuna Mesopotam	8 keshilltare

Anetare te pakices greke ne Keshillin e Qarkut

Nga Rrethi i Sarandes	**7 anetare**
▪ Nga Bashkia Sarande	1 anetar
▪ Nga Komuna Dhiver	2 anetare
▪ Nga Komuna Livadhja	2 anetare
▪ Nga Komuna Aliko	2 anetare

Nga Rrethi i Delvines	**3 anetare**
▪ Nga Bashkia Delvine	1 anetar
▪ Nga Komuna Mesopotam	2 anetare

Pjestare te pakices kombetare greke te punesuar ne strukturat shteterore te Qarkut kundrejt numrit te pergjithshem te punonjesve te administrates zene:

- ne rrethin e Sarandes 32% te numrit te pergjithshem
- ne rrethin e Delvines 20% te numrit te pergjithshem

Ne organet e qeverisjes vendore ne Gjirokaster jane zgjedhur si me poshte:

<u>Kryetare Komune te Pakices Greke</u>

Ne Rrethin e Gjirokastres	**4 kryetare komune**
• Komuna Dropull i Siperm	kryetar komune
• Komuna Dropull i Poshtem	kryetar komune
• Komuna Pogon	kryetar komune
• Komuna Çarshove	kryetar komune

<u>Kryetare Keshilli Komune te Pakices Greke</u>

Ne Rrethin e Gjirokastres	**5 kryetare keshilli komune**
• Komuna Dropull i Siperm	kryetar keshilli komune
• Komuna Dropull i Poshtem	kryetar keshilli komune
• Komuna Pogon	kryetar keshilli komune
• Komuna Çarshove	kryetar keshilli komune
• Komuna Odrie	kryetar keshilli komune

Anetare te Keshillit te Bashkise /Komunes te Pakices Greke

Ne Rrethin e Gjirokastres	**45 anetare**
• Bashkia Gjirokaster	3 anetare
• Komuna Dropull i Siperm	15 anetare
• Komuna Dropull i Poshtem	15 anetare
• Komuna Pogon	8 anetare
• Komuna Çarshove	4 anetare

Anetare te Pakices Greke ne Keshillin e Qarkut

Nga Rrethin e Gjirokastres	**6 anetare**
• Nga Komuna Dropull i Siperm	2 anetare
▪ Nga Komuna Dropull i Poshtem	2 anetare
▪ Nga Komuna Pogon	1 anetar
▪ Nga Komuna Çarshove	1 anetar

Ne administraten shteterore ne Qark jane 7 pjestare te pakices greke dhe konkretisht :

- Drejtori i Drejtorise Rajonale te Shfrytezimit te Automjeteve

- Drejtori i Drejtorise se Ujrave
- Drejtori i Bankes se Kursimeve
- Drejtori i Ndermarrjes Komunale Banesa
- Rektori i Universitetit
- Drejtori i Drejtorise se Sherbimit Spitalor
- Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrise

Ne administraten shteterore dhe te organeve te qeverisjes vendore ne Gjirokaster, Sarande, Delvine si dhe ne rrethe te tjera, jane te punesuar nje numer i konsiderueshem i pjestareve te pakices greke.

Ne komunen e Liqenasit, ne Qarkun e Korçes, ku jeton e perqendruar pakica maqedonase, te gjithe perfaqesuesit e qeverisjes vendore jane pjestare te kesaj pakice. Kjo pakice ka perfaqesues edhe ne Keshillin e Qarkut Korçe.

Ne çdo komune ku drejtojne pjestare te pakicave, financimi shteteror per mbajtjen e administrates, sigurimet shoqerore dhe grantet, jepen ne perputhje me legjislacionin perkates.

Investimet qe akordon Ministria e Pushtetit Lokal ndaj ketyre zonave jane ne perputhje me gjendjen dhe planet e zhvillimit te tyre. Konkretisht, per vitin 2001, ne planet e investimeve te Ministrise se Pushtetit Lokal, jane parashikuar fondet si me poshte:

Per organet e qeverisjes vendore ne rrethet e Sarandes dhe Delvines ne 000/leke:

- Komuna Aliko 2000
- Komuna Xarre 1500
- Komuna Livadhja 2000
- Komuna Mesopotam 2000

Ne kater komunat ku jetojne pjestare te pakices greke, financimet per investime perfaqesojne 15.9% te fondeve te akorduara ne shkalle qarku, ne nje kohe qe keto komuna perfaqesojne 15.3% te numrit te organeve te qeverisjes vendore te qarkut.

Per organe te qeverisjes vendore ne Rrethin e Gjirokastres ne 000/leke:

- Komuna Dropull i Poshtem 5000
- Komuna Dropull i Siperm 5000
- Komuna Çarshove 1000

Per komunat e mesiperme Ministria e Pushtetit Lokal po akordon fonde per investime per vitin 2001 sipas komunave, te barabarta me 23.7% te fondit te planifikuar te qarkut ne total, ne nje kohe qe komunat perfaqesojne 18.6% te numrit te organeve te qeverisjes vendore te qarkut.

Per organe te qeverisjes vendore ne Rrethin e Korçes ne 000/leke:

- Komuna Liqenas 6000

Sipas burimeve nga Ministria e Pushtetit Lokal, pavaresisht nga fondet per investime te planifikuara per vitin 2001, fondet e akorduara vetem per 4 mujorin e pare per organet te qeverisjes vendore te komunave ku jetojne pjestare te pakicave kombetare ka nje rritje te ndjeshme qe pasqyrohen ne tabelat si me poshte:

Investimet per 4-mujorin e pare te 2001 ne 000/lek

RRETHI GJIROKASTER	EMERTIMI I OBJEKTIT	VLERA 000/lek	AFATI
Komuna Dropull i Poshtem	Rikonstruksion i rruges. Terihat	5000	Ne proces prokurimi
Komuna Dropull i Poshtem	Ndertim Ure Dervican	3000	
Komuna Dropull i Siperm	Rikonstruksion i rruges Zerhat	5000	Prokuruar
Komuna Dropull i Siperm	Rikonstruksion i rruges Vrisera-Logo	20 000	
Shuma		**60 400**	**Si Rreth**

RRETHI PERMET	EMERTIMI I OBJEKTIT	VLERA 000/lek	AFATI
Komuna Çarshove	Rikonstruksion zyrash	1000	20.04.2001 Tenderi
Shuma		**1000**	**Si Rreth**

RRETHI DELVINE	EMERTIMI I OBJEKTIT	VLERA 000/lek	AFATI
Komuna Mesopotam	Rikonstruksion i rruges se fshatit Brajlat	2000	17.04.2001 Prokurimi
Komuna Mesopotam	Rikonstruksion zyrash	2500	17.04.2001
Bashkia Delvine	Rikonstruksion i rruges se fshatit Rusan	1500	
Bashkia Delvine	Ndriçim qyteti	2000	20.04.2001 Tenderi
Bashkia Delvine	Rikonstruksion zyrash	4000	Prokuruar
Shuma		**12000**	**Si Rreth**

RRETHI SARANDE	EMERTIMI I OBJEKTIT	VLERA 000/lek	AFATI
Komuna Aliko	Rikonstruksion i rruges Halo	2000	25.04.2001
Komuna Aliko	Rikonstruksion i rruges se Çukes	1500	
Komuna Xare	Rikonstruksion i rruges se fshatit Xare	1500	23.04.2001 Tenderi
Komuna Xare	Ndertim zyrash	5000	4- mujori II
Komuna Livadhja	Rikonstruksion i rruges Livadhja-Ripes	2000	30.04.2001 Tenderi
Shuma		**12000**	**Si Rreth**

Ne Gjirokaster, siç jane paraqitur edhe ne tabelen me lart, investimet per 4-mujorin e pare te 2001, ne komunat ku jetojne pjestare te pakices greke ne raport me tere rrethin e Gjirokastres, perfaqesojne 50% te investimeve, kurse ne nivel qarku rreth 25%.

Ne Rrethin e Sarandes, investimet per 4-mujorin e pare 2001, ne komunat ku jetojne pjestare te pakices greke ne raport me investimet ne tere rrethin perfaqesojne 34%, ndersa ne rrethin e Delvines 37%, kurse ne nivel qarku perfaqesojne 11% te investimeve.

Investimet ne Komunen e Liqenasit ku jetojne pjestare te pakices maqedonase, per 4-mujorin e pare 2001 ne 000/lek jane: Rikonstrusion zyrash 5000 dhe paisje zyrash 1000. Duke e krahasuar me komunat e tjera te rrethit te Korçes, Komuna e Liqenasit eshte komuna qe ka me shume investime.

Organet e qeverisjes vendore dhe perfaqesues nga pakica greke aktualisht marrin pjese ne programin e bashkepunimit nderkufitar INTERG ne kuadrin e te cilit jane parashikuar disa projekte si: zgjerimi i rruges Sarande-Ksamil, rrugelidhjet e zonave bregdetare me zonat me ne thellesi, si dhe projekte per ujesjellsat etj.

Duhet thene se, nga pikpamja ligjore, Kodi i Proceduarve Administrative te Republikes se Shqiperise ne nenin 13, pika 2, parashikon detyrimin e organeve te administrates publike per te siguruar pjesemarrjen e personave private dhe/ose shoqatave ne marrjen e vendimeve kur interesat e grupeve, te cilat ata perfaqesojne preken nga keto vendime.

Nga perfaqesues te pakices greke ngrihet pretendimi per nje angazhim me te madh ne forcat e policise. Ndonese pretendimi eshte i drejte dhe eshte e vertete qe ne radhet e policise ka pak pjestare te kesaj pakice, eshte gjithashtu e vertete qe praktikisht nuk ka asnje kerkese formale nga pjestare te pakices greke per t'u angazhuar ne radhet e policise. Drejtues te Ministrise se Rendit theksojne se jane te gatshem t'iu pergjigjen pozitivisht kerkesave te pjestareve te kesaj pakice per punesim ne organet e rendit. Ndryshe nga pakica greke, pjestare te pakices maqedonase jane te punesuar si ne forcat e policise ashtu edhe ne ushtri

Neni 16

*Palet **nuk do te ndermarrin masa, te cilat mund te ndryshojne perberjen e popullsise ne zonat** e banuara nga personat qe u perkasin pakicave, me qellim qe te kufizojne te drejtat dhe lirite qe burojne nga parimet e percaktuara ne kete Konvente Kuader.*

Shteti shqiptar dhe qeveria e tij ndalon çdo politike, qe mund te çonte ne ndryshimin e perberjes kombetare dhe etnike te popullsise ne zonat e banuara nga pakicat, me synim kufizimin e te drejtave dhe lirive te tyre.

Politika qe synojne ndryshimin e perberjes se popullsise, nepermjet planeve te paramenduara, per te shkaterruar teresisht apo pjeserisht nje grup nacional, etnik racial apo fetar, i drejtuar kunder anetareve te grupit, nepermjet vrasjes se tyre, demtimit fizik apo psiqik, vendosjes ne kushte jetese te renda, masave qe synojne pengimin e lindjeve, transferimi i detyrueshem i femijeve te nje grupi ne nje grup tjeter apo internimet dhe debimet, sipas neneve 73 dhe 74 te Kodit Penal te Republikes se Shqiperise, perbejne vepra te renda penale, qe denohen deri ne burgim te perjetshem.

E drejta e zgjedhjes se vendbanimit dhe levizjes lirisht ne çdo pjese te territorit shqiptar apo per te dale lirisht jashte shtetit, qe parashikohen ne nenin 38 te Kushtetutes, jane te drejta qe, ashtu si shqiptaret, i gezojne edhe pjestaret e pakicave kombetare. Sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.14, date 24.1.1994 "Per Ndryshimin e Vendbanimit nga Shtetasit Shqiptare", ata "jane te lire te zgjedhin vendbanimin e tyre brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

Per levizjen e evidences se gjendjes civile shtetasi paraqet ne zyren perkatese te vendbanimit te ri (bashki, komune) nje kerkese me shkrim dhe, sipas rastit, dokumentin e pronesise se baneses ku eshte vendosur, kopjen e kontrates se qiramarrjes se baneses dhe çdo dokument tjeter qe verteton qendrimin e tij ne nje banese te caktuar te ndertuar ne menyre te ligjshme, te vertetuar nga kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes ose kryetari i bashkise a komunes ne qytetet qe nuk kane lagje. Zyra e gjendjes civile e vendbanimit te ri i kerkon zyres se gjendjes civile te vendbanimit te meparshem te beje çregjistrimin nga regjistri themeltar dhe te dergoje dokumentet perkatese per te bere regjistrimin ne vendbanimin e ri".

Keshtu, levizjet e vullnetshme demografike, qe lidhen si me veshtiresite ekonomike te tranzicionit, ashtu edhe me zhvillimet e pergjithshme te kohes se sotme, si industrializimi, tendenca e pergjithshme e migracioneve drejt qyteteve te medha etj., qe ne nje fare menyre prekin te gjitha zonat rurale ne Shqiperi, nuk cenojne zbatimin e plote te ketij neni te Konventes.

Sidoqofte, eshte fakt, se ndryshe nga migrimi i popullsise shqiptare, qe ka qene nje nga proceset me dramatike te tranzicionit ne Shqiperi, pjestaret e pakicave ne raste shume te ralla kane levizur drejt zonave urbane. Per shkak te afersise gjeografike, afersise gjuhesore, kulturore e shpirterore, lehtesive te hyrjes dhe rikthimit, pjestaret e pakicave kane ndjekur rrugen e emigrimit kryesisht ne vendet e tyre ame. Nje gje e tille ka sjelle si pasoje ndryshime te rendesishme demografike ne keto zona. Por duket se ky fenomen eshte i perkohshem. Kjo mund te shihet nga fakti se pothuajse asnje nga te larguarit nuk ka shitur shtepite dhe pronat. Perkundrazi, shumica e tyre eshte kthyer here pas here per pushime, kane ndertuar shtepi te reja apo kane hapur biznese te rendesishme etj.

Gjate luftes ne Kosove, ne Sarande u strehuan rreth 2.700 kosovare. Ata u priten dhe u ndihmuan bujarisht si nga popullsia shqiptare, ashtu edhe nga popullsia e pakicave. Me mbarimin e luftes, ata te gjithe u larguan nga Saranda, per t'u kthyer ne trojet dhe shtepite e tyre me pershtypjet me te mira nga mikpritja qe ata gjeten tek e gjithe popullsia e pakices se kesaj zone. Ne disa media te huaja dhe ne disa qarqe te caktuara te pakices ne ate kohe, u be zhurme e madhe per kete problem sepse u perhap mendimi se kosovaret e ardhur do te vendoseshin ne pronat e pjestareve te pakices greke, qe perkohesisht kane emigruar dhe punojne ne Greqi.

Nje drejtim tjeter ne kete aspekt eshte politika e ndarjes se zonave zgjedhore ne Shqiperi. Ne menyre qe te mos preket uniteti i zonave te banuara si nga shqiptaret, ashtu edhe nga pjestaret e pakicave kombetare, ne nenin 71, te Ligjit Nr. 8609, date 08.05. 2000, "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", ku percaktohen kriteret per vendosjen e kufijve te zonave zgjedhore, parashikohet qe zonat te jene kompakte dhe te mos ndahen ne pjese qe jane te shkeputura nga njera tjetra. Sipas ketij neni, ne percaktimin e kufijve te te gjitha zonave, shihet qe diferenca mes numrit te zgjedhesve ne çdo zone dhe numrit mesatar te jete, per aq sa eshte e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 per qind te numrit mesatar. Kur numri i

zgjedhesve ne nje bashki eshte brenda intervalit plus ose minus 5 per qind te numrit mesatar, ajo bashki duhet te perbeje nje zone zgjedhore. Per aq sa eshte e mundur, komuna duhet te perfshihet teresisht brenda nje zone zgjedhore dhe, bashkia me numer zgjedhesish me te vogel se ai brenda intervalit plus ose minus 5 per qind te numrit mesatar, nuk duhet te ndahet ne me shume se dy zona zgjedhore. Gjithashtu, ky nen, ne percaktimin e kufijve te zonave zgjedhore, kerkon marrjen parasysh te lidhjeve tradicionale dhe interesave te perbashketa te bashkesive vendore, te barrierave dhe kufijve natyrore, linjat e komunikimit dhe transportit, si dhe kufijte e qarqeve.

Neni 17

1. *Palet angazhohen te mos pengojne te drejten e personave qe u perkasin pakicave kombetare* ***per te vendosur dhe mbajtur kontakte te lira dhe paqesore pergjate kufijve*** *me personat qe ndodhen ligjerisht ne shtetet e tjera, veçanerisht me ata me te cilet kane nje identitet etnik, kulturor, gjuhesor ose fetar, apo nje trashegimi te perbashket kulturore.*
2. *Palet angazhohen te mos pengojne te drejten e personave qe u perkasin pakicave kombetare* ***per te marre pjese ne veprimtarite e organizatave joqeveritare****, ne nivel kombetar dhe nderkombetar.*

17. 1. E drejta per te vendosur dhe mbajtur kontakte te lira dhe paqesore nderkufitare me persona qe qendrojne ne menyre te rregullt ne shtete te tjera apo me persona qe kane identitet etnik, kulturor, gjuhesor apo fetar, apo trashegimi kulturore te perbashket me ta, eshte e garantuar. Ne paragrafin e dyte, te nenit 38, te Kushtetutes thuhet: "Askush nuk mund te pengohet te dale lirisht jashte shtetit". Ne kete kuader, pjestaret e pakicave kombetare, ashtu si te gjithe shtetasit shqiptare, jane te lire qe, jo vetem te mbajne kontakte me persona qe qendrojne ne menyre te rregullt ne shtete te tjera, por te shkojne lirisht e te takohen me ta, me njerezit e tyre te aferm, me miqte e tyre apo me personalitete te jetes politike, ekonomike, kulturore, arsimore dhe me autoritetet administrative te ketyre vendeve. Gjithashtu, ata kane kontakte te lira me shtypin, radiot e kanalet e ndryshme televizive, jo vetem te vendeve te tyre ame por edhe me ato te vendeve te ndryshme. Ata jane shprehur lirisht ne intervista ne shtyp apo ne programe e biseda te ndryshme ne radio dhe television per problemet e tyre dhe per çfaredo problemi tjeter, qe ata e kane konsideruar te nevojshme te informojne, qofte median ne vendin e tyre ame, qofte ate nderkombetare.

Sikurse kemi permendur edhe me pare, ne 10 vjetet e fundit, per shkak te hapjes se kufijve, prapambetjes dhe veshtiresive te shumta ekonomike te periudhes se

tranzicionit ne Shqiperi, veçanerisht nje pjese e mire e popullsise shqiptare dhe te pakices greke te zonave te jugut te vendit ka gjetur mundesine te punesohet dhe te jetoje perkohesisht apo edhe per periudha me te gjata ne Greqi. Ne kete drejtim, me e privilegjuar ka qene pakica greke. Nder te tjera, ata favorizohen ne dhenien e vizave (deri ne 5 vjet) apo edhe te kartave te qendrimit, ne gjetjen e vendeve te punes, ne shkollimin e femijeve, trajtimin mjeksor, etj.

E njejta gje mund te thuhet edhe per anetaret e pakices maqedonase, te cilet, perveç favorizimeve ne marrjen e vizave, tani perfitojne edhe nga mundesia qe krijon marreveshja bilaterale midis Shqiperise dhe ish Republikes Jugosllave te Maqedonise per levizjen e lire te popullsise qe jeton ne nje zone prej deri 20 km nga kufiri shteteror i dy vendeve.

17. 2. E drejta e personave qe u perkasin pakicave kombetare per te marre pjese ne veprimtarite e organizatave joqeveritare kombetare apo nderkombetare gjithashtu nuk parashikohet ne ndonje akt ligjor. Por, gjithesesi, legjislacioni shqiptar nuk kufizon apo ndalon individet qe u perkasin pakicave kombetare apo shoqatave dhe organizatave te tyre, te drejten per te marre pjese ne veprimtarite e organizatave joqeveritare ne nivel kombetar apo nderkombetar. Si per te gjithe shtetasit shqiptare, ashtu edhe per pjestaret e pakicave kombetare, legjislacioni shqiptar parashikon te drejten e lirise se levizjes pa u penguar jashte shtetit, lirine e shprehjes dhe organizimit, lirine dhe fshehtesine e korespondences etj. Keto krijojne te gjitha hapesirat e nevojshme per vendosjen dhe zgjerimin e kontakteve dhe pjesmarrjen e tyre te lire ne veprimtarite e organizatave joqeveritare kombetare dhe nderkombetare. Veprimtarite e shumta te perbashketa qe zhvillohen ne Shqiperi nga organizatat joqeveritare ne bashkepunim me njera tjetren, me organizatat simotra te vendeve te ndryshme, me organizmat nderkombetare dhe me pjesmarrjen e gjere te perfaqesuesve te ketyre organizatave, flasin qarte per kete. Nga ana tjeter, pjesemarrja e anetareve te pakicave kombetare te ndryshme ne konferenca, seminare apo veprimtari te ndryshme jashte vendit, deri ne konferenca e seminare qe organizohen nga Keshilli i Evropes, apo pjesmarrja dhe paraqitja e opinioneve te tyre per çeshtje te ndryshme deri ne Parlamentin Evropian etj., perseri flasin qarte per gezimin dhe ushtrimin e kesaj te drejte nga anetaret e pakicave kombetare ne Shqiperi.

Neni 18

1. *Palet do te perpiqen te perfundojne, kur eshte e nevojshme,* ***marreveshje dypaleshe dhe shumepaleshe me shtetet e tjere****, veçanerisht me shtetet*

fqinj, per te siguruart mbrojtjen e personave qe u perkasin pakicave kombetare perkatese.

2. *Kur eshte rasti, Palet do te marrin masa* ***per te inkurajuar bashkepunimin nderkufitar****.*

18. 1. Persa i perket marreveshjeve shumepaleshe, lidhur me mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore te nenshkruara dhe ratifikuara nga Republika e Shqiperise, komente jane bere ne nenin dy te ketij raporti.

Lidhur me marreveshjet dypaleshe te nenshkruara nga Shqiperia me vendet fqinje, mund te permendim traktatet e miqesise, bashkepunimit, fqinjesise se mire dhe sigurise me Greqine, Bullgarine, Rumanine, Turqine etj.

Nder to, ne menyre te veçante, do te permendnim "Traktatin e Miqesise, Bashkepunimit, Fqinjesise se Mire dhe Sigurimit midis Republikes se Shqiperise dhe Republikes Greke", nenshkruar ne Tirane me 21 mars 1996.

Ne kete traktat, te dyja Palet:

- ripohojne perkushtimin e tyre ndaj qellimeve dhe parimeve te Kartes se Kombeve te Bashkuara, Aktit Final te Helsinkit, te Kartes se Parisit per nje Evrope te Re dhe teksteve te tjera te OSBE-se, (Preambula, pika 4)
- vleresojne se te drejtat themelore njerezore dhe minoritare kane rendesi te dores se pare si pjese e trashegimise mbarevropiane, (Preambula, pika 6)
- pranojne se pakica greke ne Shqiperi ka kontribuar dhe vazhdon te kontribuoje ne menyre te rendesishme ne jeten e shoqerise dhe perben faktor per zhvillimin e miqesise midis dy vendeve, (Preambula, pika 7)
- te frymezuara nga bashkepunimi arsimor dhe komunikimi kulturor, qe tashme ekziston midis popujve te te dy vendeve, favorizojne zhvillimin e shkembimeve midis organizatave dhe personave te te dy vendeve ne fushat e kultures dhe informacionit, (neni 11)
- do te perpiqen qe, ne baze te konventave dhe marreveshjeve midis tyre, te intensifikojne dhe zgjerojne shkembimet kulturore ne te gjitha fushat dhe ne te gjitha nivelet, duke perfshire edhe krijimin e qendrave kulturore dhe mesimin e gjuheve te tyre, ne menyre qe te japin ndihmesen ne njohjen e ndersjellte te kulturave kombetare, (neni 12)
- duke njohur rendesine e mbrojtjes dhe respektimit te te Drejtave Njerezore dhe minoritare, jane dakord te zbatojne dispozitat e teksteve te OSBE-se, qe permenden ne Dimensionin Njerezor, por sidomos ne tekstet e Takimeve te Kopenhages (1990), te Gjeneves (1991), dhe te Moskes (1991).

Te dy vendet kane nenshkruar, gjithashtu, nje sere marreveshjesh e protokollesh te tjera, si p.sh. ato per bashkepunimin ne fushat e arsimit, shkences dhe kultures. Pikerisht mbi bazen e ketyre protokolleve dhe me angazhimin e drejtperdrejte te qeverive te te dy vendeve jane realizuar nje sere shkembimesh te rendesishme, qe kane kontribuar ne ngritjen e nivelit te mesimdhenies se gjuhes greke ne Shqiperi, nepermjet trajnimit te mesuesve minoritare ne kurse kualifikimi ne Greqi, ne pajisjen me te mire me mjete didaktike te shkollave ku mesojne femijet e minoritareve, ne shkembimet e nxenesve, ne pajisjen me te mire me tekste shkollore bashkohore te mesimit te gjuhes, te njohjes se ndersjellte te kultures se dy vendeve etj., nga te cilat ka perfituar me se shumti pakica greke ne Shqiperi. Nje ndihmese te madhe keto protokolle kane dhene per nxitjen e ngritjes se nivelit te studimit te gjuhes greke edhe ne Universitetin e Tiranes dhe te gjuhes shqipe ne Universitetin e Janines.

Perpjekje per perfundimin e protokolleve te tilla po behen edhe me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, te cilat do te zgjerojne dhe thellojne me tej shkembimet midis dy vendeve ne fushen e arsimit dhe shkences dhe qe, padyshim, do te ndikojne pozitivisht ne ruajtjen dhe zhvillimin e traditave edhe te pakices maqedonase qe jeton ne Shqiperi.

18. 2. Shqiperia ka bere dhe po ben te gjitha perpjekjet per konsolidimin dhe zgjerimin e bashkepunimit nderkufitar. Me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise Shqiperia ka nenshkruar Marreveshjen per Qarkullimin e Vogel Kufitar, mbi bazen e te ciles, popullsia ne te dy anet e kufirit, deri ne nje largesi prej 20 km., qarkullon lirisht ne kete hapesire vetem me kartat e identitetit te leshuara nga autoritetet vendore te te dy vendeve.

Megjithe perpjekjet e bera nga qeveria shqiptare per nenshkrimin e nje marreveshje per qarkullimin e vogel kufitar edhe me Greqine, nje gje e tille nuk eshte arritur, per shkak te detyrimeve te saj ndaj marreveshjes se Shengenit. Por, duhet theksuar se ne kuadrin e programeve qe ka BE-ja' per zhvillimin e zonave kufitare te BE-se, si INTEREG dhe CROSS-BORDER, me Greqine ekziston nje bashkepunim shume i mire.

Ne kuadrin e bashkepunimit nderkufitar, ekzistojne gjithashtu disa projekte te perbashketa nder te cilet mund te permendim projektin Parku Kombetar Prespa (shpallja dhe mbrojtja e te cilit eshte bere me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 80, date 18.2.1999), qe eshte perfshire ne programet e Bankes Boterore dhe atyre te Qeverise Gjermane, projektet per rindertime sociale ne komunat e zonave kufitare etj., te cilat jo vetem krijojne kushtet per zhvillimin e metejshem te marredhenieve me vendet fqinje, por, njekohesisht, influencojne drejtperdrejt ne mireqenien edhe te popullsise se pakicave qe jeton ne keto zona. Shqiperia ben te gjitha perpjekjet e mundeshme per nxitjen e realizimit te projekte te tilla me Greqine, ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe Malin e Zi.

Neni 19

Palet angazhohen te respektojne dhe zbatojne parimet qe permbahen ne kete Konvente Kuader, duke bere, kur eshte e nevojshme, ***vetem ato kufizime apo shmangie qe jane parashikuar ne instrumentet juridike nderkombetare, veçanerisht ne Konventen per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore****, per aq sa ato kane te bejne me te drejtat dhe lirite qe burojne nga keto parime.*

Persa i perket kesaj klauzole, perseri duhet t'i referohemi komenteve te bera ne nenin 2, lidhur me zbatimin nga Republika e Shqiperise te konventave dhe marreveshjeve mbi te drejtat e njeriut, te cilat jane nenshkruar apo ratifikuar nga Shqiperia. Permendim se Shqiperia eshte midis vendeve qe ka ratifikuar Konventen-Kuader pa bere asnje rezerve, kufizim apo shmangie.

Sipas nenit 17 te Kushtetutes se Shqiperise, "*kufizimet e te drejtave dhe lirive te parashikuara ne Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve dhe duhet te jete ne perpjesetim me gjendjen qe e ka diktuar ate. Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut*".

Kufizimi i te drejtave themelore te individit nga veprimet e administrates publike rregullohet nga paragrafi i dyte i nenit 11 te Kodit te Procedurave Administrative, i cili percakton se: "*Veprimet e administrates publike, te cilat per arsye te mbrojtjes se interesit publik ose te te drejtave te te tjereve, kufizojne te drejtat themelore te individit te njohura nga Kushtetuta, marreveshjet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, duhet gjithsesi te respektojne parimin e proporcionalitetit dhe te mos cenojne thelbin e lirive dhe te drejtave. Kjo do te thote qe veprimet e administrates publike duhet te jene te tilla qe:*

- *te kerkojne realizimin e interesave te ligjshme publike;*
- *te perdorin gjithnje mjete te pershtatshme dhe ne proporcion me qellimet qe synohen te arrihen".*

Ne çdo rast, organet e administrates publike detyrohen te vleresojne nese eshte e mundur qe qellimi i kerkuar te realizohet me masa sa me pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre".

Seksioni III

Neni 20

Ne ushtrimin e te drejtave dhe lirive, qe burojne nga parimet e percaktuara ne kete Konvente Kuader, ***çdo person qe i perket nje pakice kombetare do te respektoje legjislacionin kombetar dhe te drejtat e te tjereve****, veçanerisht ato te personave qe u perkasin shumices apo pakicave te tjera kombetare.*

Neni 21

Asgje ne kete Konvente Kuader nuk do te interpretohet se nenkupton ndonje te drejte per t`u angazhuar ne veprimtari apo per te kryer ndonje veprim qe eshte kunder ***parimeve themelore te se drejtes nderkombetare****, dhe veçanerisht kunder* ***barazise sovrane, integritetit territorial dhe pavaresise politike te shteteve.***

Neni 22

Ne kete Konvente Kuader asgje nuk kufizon apo shmang ndonje prej te ***drejtave te njeriut dhe lirive themelore****, qe mund te sigurohen sipas ligjeve te ndonje pale kontraktuese, apo ndonje marreveshje tjeter, ku ajo eshte pale.*

Neni 23

Te drejtat dhe lirite, qe burojne nga parimet e parashikuara ne kete Konvente Kuader, ne masen qe ato jane objekt i nje dispozite pergjegjese ***ne Konventen per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore*** *apo ne protokollet e saj, do te kuptohen ne nje menyre, e cila eshte ne perputhje me dispozitat e kesaj te fundit.*

Neni 30

1. *Çdo Shtet mund te percaktoje ne momentin e nenshkrimit, apo kur depoziton instrumentin e tij te ratifikimit, pranimit, miratimit apo te*

aderimit, territorin apo territoret per te cilat ai eshte pergjegjes ne marredheniet nderkombetare, ***ku do te zbatohet*** *kjo konvente kuader.*

2. *Çdo Shtet mund* ***te zgjeroje****, ne çdo moment me vone, me ane te nje deklarate drejtuar Sekretarit te Prgjithshem te Keshillit te Europes,* ***zbatimin*** *e kesaj Konvente Kuader ne çdo territor tjeter, te percaktuar ne kete deklarate. Lidhur me keto territore, Konventa Kuader do te hyje ne fuqi ne diten e pare te muajit vijues pasi te kene kaluar 3 muaj, nga data e marrjes se nje deklarate te tille nga Sekretari i Pergjithshem.*

3. *Çdo deklarate e bere sipas dy paragrafeve te mesiperme mund te terhiqet, lidhur me çdo territor te caktuar ne kete deklarate, me ane te nje njoftimi drejtuar Sekretarit te Pergjithshem.* ***Terheqja*** *do te hyje ne fuqi ne diten e pare te muajit vijues pasi te kene kaluar 3 muaj, nga data e marrjes se nje njoftimi te tille nga Sekretari i Pergjithshem.*

Per nenet **20, 21, 22, 23** dhe **30** te Konventes Kuader, nuk kemi ndonje koment te veçante.

DISPOZITA KRYESORE TE LEGJISLACIONIT SHQIPTAR PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE PAKICAVE KOMBETARE NE SHQIPERI

L I G J

Nr. 8417, Date: 21.10.1998

KUSHTETUTA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 1

1. Shqiperia eshte republike parlamentare.
2. Republika e Shqiperise eshte shtet unitar dhe i pandashem.
3. Qeverisja bazohet ne nje sistem zgjedhjesh te lira, te barabarta, te pergjithshme e periodike.

Neni 3

Pavaresia e shtetit dhe teresia e territorit te tij, dinjiteti i njeriut, te drejtat dhe lirite e tij, drejtesia shoqerore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombetar dhe trashegimia kombetare, bashkejetesa fetare, si dhe bashkejetesa dhe mirekuptimi i shqiptareve me pakicat jane baza e ketij shteti, i cili ka per detyre t'i respektoje dhe t'i mbroje.

Neni 8

1. Republika e Shqiperise mbron te drejtat kombetare te popullit shqiptar qe jeton jashte kufijve te saj.

2. Republika e Shqiperise mbron te drejtat e shtetasve shqiptare me banim te perkohshem ose te perhershem jashte kufijve te vet.

3. Republika e Shqiperise u siguron ndihme shtetasve shqiptare qe jetojne e punojne jashte shtetit per te ruajtur e per te zhvilluar lidhjet me trashegimine kulturore kombetare.

Neni 9

1. Partite politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet te perputhet me parimet demokratike.

2. Partite politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e te cilave mbeshteten ne metoda totalitariste, qe nxitin e perkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, qe perdorin dhunen per marrjen e pushtetit ose per te

ndikuar ne politiken shteterore, si edhe ato me karakter te fshehte jane te ndaluara sipas ligjit.

3. Burimet financiare te partive, si dhe shpenzimet e tyre behen kurdohere publike.

Neni 10

1. Ne Republiken e Shqiperise nuk ka fe zyrtare.

2. Shteti eshte asnjanes ne çeshtjet e besimit e te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike.

3. Shteti njeh barazine e bashkesive fetare.

4. Shteti dhe bashkesite fetare respektojne ne menyre te ndersjellte pavaresine e njeri-tjetrit dhe bashkepunojne ne te mire te secilit dhe te te gjitheve.

5. Marredheniet ndermjet shtetit dhe bashkesive fetare rregullohen mbi bazen e marreveshjeve te lidhura ndermjet perfaqesuesve te tyre dhe Keshillit te Ministrave. Keto marreveshje ratifikohen ne Kuvend.

6. Bashkesite fetare jane persona juridike. Ato kane pavaresi ne administrimin e pasurive te tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve te tyre, per sa nuk cenohen interesat e te treteve.

Neni 13

Qeverisja vendore ne Republiken e Shqiperise ngrihet ne baze te parimit te decentralizmit te pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomise vendore.

Neni 14

1. Gjuha zyrtare ne Republiken e Shqiperise eshte shqipja.

……..

Neni 16

1. Te drejtat e lirite themelore, si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetute per shtetasit shqiptare vlejne njelloj edhe per te huajt e per personat pa shtetesi ne territorin e Republikes se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur Kushtetuta e lidh ne menyre te posaçme me shtetesine shqiptare ushtrimin e te drejtave e te lirive te caktuara.

2. Te drejtat dhe lirite themelore, si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetute vlejne edhe per personat juridike, per aq sa perputhen me qellimet e pergjithshme te ketyre personave dhe me thelbin e ketyre te drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne kete Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimi duhet te jete ne perpjesetim me gjendjen qe e ka diktuar ate.

2. Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Te gjithe jane te barabarte perpara ligjit.

2. Askush nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore.

3. Askush nuk mund te diskriminohet per shkaqet e permendura ne paragrafin 2, nese nuk ekziston nje perligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 19

1. Kushdo qe lind duke pasur qofte edhe njerin prej prinderve me shtetesi shqiptare, e fiton vetiu shtetesine shqiptare. Shtetesia shqiptare fitohet edhe per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj.

2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbase shtetesine, perveçse kur ai heq dore prej saj.

Neni 20

1. Personat qe u perkasin pakicave kombetare ushtrojne ne barazi te plote para ligjit te drejtat dhe lirite e tyre.

2. Ata kane te drejte te shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore. Ata kane te drejte t'i ruajne e zhvillojne ato, te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare, si dhe te bashkohen ne organizata e shoqata per mbrojtjen e interesave dhe te identitetit te tyre.

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 22

1. Liria e shprehjes eshte e garantuar.

2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit eshte e garantuar.

3. Censura paraprake e mjeteve te komunikimit ndalohet.

4. Ligji mund te kerkoje dhenien e autorizimit per funksionimin e stacioneve te radios ose te televizionit.

Neni 23

1. E drejta e informimit eshte e garantuar.

2. Kushdo ka te drejte, ne perputhje me ligjin, te marre informacion per veprimtarine e organeve shteterore, si dhe te personave qe ushtrojne funksione shteterore.

3. Kujtdo i jepet mundesia te ndjeke mbledhjet e organeve te zgjedhura kolektive.

Neni 24

1. Liria e ndergjegjes dhe e fese eshte e garantuar.

2. Secili eshte i lire te zgjedhe ose te ndryshoje fene ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes se riteve.

3. Askush nuk mund te detyrohet ose te ndalohet te marre pjese ne nje bashkesi fetare ose ne praktikat e saj, si dhe te beje publike bindjet ose besimin e tij.

Neni 28

1. Kushdo, te cilit i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen qe i behet. Personi, te cilit i eshte hequr liria, duhet te njoftohet se nuk ka asnje detyrim te beje ndonje deklarate dhe ka te drejte te komunikoje menjehere me avokatin, si dhe t'i jepet mundesia per realizimin e te drejtave te tij.

……..

Neni 31

Gjate procesit penal kushdo ka te drejte:

a) te vihet ne dijeni menjehere dhe hollesisht per akuzen qe i behet, per te drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundesia per te njoftuar familjen ose te afermit e tij;

b) te kete kohen dhe lehtesite e mjaftueshme per te pergatitur mbrojtjen e vet;

c) te kete ndihmen pa pagese te nje perkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhen shqipe;

ç) te mbrohet vete ose me ndihmen e nje mbrojtesi ligjor te zgjedhur prej tij; te komunikoje lirisht dhe privatisht me te, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete te mjaftueshme;

d) t'u beje pyetje deshmitareve te pranishem dhe te kerkoje paraqitjen e deshmitareve, te eksperteve dhe te personave te tjere, te cilet mund te sqarojne faktet.

Neni 35

1. Askush nuk mund te detyrohet, perveçse kur e kerkon ligji, te beje publike te dhena qe lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, perdorimi dhe berja publike e te dhenave rreth personit behet me pelqimin e tij, me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka te drejte te njihet me te dhenat e mbledhura rreth tij, me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka te drejte te kerkoje ndreqjen ose fshirjen e te dhenave te paverteta ose te paplota ose te mbledhura ne kundershtim me ligjin.

Neni 36

Liria dhe fshehtesia e korrespondences ose e çdo mjeti tjeter te komunikimit jane te garantuara.

Neni 38

1. Kushdo ka te drejte te zgjedhe vendbanimin si dhe te levize lirisht ne çdo pjese te territorit te shtetit.

2. Askush nuk mund te pengohet te dale lirisht jashte shtetit.

Neni 39

1. Asnje shtetas shqiptar nuk mund te debohet nga territori i shtetit.

2. Ekstradimi mund te lejohet vetem kur eshte parashikuar shprehimisht ne marreveshjet nderkombetare ne te cilat Republika e Shqiperise eshte pale, dhe vetem me vendim gjyqesor.

3. Ndalohet debimi kolektiv i te huajve. Debimi i individeve te huaj lejohet ne kushtet e percaktuara me ligj.

Neni 42

1. Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor.

2. Kushdo, per mbrojtjen e te drejtave, te lirive dhe te interesave te tij kushtetues dhe ligjore, ose ne rastin e akuzave te ngritura kunder tij, ka te drejten e nje gjykimi te drejte dhe publik brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 44

Kushdo ka te drejte te rehabilitohet dhe/ose te zhdemtohet ne perputhje me ligjin, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi ose mosveprimi te paligjshem te organeve shteterore.

Neni 45

1. Çdo shtetas qe ka mbushur tetembedhjete vjeç, qofte edhe diten e zgjedhjeve, ka te drejten te zgjedhe dhe te zgjidhet.

2. Perjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqesor te formes se prere si te paafte menderisht.

3. Te denuarit qe jane duke vuajtur denimin me heqje te lirise, kane vetem te drejten per te zgjedhur.

4. Vota eshte vetjake, e barabarte, e lire dhe e fshehte.

Neni 46

1. Kushdo ka te drejte te organizohet kolektivisht per çfaredo qellimi te ligjshem.

2. Regjistrimi ne gjykate i organizatave ose i shoqatave behet sipas procedures se parashikuar me ligj.

3. Organizatat ose shoqatat qe ndjekin qellime antikushtetuese jane te ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqesore dhe pa arme, si dhe e pjesemarrjes ne to eshte e garantuar.

2. Tubimet paqesore ne sheshe dhe ne vendet e kalimit publik behen sipas procedurave te parashikuara me ligj.

Neni 48

Kushdo, vete ose se bashku me te tjere, mund t'u drejtoje kerkesa, ankesa ose verejtje organeve publike, te cilat jane te detyruara te pergjigjen ne afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Neni 52

1. Kushdo ka te drejten e sigurimeve shoqerore ne pleqeri ose kur eshte i paafte per pune, sipas nje sistemi te caktuar me ligj.

2. Kushdo, kur mbetet pa pune per shkaqe te pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete te tjera jetese, ka te drejten e ndihmes ne kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 57

1. Kushdo ka te drejten per arsimim.

2. Arsimi shkollor i detyrueshem caktohet me ligj.

3. Arsimi i mesem i pergjithshem publik eshte i hapur per te gjithe.

4. Arsimi i mesem profesional dhe i larte mund te kushtezohet vetem nga kritere aftesie.

5. Arsimi i detyrueshem, si dhe arsimi i mesem i pergjithshem ne shkollat publike eshte falas.

6. Nxenesit dhe studentet mund te arsimohen edhe ne shkolla jopublike te te gjitha niveleve, te cilat krijohen e funksionojne ne baze te ligjit.

7. Autonomia e institucioneve te arsimit te larte dhe liria akademike jane te garantuara me ligj.

Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron te drejtat, lirite dhe interesat e ligjshem te individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administrates publike.

2. Avokati i Popullit eshte i pavarur ne ushtrimin e detyres se tij.

3. Avokati i Popullit ka buxhet te veçante, te cilin e administron vete. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Neni 63

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor perpara Kuvendit.

2. Avokati i Popullit raporton perpara Kuvendit kur i kerkohet prej ketij, si dhe mund t'i kerkoje Kuvendit te degjohet per çeshtje qe ai i çmon te rendesishme.

3. Avokati i Popullit ka te drejte te beje rekomandime dhe te propozoje masa kur veren shkelje te te drejtave dhe lirive te njeriut nga administrata publike.

4. Organet dhe funksionaret publike jane te detyruar t'i paraqesin Avokatit te Popullit te gjitha dokumentet dhe informacionet e kerkuara prej tij.

Neni 64

1. Kuvendi perbehet nga 140 deputete. 100 deputete zgjidhen drejtperdrejt ne zona njeemerore me numer te perafert zgjedhesish. 40 deputete zgjidhen nga listat shumemerore te partive dhe/ose koalicioneve te partive sipas renditjes ne to.

2. Numri i pergjithshem i deputeteve te çdo partie dhe/ose koalicioni partish percaktohet ne raport sa me te afert me votat e vlefshme te marra prej tyre ne te gjithe vendin ne raundin e pare te zgjedhjeve.

3. Partite qe marrin me pak se 2.5 per qind dhe koalicionet e partive qe marrin me pak se 4 per qind te votave te vlefshme ne te gjithe vendin ne raundin e pare te zgjedhjeve, nuk perfitojne nga listat shumemerore perkatese.

Neni 68

1. Kandidatet per deputete mund te paraqiten vetem nga partite politike, nga koalicionet e partive, si dhe nga zgjedhesit.

2. Rregullat per caktimin e kandidateve per deputete, per organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe percaktimi i zonave zgjedhore dhe kushtet e vlefshmerise se zgjedhjeve rregullohen nga ligji per zgjedhjet.

Neni 81

1. Te drejten per te propozuar ligje e ka Keshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mije zgjedhes.

……

Neni 107

1. Nepunesit publike zbatojne ligjin dhe jane ne sherbim te popullit.

2. Nepunesit ne administraten publike caktohen me konkurs, me perjashtim te rasteve te parashikuara nga ligji.

3. Garancite e qendrimit ne detyre dhe trajtimi ligjor i nepunesve publike rregullohen me ligj.

Neni 108

1. Njesite e qeverisjes vendore jane komunat ose bashkite dhe qarqet. Njesi te tjera te qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Ndarjet administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazen e nevojave e te interesave te perbashket ekonomike dhe te tradites historike. Kufijte e tyre nuk mund te ndryshohen pa u marre me pare mendimi i popullsise qe banon ne to.

3. Komuna dhe bashkia jane njesi baze te qeverisjes vendore. Ato kryejne te gjitha detyrat veteqeverisese, me perjashtim te atyre qe me ligj u jepen njesive te tjera te qeverisjes vendore.

4. Veteqeverisja ne njesite vendore ushtrohet nepermjet organeve te tyre perfaqesuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat per zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj ne perputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.

Neni 109

1. Organet perfaqesuese te njesive baze te qeverisjes vendore jane keshillat, te cilet zgjidhen çdo tre vjet me zgjedhje te pergjithshme, te drejtperdrejta dhe me votim te fshehte.

2. Organi ekzekutiv i bashkise ose i komunes eshte kryetari, i cili zgjidhet drejtperdrejt nga populli ne menyren e parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni.

3. Te drejten e zgjedhjes ne keshillat vendore dhe si kryetar bashkie ose komune e kane vetem shtetasit qe jane me banim te perhershem ne territorin e njesise vendore perkatese.

4. Organet e njesive te qeverisjes vendore kane te drejte te formojne bashkime dhe institucione te perbashketa me njeri-tjetrin per perfaqesimin e interesave te tyre, te bashkepunojne me njesite vendore te vendeve te tjera, si dhe te perfaqesohen ne organizatat nderkombetare te pushteteve vendore.

Neni 110

1. Qarku perbehet nga disa njesi baze te qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe te interesave te perbashket.

2. Qarku eshte njesia ku ndertohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politiken shteterore.

3. Organi perfaqesues i qarkut eshte keshilli i qarkut. Bashkite dhe komunat delegojne anetare ne keshillin e qarkut ne perpjesetim me popullsine e tyre, por per çdo rast te pakten nje anetar. Kryetaret e komunave dhe te bashkive jane kurdohere anetare te keshillit te qarkut. Anetaret e tjere te tij zgjidhen me lista perpjesetimore nder keshilltaret bashkiake ose komunale nga keshillat perkates.

4. Keshilli i qarkut ka te drejte te nxjerre urdheresa dhe vendime me fuqi detyruese te pergjithshme per qarkun.

Neni 113

1. Keshillat komunale, bashkiake dhe te qarkut:

a) rregullojne dhe administrojne ne menyre te pavarur çeshtjet vendore brenda juridiksionit te tyre;

b) ushtrojne te drejtat e prones, administrojne ne menyre te pavarur te ardhurat e krijuara, si dhe kane te drejte te ushtrojne veprimtari ekonomike;

c) kane te drejte te mbledhin dhe te shpenzojne te ardhurat qe jane te domosdoshme per ushtrimin e funksioneve te tyre;

ç) kane te drejte te vendosin, ne perputhje me ligjin, taksa vendore, si dhe nivelin e tyre;

d) caktojne rregullat per organizimin dhe funksionimin e tyre ne pajtim me ligjin;

dh) krijojne simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendore te nderit;

e) ndermarrin nisma per çeshtje vendore perpara organeve te caktuara me ligj.

2. Organet e njesive te qeverisjes vendore nxjerrin urdheresa, vendime dhe urdhra.

3. Te drejtat per veteqeverisje te njesive te qeverisjes vendore mbrohen ne gjykate.

Neni 122

1. Çdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendshem juridik pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise. Ajo zbatohet ne menyre te drejtperdrejte, perveç rasteve kur nuk eshte e vetezbatueshme dhe zbatimi i saj kerkon nxjerrjen e nje ligji. Ndryshimi, plotesimi dhe shfuqizimi i ligjeve te miratuara me shumicen e te gjithe anetareve te Kuvendit per efekt te ratifikimit te marreveshjeve nderkombetare behet me te njejten shumice.

2. Nje marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te.

3. Normat e nxjerra prej nje organizate nderkombetare kane epersi, ne rast konflikti, mbi te drejten e vendit, kur ne marreveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqiperise per pjesemarrjen ne ate organizate, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtperdrejte i normave te nxjerra prej asaj.

Neni 150

1. Populli, nepermjet 50 mije shtetasve me te drejte vote, ka te drejten e referendumit per shfuqizimin e nje ligji, si dhe t'i kerkoje Presidentit te Republikes zhvillimin e referendumit per çeshtje te nje rendesie te veçante.

2. Kuvendi, me propozimin e jo me pak se nje se pestes se deputeteve ose me propozimin e Keshillit te Ministrave, mund te vendose qe nje çeshtje ose nje projektligj i nje rendesie te veçante te shtrohet ne referendum.

3. Parimet dhe procedurat per zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmeria e tij parashikohen me ligj.

Neni 175

1. Gjate gjendjes se luftes ose gjendjes se jashtezakonshme nuk mund te kufizohen te drejtat dhe lirite e parashikuara nga nenet: 15, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafet 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55.

2. Gjate gjendjes se fatkeqesise natyrore mund te kufizohen te drejtat dhe lirite e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.

3. Aktet per shpalljen e gjendjes se luftes, gjendjes se jashtezakonshme ose te gjendjes se fatkeqesise natyrore duhet te cilesojne te drejtat dhe lirite qe kufizohen sipas paragrafeve 1 dhe 2 te ketij neni.

L I G J
Nr. 8485, date 12.05.1999

KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 9

Parimi i ligjshmerise

1. Organet e Administrates Publike e zhvillojne veprimtarine e tyre ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, marreveshjet nderkombetare ne te cilat Republika e Shqiperise aderon, ligjet e Republikes se Shqiperise, brenda kufijve te kompetencave qe u jane dhene atyre dhe konform qellimit per te cilat jane dhene keto kompetenca.

2. Aktet administrative te nxjerra ne kushtet e gjendjes se jashtezakonshme ne kundershtim me dispozitat e ketij Kodi jane te vlefshme, ne qofte se rezultati i kerkuar ne kushtet e gjendjes se jashtezakonshme nuk mund te arrihet me mjete te tjera.

Palet e demtuara nga aktet e lartpermendura kane te drejte te kompensohen per humbjet eventuale ne baze te dispozitave ligjore, qe rregullojne pergjegjesine e administrates publike.

Neni 11

Parimi i barazise dhe proporcionalitetit

1. Ne marredheniet me personat private, administrata publike udhehiqet nga parimi i barazise ne kuptimin qe askush nuk duhet te privilegjohet apo diskriminohet per shkak te gjinise, races, fese, etnise, gjuhes, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesise prinderore.

2. Veprimet e administrates publike, te cilat per arsye te mbrojtjes se interesit publik ose te te drejtave te te tjereve, kufizojne te drejtat themelore te individit te njohura nga Kushtetuta, marreveshjet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, duhet gjithsesi te respektojne parimin e proporcionalitetit dhe te mos cenojne thelbin e lirive dhe te drejtave. Kjo do te thote qe veprimet e administrates publike duhet te jene te tilla qe:

- te kerkojne realizimin e interesave te ligjshme publike;
- te perdorin gjithnje mjete te pershtatshme dhe ne proporcion me qellimet qe synohen te arrihen.

Ne çdo rast, organet e administrates publike detyrohen te vleresojne nese eshte e mundur qe qellimi i kerkuar te realizohet me masa sa me pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre.

Neni 13

Parimi i bashkepunimit te administrates me personat private

1. Organet e administrates publike e zhvillojne veprimtarine e tyre ne bashkepunim te ngushte me personat private duke:

a. u siguruar personave private informacionin dhe sqarimet e nevojshme;

b. mbeshtetur dhe stimuluar nismat e personave private, si dhe duke mirepritur sugjerimet dhe informacionet e tyre.

2. Administrata publike mban pergjegjesi per informacionin me shkrim qe u jep personave private.

Organet e administrates publike sigurojne pjesemarrjen e personave private dhe/ose shoqatave ne marrjen e vendimeve kur interesat e grupeve, te cilat ata perfaqesojne preken nga keto vendime.

Sipas dispozitave te ketij Kodi, organet e Administrates Publike duhet t'u japin mundesi ketyre subjekteve per t'u shprehur.

LIGJI NR.8145, DATE 11.9.1996

PER TE DREJTEN E TUBIMEVE

Neni 1

Ne Republiken e Shqiperise gjithe shtetasit, pa asnje dallim per shkak te seksit, races, ngjyres, gjuhes, besimit, etnise, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, te bindjeve politike, perkatesise prinderore ose te çdo lloj rrethane tjeter vetjake, kane te drejte per tubime publike.

Neni 2

Ne zbatim te ketij ligji, me tubim do te kuptojme grumbullimet, manifestimet, mbledhjet, procesionet dhe parakalimet, ne te cilat pjesemarresit shprehin lirisht dhe ne menyre paqesore pikepamjet e tyre per çeshtjet qe u interesojne.

Neni 3

"Vende publike", ne kuptimin e ketij ligji, konsiderohen sheshet, bulevardet, rruget dhe çdo mjedis tjeter qe shfrytezohet lirisht per levizjet e qytetareve e te automjeteve.

Neni 4

Per tubimet ne vendet publike organizatoret detyrohen te kerkojne lejen me shkrim te shefit te komisariatit te policise, ne territorin e te cilit do te zhvillohen, jo me vone se tri dite perpara.

Neni 5

Kur tubimet zhvillohen ne "vende te hapura per publikun", si stadiume, salla kinemaje, teatri e te tjera mjedise te ketij lloji, nuk nevojitet leja me shkrim nga organet e policise.

Neni 6

Kur nevojitet leja per zhvillimin e tubimit, ne kerkesen me shkrim drejtuar shefit te komisariatit te policise duhet te pershkruhet:

a) identiteti dhe adresa e organizatoreve;

b) qellimi i tubimit;

c) data, vendi dhe koha e fillimit dhe e mbarimit te tubimit;

ç) numri i perafert i pjesemarresve.

Neni 7

Shefi i komisariatit te policise, kur e gjen kerkesen te ligjshme, e miraton dhe jo me vone se 24 ore para fillimit te tubimit njofton me shkrim organizatoret.

Neni 8

Shefi i komisariatit te policise mund te refuzoje dhenien e lejes per zhvillimin e nje tubimi, per shkak te sigurimit te rendit ose te qetesise publike, ne rastet kur:

a) zhvillimi i tubimit mund te kufizoje ose te dhunoje lirite dhe te drejtat themelore te shtetasve te tjere;

b) pengohet transporti dhe nje pengim i tille bie ndesh me interesat e qytetareve;

c) ka te dhena te besueshme per kryerjen e veprave penale ose te veprimeve te dhunshme;

ç) ne te njejtin vend dhe kohe me zhvillimin e tubimit eshte planifikuar nje tjeter ose mund te pengohet nje veprimtari me karakter kombetar.

Ne keto raste shefi i komisariatit te policise njofton me shkrim organizatoret e tubimit jo me vone se 24 ore para zhvillimit, duke parashtruar edhe shkaqet e refuzimit.

Neni 10

Gjate zhvillimit te tubimit organizatoret dhe pjesemarresit detyrohen t'i permbahen rreptesisht qellimit te percaktuar qysh me pare ne kerkesen e bere shefit te komisariatit te policise.

Neni 12

Pjesemarresve ne tubim u ndalohet mbajtja e armeve te çfaredolloji, edhe sikur te jene te pajisur me lejen perkatese nga organet kompetente. Gjithashtu, u ndalohet edhe mbajtja e maskave.

Neni 14

Ne rastet kur organizatoret a pjesemarresit ne tubim hedhin parrulla ose perdorin simbole antikushtetuese, ose te tilla qe nxitin te tjeret per veprime te dhunshme, kryejne veprime te tilla ose te tjera qe perbejne vepra penale, shefi i komisariatit te policise, ose persona te tjere te autorizuar prej tij, urdherojne ndalimin e tubimit dhe shperndarjen e pjesemarresve.

Neni 15

Kur pjesemarresit ne tubim, me gjithe thirrjet e qarta te policise, nuk shperndahen, shefi i komisariatit ose personi i autorizuar prej tij, urdheron shperndarjen forcerisht te tyre, pasi i ka paralajmeruar me pare se do te perdoret forca.

Neni 17

Pengimi ne ushtrimin e se drejtes per tubim, organizimi dhe pjesemarrja ne tubime te paligjshme, si dhe organizimi i tubimeve me pjesemarrje te personave te armatosur, perbejne vepra penale dhe denohen sipas neneve 261, 262 dhe 263 te Kodit Penal te Republikes se Shqiperise.

L I G J

Nr. 8580, date 17.2.2000

PER PARTITE POLITIKE

Neni 3

Partite politike shqiptare jane pjese e nje sistemi te lire e demokratik qeverises ne vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre eshte e lire dhe e garantuar nga Kushtetuta.

Neni 5

Veprimtaria e partive politike mund te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose ne disa njesi te ndarjes administrative territoriale te vendit.

Neni 7

Ndalohet regjistrimi i nje partie ne rastet kur:

a) organizimi i saj i brendshem eshte ne kundershtim me parimet demokratike dhe, veçanerisht, me parimet vijuese: ndertimi nga poshte lart i partise, zgjedhjet e brendshme demokratike per forumet e partise, e drejta e shprehjes se mendimit nga çdo anetar, liria e hyrjes dhe e daljes se tyre nga partia, e drejta e çdo anetari per te zgjedhur e per t'u zgjedhur;

b) ne dokumentet e themelimit te partise permendet shprehimisht ose, nga permbajtja e tyre, del se ato jane ne kundershtim me dispozitat kushtetuese qe ndalojne krijimin e partive ose strukturave partiake ne fushat e institucionet e parashikuara prej tyre;

c) partia eshte krijuar jashte territorit te Republikes se Shqiperise;

ç) ne dokumentet e themelimit te saj shprehet qellimi per perdorimin e dhunes per marrjen e pushtetit ose per te ndikuar ne politiken shteterore;

d) ne dokumentet e themelimit te saj shprehet nxitja dhe perkrahja e urrejtjes racore fetare, krahinore ose etnike;

dh) mbeshtetet ne metoda totalitariste, si dhe ka karakter te fshehte;

e) me te njejtin emertim eshte regjistruar nje parti tjeter.

Neni 8

Veprimtaria antikushtetuese e partive politike eshte e ndaluar.

Konstatimi i veprimtarise antikushtetuese te partise politike dhe ndalimi i saj vendoset nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 9

Regjistrimi i partive politike behet ne gjykaten e shkalles se pare te rrethit te Tiranes, e cila mban regjistrin e partive politike. Ne regjistrin e partive politike shenohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqesor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plote i partise, inicialet e partise, stema e partise, pershkrimi i konfiguracionit te vules, emri i kryetarit, shenime per ndryshimin e emrit, konfiguracione te vules ose te kryetarit te partise, fshirjes apo mbarimit te veprimtarise se subjektit, data e berjes se shenimit, emri, si dhe nenshkrimi i nepunesit kompetent.

Partia politike njihet si person juridik qe nga data kur gjykata ta kete miratuar dhe regjistruar ate.

Deri ne daten e regjistrimit, themeluesit e partise mund te kryejne veprime qe jane te nevojshme per organizimin e saj, siç jane, sidomos,thirrja e zhvillimi i mbledhjes se themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund te kryejne veprimtari si parti politike.

Neni 10

Pasi mbledhja e anetareve themelues te partise politike te kete miratuar dokumentet e partise, programin, statusin, si dhe organet drejtuese te saj, duhet te paraqitet ne gjykate kerkesa per regjistrimin e saj.

Kerkesa per regjistrimin e nje partie politike duhet te nenshkruhet nga jo me pak se 500 shtetas shqiptare, anetare themelues te saj, me vendbanim te perhershem ne Republiken e Shqiperise.

Neni 11

Ne dokumentet per regjistrimin e partise politike, percaktohen:

a) emertimi dhe selia e partise;

b) qellimet dhe detyrat e saj;

c) organet udheheqese dhe ndertimi i partise;

ç) burimet e financimit.

Neni 13

Regjistrimi i partise politike behet brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses per regjistrim dhe te dokumenteve te parashikuara ne nenin 10 dhe 11 te ketij ligji.

Ne rastin kur dokumentet e partive politike nuk jane te rregullta, gjykata, brenda 20 diteve e kthen kerkesen per te bere plotesimet perkatese.

Neni 15

Vendimi i gjykates per regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike ne regjistrin e partive politike mund te ankimohet ne gjykaten e apelit te Tiranes brenda 15 diteve nga data e shpalljes se vendimit te gjykates.

Neni 18

Shteti ndihmon materialisht partite politike ne kohen e krijimit te tyre. Ndihma jepet menjehere pas regjistrimit dhe eshte 100 000 leke.

Neni 21

Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private te huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesemarrje te kapitalit shteteror.

Lejohen dhuratat dhe ndihmat qe vijne nga parti ose bashkime nderkombetare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e te huaja, si dhe nga individe, persona fizike e juridike private vendas.

Neni 26

Partia politike shperndahet:

a) kur shkrihet ose bashkohet me parti te tjera;

b) kur ndahet ne dy ose me shume parti te tjera me emer te ri;

c) kur veteshperndahet ne perputhje me normat e statutit te saj;

ç) kur numri i anetareve te partise ka mberritur nen numrin minimal te caktuar me statut ose sipas ketij ligji;

d) kur ndalohet veprimtaria e saj me vendim te organit kompetent.

Vendimi per shperndarjen e partise politike depozitohet ne gjykaten e shkalles se pare te rrethit te Tiranes. Kjo gjykate vendos çregjistrimin e partise dhe procedurat perkatese per likuidimin e saj.

L I G J

Nr.8609, date 8.5.2000

KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 1

Qellimi i ketij Kodi

Ky Kod ka per qellim percaktimin e rregullave:

a) per votimin per zgjedhjet per Kuvendin, per organet e qeverisjes vendore dhe ne referendum;

b) per organizimin dhe funksionimin e komisioneve te zgjedhjeve;

c) per pergatitjen dhe rishikimin e listave te zgjedhesve;

ç) per caktimin e zonave zgjedhore;

d) per regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe financimin e tyre;

dh) per pasqyrimin e fushatave zgjedhore nga ana e mediave;

e) per zhvillimin dhe vlefshmerine e referendumeve;

e) per procedurat e votimit dhe te nxjerrjes se rezultateve te zgjedhjeve;

f) per shkeljet penale dhe administrative te dispozitave te ketij Kodi.

Neni 2

Perkufizime

Per qellimet e ketij Kodi:

1. "Data e zgjedhjeve" eshte data e votimit, e caktuar me dekret te Presidentit te Republikes dhe nuk perfshin daten kur mund te zhvillohet nje raund i dyte votimi.

2. "Institucione te posaçme" jane burgjet, vendet e paraburgimit, spitalet ose institucionet e tjera shendetesore, qe pranojne paciente per me shume se tri dite.

3. "Kandidat" eshte nje shtetas shqiptar, i regjistruar ne komisionet e zgjedhjeve si kandidat per deputet, ose per kryetar bashkie ose te komune, ose per keshillin e bashkise ose te komunes, ne perputhje me kete Kod, per te cilin do te votohet ne zgjedhje.

4. "Kandidat i pavarur" eshte nje kandidat per deputet, ose per kryetar bashkie ose komune, ose per keshillin e bashkise ose te komunes, qe nuk mbeshtetet nga asnje parti politike.

5. "Kandidat i perbashket" eshte nje kandidat i zones njeemerore ose i nje njesie zgjedhore, i cili mbeshtetet nga dy ose me shume parti politike.

6. "Koalicion" eshte nje grupim i dy ose me shume partive politike te regjistruara ne KQZ, te cilat paraqesin nje liste shumemerore te perbashket per zgjedhjet per Kuvendin ose per organet e qeverisjes vendore.

7. "KQV" eshte Komisioni i Qendres se Votimit.

8. "KQZ" eshte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i krijuar sipas nenit 154 te Kushtetutes.

9. "KZQV" eshte Komisioni i Zgjedhjeve per Qeverisjen Vendore.

10. "KZZ" eshte Komisioni i Zones Zgjedhore.

11. "Listat e zgjedhesve" jane dokumente zyrtare te regjistrimit te zgjedhesve per çdo zone te qendres se votimit, te parashikuara ne perputhje me kete Kod.

12. "Liste shumemerore" eshte lista e kandidateve te nje partie politike ose koalicioni, e cila miratohet nga KQZ-ja dhe sherben per zgjedhjen e kandidateve ne sistemin proporcional.

13. "Njesi zgjedhore" eshte nje zone zgjedhore, ose nje bashki ose komune ne rastin e zgjedhjeve vendore.

14. "Parti politike" eshte nje parti e regjistruar ne perputhje me ligjin nr. 8580, date 17.2.2000, "Per partite politike".

15. "Periudhe e zgjedhjeve" eshte periudha nga 30 dite perpara dates se zgjedhjeve, deri ne shpalljen perfundimtare te rezultateve te votimit.

16. "Perfaqesues i subjektit zgjedhor" eshte nje person i autorizuar nga nje kandidat ose parti politike e regjistruar, per te perfaqesuar interesat e tyre dhe per te marre pjese ne mbledhjet e komisioneve zgjedhore, ne emer dhe per llogari te kandidatit ose te partise.

17. "Qender votimi" jane mjediset e caktuara per zhvillimin e votimit, ne perputhje me kete Kod.

18. "Raundi i dyte" eshte zhvillimi i nje votimi te dyte ne nje njesi zgjedhore per shkak se asnjeri nga kandidatet nuk ka fituar shumicen e kerkuar te votave ne daten e zgjedhjeve, sipas ketij Kodi.

19. "Referendum kushtetues" eshte referendumi qe zhvillohet sipas pikes 4 ose 5 te nenit 177 te Kushtetutes.

20. "Referendum i pergjithshem" eshte referendumi qe zhvillohet sipas nenit 150, 151 dhe 152 te Kushtetutes.

21. "Referendum vendor" eshte referendumi qe zhvillohet sipas pikes 4 te nenit 108 te Kushtetutes.

22. "Regjistri Kombetar i Zgjedhesve" eshte dokumenti zyrtar ku regjistrohen te gjithe zgjedhesit e Republikes se Shqiperise.

23. "Rishikimi i listave" eshte procesi i fshirjes ose i shtimit te emrave ose i ndryshimit te te dhenave ne listat e zgjedhesve.

24. "Student" eshte çdo zgjedhes i regjistruar si student me shkeputje nga puna ne nje program arsimimi ose kualifikimi profesional ne Shqiperi per jo me pak se tre muaj, vendqendrimi i te cilit per qellimin e edukimit ose te kualifikimit eshte i ndryshem nga vendbanimi i tij.

25. "Subjekte zgjedhore" jane partite politike dhe koalicionet e regjistruara ne KQZ, si dhe kandidatet e tyre dhe kandidatet e pavarur te regjistruar ne KZZ ose KZQV.

26. "Vendbanim" eshte vendi ku zgjedhesi eshte regjistruar ne regjistrin e gjendjes civile, sipas nenit 12 te Kodit Civil.

27. "Vendqendrim" eshte vendi brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ku zgjedhesi ndodhet perkohesisht, ne kuptim te nenit 14 te Kodit Civil.

28. "Zgjedhes" eshte çdo shtetas shqiptar me te drejte vote.

29. "Zgjedhes ne Forcat e Armatosura ose ne Forcat e Rendit" jane te gjithe zgjedhesit qe sherbejne ne forcat e armatosura ose ne forcat e rendit, me vendqendrim ne nje repart ushtarak ose te rendit.

30. "Zgjedhje" jane votimet per Kuvendin, per organet perfaqesuese te qeverisjes vendore ose ne referendum.

31. "Zgjedhje te pjesshme" jane votimet per te plotesuar vendin e njerit prej 100 deputeteve te zgjedhur ne zonat njeemerore ose vendin e kryetarit te bashkise ose te komunes, si dhe per zgjedhjen e nje keshilli te ri vendor ne rast shperndarjeje.

32. "Zone e qendres se votimit" eshte nje zone gjeografike brenda territorit te nje bashkie, komune ose zone zgjedhore, e percaktuar ne perputhje me kete Kod.

33. "Zone zgjedhore" eshte nje nga 100 ndarjet gjeografike te territorit te Republikes se Shqiperise, e percaktuar ne perputhje me Kushtetuten, si dhe me rregullat e ketij Kodi, ne te cilen votohet per zgjedhjen e nje deputeti.

Neni 3

Parime te pergjithshme

1. Zgjedhjet behen me votim te lire, te fshehte dhe te drejtperdrejte, sipas rregullave te parashikuara ne kete Kod.

2. Çdo shtetas shqiptar, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike ka te drejte te zgjedhe dhe te zgjidhet ne perputhje me rregullat e parashikuara ne kete Kod.

3. Zgjedhesit ushtrojne lirisht te drejten e votes ne perputhje me rregullat e parashikuara ne kete Kod.

4. Zgjedhesit jane te barabarte ne ushtrimin e te drejtes per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur.

5. Ndarja e zonave zgjedhore behet duke perfshire ne secilen prej tyre nje numer afersisht te barabarte zgjedhesish.

6. Çdo zgjedhes ka te drejten e vetem nje vote per zgjedhjen e nje subjekti zgjedhor ose te nje alternative referendare, sipas rregullave te parashikuara ne kete Kod.

7. Subjektet zgjedhore jane te lira te bejne propagande zgjedhore ne çdo menyre te ligjshme.

8. Komisionet zgjedhore, te parashikuara ne kete Kod, i permbushin funksionet e tyre ne menyre te paanshme dhe transparente.

Neni 6

Kushtet per te qene zgjedhes

1. Çdo shtetas shqiptar qe ka mbushur moshen 18 vjeç ne daten e zgjedhjeve ose para saj dhe qe ploteson kushtet e parashikuara ne kete Kod, ka te drejte te votoje per zgjedhjet per Kuvendin, per organet e qeverisjes vendore dhe ne referendume.

2. Perjashtohen nga e drejta per te zgjedhur shtetasit e shpallur me vendim gjyqesor te formes se prere si te pa zote per te vepruar, per shkak te paaftesise mendore.

Neni 7
Vendi i votimit te zgjedhesve

Zgjedhesit votojne ne qendren e votimit ne zonen e se ciles ata jane regjistruar ne listen e zgjedhesve.

Neni 8
Zgjedhesit qe banojne jashte shtetit

Zgjedhesit qe banojne ne nje shtet tjeter kane te drejte te votojne vetem ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne vendin ku jane te regjistruar ne regjistrin e gjendjes civile, me kusht qe te jene regjistruar ne Regjistrin Kombetar te Zgjedhesve dhe te jene pajisur me karten e zgjedhesit, sipas procedurave te parashikuara ne kete Kod.

Neni 10

Kushtet per te qene kandidat

1. Kandidati per deputet, perveç kushteve per te qene zgjedhes, duhet te plotesoje edhe kushtet e pikes 3 te nenit 45 dhe nenit 69 te Kushtetutes.
2. Kandidati per organet e qeverisjes vendore, perveç kushteve te parashikuara ne nenin 45 te Kushtetutes, duhet te jete shtetas me vendbanim ne njesine perkatese te qeverisjes vendore. Kandidati per organet e qeverisjes vendore nuk mund te jete deputet ne Kuvend ose kandidat per deputet.
3. Kandidatet e listave te partive, te depozituara ne komisionet e zgjedhjeve, duhet te plotesojne kushtet e parashikuara ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni.

Neni 12

Regjistrimi i partive politike

1. Çdo parti politike qe paraqet kandidate per deputete, kandidate per kryetare bashkie ose komune, ose per keshilltare ne keshillin e bashkise ose te komunes, ne perputhje me procedurat e parashikuara ne kete Kod, regjistrohet ne KQZ si subjekt zgjedhor jo me vone se 45 dite perpara dates se zgjedhjeve.
2. Per t'u regjistruar prane KQZ-se, nje parti politike duhet te paraqese:
   - **a)** vertetimin qe partia eshte regjistruar ne Gjykaten e Rrethit te Tiranes;
   - **b)** emrin, mbiemrin dhe adresen e kryetarit te partise, i cili eshte personi i autorizuar per te paraqitur kandidatet;
   - **c)** emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresen e partise;

ç) kopjen e vules se partise;

d) emrin dhe adresen e financierit te partise;

dh) emrin dhe adresen e personit pergjegjes per komunikimin me KQZ-ne.

Neni 71

Kriteret per caktimin e kufijve te zonave

Komisioni i cakton kufijte e zonave zgjedhore sipas procedurave te meposhtme:

1. Merr nga KQZ-ja numrin e pergjithshem te zgjedhesve, si dhe numrin e zgjedhesve ne çdo njesi zgjedhore dhe zone qendre votimi ekzistuese. Keto te dhena nxirren nga Regjistri Kombetar i Zgjedhesve ashtu si rezultojne ne daten 1 gusht te vitit perkates.

2. Merr nga KQZ-ja dhe burime te tjera kompetente hartat e zonave zgjedhore, te bashkive dhe komunave dhe te zonave te qendrave te votimit ekzistuese, si dhe harta te tjera qe i çmon te nevojshme.

3. Percakton numrin mesatar te zgjedhesve per zone, duke pjesetuar numrin e pergjithshem te zgjedhesve te regjistruar ne Regjistrin Kombetar te Zgjedhesve me numrin e zonave zgjedhore njeemerore.

4. Percakton diferencen ne perqindje mes numrit mesatar te zgjedhesve dhe numrit te zgjedhesve te çdo zone.

5. Rishikon kufijte e te gjitha zonave ne menyre qe diferenca mes numrit te zgjedhesve ne çdo zone dhe numrit mesatar te jete, per aq sa eshte e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 per qind te numrit mesatar.

6. Kur numri i zgjedhesve ne nje bashki eshte brenda intervalit plus ose minus 5 per qind te numrit mesatar, ajo bashki duhet te perbeje nje zone zgjedhore.

7. Per aq sa eshte e mundur, komuna duhet te perfshihet teresisht brenda nje zone zgjedhore, dhe bashkia me numer zgjedhesish me te vogel se ai qe parashikohet ne piken 6 te ketij neni nuk duhet te ndahet ne me shume se dy zona zgjedhore.

8. Perveç rregullit te parashikuar ne piken 5 te ketij neni, Komisioni merr parasysh edhe kriteret e meposhtme per caktimin e kufijve te zonave zgjedhore:

a) Lidhjet tradicionale dhe interesat e perbashket te bashkesive vendore.

b) Kufijte dhe barrierat natyrore.

c) Linjat e transportit dhe te komunikimit.

ç) Kufijte e qarqeve.

9. Zonat zgjedhore duhet te jene kompakte dhe nuk mund te ndahen ne pjese te shkeputura nga njera-tjetra.

L I G J
Nr.8410, date 30.9.1998

PER RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Neni 4

Parimet Themelore te zhvillimit te veprimtarise Radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive eshte e lire.
Veprimtaria radiotelevizive respekton paanshmerisht te drejten per informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jeten private te njeriut, si dhe te drejtat e lirite themelore te tij. Ne kete veprimtari respektohen ne menyre te veçante te drejtat, interesat dhe kerkesat morale e ligjore per mbrojtjen e te miturve. Veprimtaria radiotelevizive nuk lejohet te cenoje rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombetar.

Neni 5

Pavaresia editoriale sigurohet me ligj.
Punesimi, ngritja ne detyre, si dhe te drejtat dhe detyrat e punonjesve te radiove dhe televizioneve publike dhe private nuk percaktohen nga seksi, origjina, pikepamjet politike, besimi fetar apo anetaresia ne sindikata.

Neni 20

Dispozita te Pergjitheshme per Licensimin

Licencat jane dy llojesh: kombetare dhe lokale.

Per transmetime televizive tokesore jepen dy licenca private kombetare.

Per transmetime radio me modulim ne frekuence jepen kater licenca private kombetare.

Licencat per transmetim televiziv ose radio ne shkalle kombetare u jepen shoqerive anonime qe themelohen me seli ne territorin e Republikes se Shqiperise

me synim ekskluziv veprimtarine radiotelevizive. Aksionet qe perfaqesojne kapitalin ne nje shoqeri, mbajtese te nje licence per transmetim televiziv ose radio, jane nominative.

Asnje person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet te kete me shume se 40 per qind te kapitalit te pergjithshem te shoqerise.

Mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te asamblese se shoqerise anonime me objekt te vetem veprimtarine per transmetime televizive ose radio, jane te vlefshme kur ne to marrin pjese jo me pak se dy te tretat e mbajtesve te aksioneve.

Nje person fizik ose juridik, qe ka aksione ne nje shoqeri televizive ose radio kombetare, nuk lejohet te kete, drejtperdrejt ose terthorazi, aksione ne nje shoqeri te dyte televizive ose radio kombetare, si dhe nuk i lejohet te marre licence per transmetim televiziv ose radioje lokale.

Licencat per transmetim televiziv ose radio lokale me modulim ne frekuence u jepen personave juridike e fizike dhe organizatave jofitimprurese te regjistruara ne territorin e Republikes se Shqiperise. Te njejtit subjekt nuk i jepet licence per me shume se dy zona transmetimi lokal. Licenca per transmetim lokal ne zonat urbane me mbi 200.000 banore nuk u jepet personave fizike.

I njejti subjekt qe zoteron nje licence per transmetim televiziv lokal mund te marre vetem nje licence te dyte per transmetim radioje lokale.

I njejti subjekt qe zoteron nje licence per radio lokale mund te marre vetem nje licence te dyte per transmetim televiziv lokal.

Mbajtesi i licences per transmetim televiziv ose radio kombetare duhet te realizoje mbulimin e mbi 70 per qind te territorit te vendit. Brenda 6 vjetesh ky mbulim duhet te perfshije jo me pak se 90 per qind te territorit dhe jo me pak se 90 per qind te popullsise se Shqiperise.

Mbajtesi i licences per transmetim televiziv ose radio lokale duhet te realizoje mbulimin e zones se caktuar ne licence sipas parametrave teknike te percaktuar nga KKRT-ja.

Me termin “transmetim televiziv ose radio lokale”, sipas ketij ligji nenkuptohet mbulimi me sinjal televiziv ose radio nga operatoret televizive ose radio te licencuar, si te tille, i territorit te komunave, bashkive, deri ne hapesiren administrative te dy prefekturave, kur ato formojne nje entitet gjeografik dhe qe ofrojne burime te mjaftueshme financiare per prodhim dhe transmetim programesh televizive ose radio.

I ndalohet huazimi i emrit, ne çdo lloj menyre, çdo subjekti fizik ose juridik, vendas ose te huaj, qe kandidohet per marrjen e nje licence per veprimtari radio ose televizive.

Neni 21

Porcedurat e Dhenies se Licenses

Licenca jepet nga Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit, i cili organizon per kete qellim konkurrim kandidaturash per kerkesat e depozituara. Kandidaturat qe fitojne shpallen publikisht.

Radiotelevizioni publik Shqiptar nuk ka nevoje per licence.

Neni 22

Vlefshmeria e Licenses

Licenca e transmetimit eshte e patjetersueshme dhe vlen vetem per subjektin te cilit i eshte dhene. Ne rast se mbajtesi i licences hyn ne marredhenie juridike civile, objekt i te cilave eshte edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atehere per cedimin ose kalimin e te drejtave qe burojne nga licenca kerkohet miratimi i Keshillit Kombetar te Radios dhe Televizionit. Subjektit qe ka fituar keto te drejta, miratimi i jepet ne formen e nje licence te re me te njejten permbajtje. Kur Keshilli nuk e miraton kalimin per shkaqe te parashikuara ne kete ligj, i ofron frekuencat qe i perkasin kesaj licence per nje konkurrim te ri kandidaturash.

Neni 23

Kerkesa per License

Kerkesa per marrjen e licences se transmetimit radioteleviziv permban:

1. emertimin, vendndodhjen, formen ligjore te subjektit qe ben kerkesen bashke me emrin dhe firmen e personit qe ka te drejte ta perfaqesoje ate;
2. dokumentet qe vertetojne te dhena zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar te personit juridik apo fizik qe ben kerkesen;
3. emertimin e programit dhe te stacionit transmetues;
4. objektin dhe karakteristikat e pergjithshme te sherbimit, te dhena per kohezgjatjen e programeve dhe territorin qe do te mbuloje, si dhe projektin teknik te instalimit dhe shfrytezimit te aparaturave;

5. deklaraten e aplikuesit se do te zbatoje ligjin nr.7564, date 19.5.1992 "Per te drejten e autorit" , legjislacionin plotesues ne fuqi, si dhe marreveshje dhe kontrate me shoqerite e autorit;

6. listen e administratoreve, parashikimet per shpenzimet dhe te ardhurat, origjinen dhe shumen e financimeve te parashikuara per kohezgjatjen per te cilen kerkohet licenca;

7. listen emerore te anetareve te Bordit Drejtues dhe curriculum vitae te tyre. Numri minimal i anetareve te Bordit per çdo subjekt te licencuar percaktohet ne rregulloren e KKRT-se;

8. permbajtjen e programeve qe do te transmetohen dhe strukturen programore te propozuar per transmetim, te cilat te shprehin qarte pluralizmin ne teresine e tyre dhe paanesine e informacionit;

9. raportin e kohes se transmetimit qe do te zene emisionet e prodhuara vete dhe atyre te prodhuara ne vend ne perpjesetim me emisionet e tjera.

Neni 24

Vendimi per Dhenien e Licenses

Vendimi per dhenien ose mosdhenien e licencave jepet brenda 90 diteve pas afatit te dorezimit te kerkesave.

Per kerkesen qe miratohet, ne vendim shenohen permbajtja dhe sasia e programeve ne perputhje me kete ligj, kushtet teknike te transmetimit, afati dhe tarifat vjetore qe i caktohen te licencuarit.

Vendimi per dhenien e licences botohet ne Fletoren Zyrtare ne

numrin me te afert te saj.

I licencuari regjistrohet ne organet tatimore.

Neni 25

Afati i Licenses

Licensa per veprimtari radiotelevizive kombetare jepet per nje kohe deri ne 6 vjet per transmetimet ne radio dhe 8 vjet ne televizion, duke filluar qe nga dita e botimit te vendimit per dhenien e licences ne Fletoren Zyrtare.

Licenca per veprimtari radiotelevizive lokale jepet per nje kohe deri ne 3 vjet per transmetime radiofonike dhe 5 vjet per transmetime televizive.

Kerkesa per rinovimin e licences behet 90 dite perpara afatit te perfundimit te saj. Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit vendos per rinovimin ose per

shpalljen e konkurrimit te kandidaturave te reja, nese operatori i licencuar nuk ka qene i rregullt ne zbatimin e ketij ligji.

Neni 26

Mosdhenia e Licenses

Licenca nuk u jepet:

1. personave te cileve me vendim te formes se prere te gjykates u eshte hequr zotesia per te vepruar;
2. partive dhe organizatave politike, komuniteteve dhe shoqatave fetare, autoriteteve te pushtetit lokal, si dhe çdo autoriteti tjeter shteteror;
3. enteve publike me karakter ekonomik, bankave dhe institucioneve te tjera te kreditit.

Neni 27

Licensa per Radio dhe Televizion

Te njejtit subjekt mund t'i jepet licence per transmetim per radio dhe televizion lokal ne te njejtin territor.

Neni 28

Kushtet Financiare per Dhenien e Licenses

KKRT- ja verifikon nese kapitali financiar i deklaruar dhe i nenshkruar i pergjigjet projektit teknik dhe programor te parashtruar ne kerkesen per licence.

Neni 29

Kushti per Permbajtjen e Programeve

Per marrjen e licences me shtrirje lokale duhet qe te pakten 15 per qind e programeve javore te permbajne informacion dhe programe qe lidhen me realitetin lokal, por qe nuk kane karakter tregtar.

Neni 34

Heqja e Licenses

Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit ka te drejte te heqe licencen e transmetimit kur:

1. eshte fituar sipas te dhenave te rreme te paraqitura ne kerkese;
2. nuk plotesohen kushtet per te cilat eshte dhene licenca;
3. cenohen rende detyrimet e caktuara ne kete ligj dhe detyrime te tjera ligjore, qe lidhen me transmetimin e programeve, ne perputhje me nenin 137 te ketij ligji;
4. nuk ka filluar transmetim pas hyrjes ne fuqi te vendimit per dhenie licence per nje periudhe kohe:

a) - 180 dite ne transmetimet e radios lokale;
   - 270 dite ne transmetimet e televizionit lokal;

b) - 1 vit ne transmetimet e radios kombetare;
   - 1 vit e gjysme ne transmetimet e televizionit kombetar;

5. pas fillimit te transmetimit, gjate nje viti kalendarik, nuk transmetohet 30 dite, pa llogaritur nderprerjet per arsye teknike qe nuk varen nga mbajtesi i licences;
6. te mbajtesi i licences kane ndodhur ndryshime qe e bejne te pamundur respektimin e kushteve te vendosura ne licence;
7. prona e mbajtesit te licences ka dale ne ankand per shitje.

Kur hiqet licenca e transmetimit, mbajtesi i saj eshte i detyruar ta ktheje ate pa kerkuar demshperblim nga Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit.

Neni 35

Program Radioteleviziv

Programe radiotelevizive quhen teresia e emisioneve qe transmetohen nga nje stacion i caktuar. Radioja dhe televizioni publik transmetojne emisione me karakter informativ, edukativ, kulturor, artistik e argetues.

Ne programet radiotelevizive nuk lejohet censura.

Programet radiotelevizive respektojne kufizimet e parashikuara me ligj, ato te nenit 10 te Konventes Europiane "Per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut" dhe te kreut "Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut" te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise.

Neni 36

Programet radiotelevizive publike dhe private respektojne dinjitetin vetjak dhe te drejtat themelore te njeriut, paanshmerine, plotesine dhe pluralizmin e informacionit, te drejtat e femijeve dhe te adoleshenteve, rendin publik dhe

sigurine kombetare, gjuhen dhe kulturen shqiptare, te drejtat kushtetuese e njerezore te shtetasve, te pakicave kombetare ne perputhje me konventat nderkombetare te nenshkruara nga Republika e Shqiperise, diversitetin fetar shqiptar.

Neni 37

Perdorimi i gjuhes shqipe eshte i detyruar per te gjitha programet, perveç veprave muzikore me tekst ne gjuhe te huaj, emisioneve per mesimin e gjuheve te huaja, emisioneve drejtuar posaçerisht pakicave kombetare dhe programeve te subjekteve radiotelevizive lokale te licencuara per transmetim ne gjuhen e minoriteteve.

Filmat ne version origjinal ne kanalet kombetare transmetohen te shoqeruar me subtitrimin dhe dublimin ne gjuhen shqipe. Per radiot dhe televizionet lokale ky detyrim fillon te zbatohet nje vit pas licencimit.

Radioja dhe televizioni publik dhe privat pasqyrojne ne veprimtarine e tyre nje kulture gjuhesore ne pajtim me normen e vendosur te gjuhes letrare kombetare.

Perjashtohen nga ky detyrim subjektet radiotelevizive te licencuara ndryshe.

Neni 38

Programet e Ndaluara me Ligj

Ne radio dhe televizion nuk lejohet te jepen programe qe nxisin dhunen, urrejtjen kombetare, fetare e raciale, veprime antikushtetuese, ndarjen territoriale, diskriminimin per shkak te bindjeve politike dhe perkatesise fetare.

Nuk lejohet gjithashtu:

1. transmetimi i informacioneve te cilat perbejne sekret shteteror sipas ligjit dhe qe i sjellin dem sigurise kombetare;
2. transmetimi i informacioneve qe cenojne jeten private te shtetasve;
3. transmetimi i mesazheve te shifruara kunder interesave themelore te shtetit;
4. prodhimi e transmetimi i programeve pornografike.

Neni 68

Programi i RTSH-se ne transmetimet e studiove qendrore dhe atyre rajonale siguron :

- shumellojshmeri informacioni politik, social, kulturor dhe argetues nga vendi dhe bota;
- dhenien e informacionit nga i gjithe territori i Republikes se Shqiperise;
- dhenien e informacionit per pakicat kombetare;

- dhenien e intormacionit per publikun jashte vendit.

Neni 88

Keshilli Drejtues i RTSH-se perbehet nga 15 anetare, te cilet zgjidhen nga Kuvendi Popullor.

Kandidaturat propozohen nga Komisioni i Perhershem per Mjetet e Informimit Publik.

Komisioni i paraqet Kuvendit Popullor listen me dyfishin e kandidateve, sipas perfaqesimit te meposhtem te partive, institucioneve dhe organizatave joqeveritare:

1) 6 anetare zgjidhen ndermjet 12 kandidaturave te propozuara nga forcat politike, sipas perfaqesimit te tyre ne Kuvendin Popullor.

2) Nga 1 anetar ndermjet 2 kandidaturave te propozuara drejtpersedrejti nga:
- Universitetet e Tiranes;
- Akadmia e Shkencave;
- shoqatat e shkrimtareve dhe artisteve;
- Forumi drejtues i OJQ-ve;
- shoqatat e gazetareve;
- perfaqesues te sindikatave;
- perfaqesues te OJQ-ve te rinise;
- perfaqesues te OJQ-ve te grave;
- perfaqesues nga pakica kombetare.

L I G J
Nr.7952, date 21.6.1995

PER SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Neni 3

Shtetasit e Republikes se Shqiperise gezojne te drejta te barabarta per t'u arsimuar ne te gjitha nivelet e arsimimit qe percakton ky ligj, pavaresisht nga gjendja sociale, kombesia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shendetesore dhe niveli ekonomik.

Neni 4

Arsimi ne Republiken e Shqiperise realizohet ne institucione arsimore publike dhe private, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji.

Neni 6

Mesimet ne institucionet arsimore publike te Republikes se Shqiperise zhvillohen ne gjuhen shqipe, me perjashtim te rasteve qe parashikon ndryshe ky ligj.

Neni 7

7.1. Arsimi parauniversitar publik ka karakter laik.

7.2. Ne institucionet arsimore publike ndalohet indoktrinimi ideologjik e fetar.

Neni 10

10.1 Personave qe u perkasin pakicave kombetare u krijohen mundesi te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen amtare, te mesojne historine dhe kulturen e tyre brenda kuadrit te planeve dhe programeve mesimore.

10.2 Per te mundesuar nje pjesemarrje aktive dhe te barabarte ne jeten ekonomike, shoqerore, politike e kulturore te Republikes se Shqiperise, shteti krijon kushte qe personat e pakicave te moshes shkollore te mesojne gjuhen shqipe, historine dhe kulturen shqiptare.

10.3 Planet e programet mesimore, si dhe raportet e perdorimit te gjuhes amtare dhe asaj zyrtare ne procesin mesimor, percaktohen me akte te veçanta te Ministrise se Arsimit dhe e Shkences.

10.4 Arsimi, per personat e pakicave, realizohet ne njesi shkollimi dhe institucione arsimore te caktuara, hapja dhe funksionimi i te cilave behet sipas procedurave te percaktuara nga Keshilli i Ministrave.

Neni 44

44.1 Hapja e institucioneve arsimore private laike, ne te cilat mesimi zhvillohet ne gjuhen shqipe, behet vetem me leje te dhene nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences. Per rastet e institucioneve arsimore private, ku mesimet zhvillohen edhe ne gjuhe te huaj ose kur zhvillohen edhe lende fetare, kjo leje jepet nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe te Shkences.

Ministria e Aresimit dhe e Shkences propozon institucionin arsimor publik te arsimit profesional, i cili do te privatizohet. Miratimi behet nga Keshilli i

Ministrave me vendim te veçante. Menyrat dhe fazat e procesit te privatizimit percaktohen nga Ministria e Ekonomise Publike dhe e Privatizimit dhe nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences.

44.2 Leja jepet kur planet, programet mesimore dhe kushtet e realizimit te tyre nuk bien ne kundershtim me interesat kombetare me legjislacionin shqiptar, me rendin publik, normat morale dhe higjienen, si dhe kur sigurohen kushtet materiale te domosdoshme se bashku me personelin e nevojshem mesimor.

44.3 Gjuha dhe letersia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqiperise zhvillohen detyrimisht ne shqip.

44.4 Kriteret dhe procedurat per dhenien e lejes per shkollat private laike, ne te cilat mesimi behet ne gjuhen shqipe, rregullohen me akte nenligjore te Ministrise se Arsimit dhe e Shkences. Per shkollat e tjera private, ne te cilat zhvillohen edhe lende fetare ose ne te cilat mesimi behet edhe ne gjuhe te huaj, keto kritere ose procedura caktohen me akte nenligjore te Keshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe e Shkences. Leja per hapjen e institucioneve arsimore private nuk mund te jepet me pare se 3 muaj dhe jo me vone se 1 vit nga koha e depozitimit te kerkeses.

44.5 Kur provohen shkelje te dispozitave te ketij ligji, leja e dhene per institucionet arsimore private laike, ne te cilat mesimi behet ne gjuhen shqipe, hiqet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences. Per institucionet e tjera arsimore private kjo leje hiqet nga Keshilli i Ministrave.

44.6 Shkollat private, te cilave u eshte hequr leja, mund te bejne kerkese per ta rifituar ate per vitin e ardhshem shkollor.

44/a.1. Krahas institucioneve arsimore private te niveleve te arsimit parauniversitar, lejohen hapja dhe funksionimi i institucioneve arsimore, private, plotesuese. Quhen te tilla ato institucione arsimore e njesi shkollimi qe funksionojne jashte strukturave te institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet ne drejtim te arsimimit e te edukimit ne lende e specialitete te veçanta, brenda ose jashte planeve mesimore, te miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences.

44/a.2. Leja per funksionimin e institucioneve arsimore, private, plotesuese jepet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences jo me pare se dy muaj nga data e depozitimit te kerkeses.

44.a.3. Kriteret per hapjen dhe funksinimin e tyre percaktohen me akte nenligjore te Ministrise se Arsimit dhe te Shkences.

V E N D I M

Nr.396, date 22.8.1994

PER ARSIMIN 8-VJEÇAR NE GJUHEN AMTARE TE PERSONAVE TE PAKICAVE

Nisur nga orientimi themelor politik i Republikes se Shqiperise per te mbrojtur e respektuar te drejtat e njeriut dhe lirite themelore te individit, perfshire edhe ate te personave qe u perkasin pakicave.

Duke synuar te konkretizojne ne sferen arsimore politiken shteterore per te krijuar kushtet e duhura per shprehjen, ruajtjen e zhvillimin e identitetit kulturor e gjuhesor te personave qe iu perkasin pakicave si dhe nevojen e integrimit te tyre ne shoqerine shqiptare,

Bazuar ne ligjin "Per te drejtat dhe lirite themelore te njeriut", miratuar nga Kuvendi Popullor me 31 mars 1993, neni 26 i te cilit parashikon: "Personat qe u perkasin pakicave... kane te drejte te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare..."

Duke pasur parasysh dhe parimet e standardet e parashikuara ne Karten Europiane mbi Gjuhet Rajonale apo te Pakicave, miratuar nga Keshilli i Europes ne Strasburg me 5 nentor 1992, si dhe dokumentet e tjera nderkombetare ne kete fushe.

Me propozimin e Ministrise se Arsimit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personat qe u perkasin pakicave kane te drejte te mesojne dhe, ose te mesohen ne gjuhen e tyre amtare ne njesi shkollimi dhe institucione arsimore shteterore te caktura.
2. Arsimi ne gjuhen amtare i pakicave zhvillohet ne menyre shumeformeshe ne perputhje me parimet themelore te edukimit te pergjithshem ne Republiken e Shqiperise dhe mbi bazen e planeve dhe programeve mesimore te shkollave shteterore te vendit te percaktuar nga Ministria e Arsimit.
3. Per t'u mundesuar nje pjesemarrje te barabarte dhe aktive ne gjithe jeten ekonomike, shoqerore, politike e kulturore te Republikes se Shqiperise, te rinjte qe u perkasin pakicave duhet te dine gjuhen shqipe dhe per kete qellim shteti krijon kushtet e nevojshme.

4. Njesite e shkollimit ne gjuhen e pakicave, ashtu si gjithe shkollat e tjera shteterore funksionojne nen mbikqyrjen dhe kontrollin e Ministrise se Arsimit.

5. Ne njesite e shkollimit ekzistues ku mesohet dhe gjuha amtare e pakicave, nxenesit e ketyre pakicave kane te drejte te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare.

Plani dhe programet mesimore, si dhe raportet e perdorimit te gjuhes amtare dhe asaj zyrtare ne procesin mesimor te ketyre njesive percaktohen me akte te veçanta te Ministrise se Arsimit. Leximi dhe gjuha amtare e nxenesve te pakicave, si dhe leximi dhe gjuha shqipe zhvillohen si lende te veçanta. Ne kuadrin e programit shkollor, nxenesve te pakicave ne keto njesi u krijohen mundesi per te studiuar historine, traditat dhe kulturen e tyre.

6. Ne qendrat e banimit (qytetet dhe fshatrat), ku jetojne dhe personat qe u perkasin pakicave, ne rastet kur ka nje numer te mjaftueshem nxenesish te pakicave qe i pergjigjet kritereve te pergjithshme per funksionimin e njesive te shkollimit, ata kane te drejte qe ne kuadrin e sistemit shteteror te arsimit te detyrueshem, te mesojne ne menyre fakultative gjuhen e tyre amtare. Menyra konkrete e organizimit te mesimit ne keto njesi rregullohet me akte te veçanta te Ministrise se Arsimit.

Çelja apo mbyllja e klasave te mesimit fakultativ ne shkollat ku gjuha amtare mesohet ne menyre fakultative nga nxenesit e pakices behet me vendim te Prefektit, pasi te merret miratimi i ministrit te Arsimit.

Per çeljen e tyre paraqitet tek drejtori i drejtorise arsimore te rrethit perkates nje kerkese e nenshkruar nga prinderit ose kujdestaret e femijeve qe do te regjistrohen ne perputhje me te drejtat e tyre si individe dhe qytetare.

Kerkesa, qe duhet te permbaje listen emerore te femijeve sipas regjistrimeve ne zyren e gjendjes civile, dorezohet nga nje perfaqesues i prinderve tek drejtori i drejtorise arsimore te rrethit te pakten 6 muaj para fillimit te vitit shkollor te pritshem. Pasi ben verifikimet dhe vleresimet lidhur me plotesimin e kritereve te pergjithshme per funksionimin e njesive te shkollimit, drejtori i drejtorise arsimore ia paraqet kerkesen Prefektit shoqeruar me mendimin e tij. Me marrjen e vendimit, Prefekti udhehiqet nga kriteret e percaktuara ne aktet ligjore, duke pasur parasysh perberjen dhe rrethanat konkrete te popullsise ne qendren perkatese te banimit (qytetit a fshatit), veçanerisht nevojen per te siguruar ne vijimesi kontigjentet e duhura te nxenesve. Vendimi i Prefektit i behet i njohur perfaqesuesit te prinderve apo kujdestareve te interesuar te pakten nje muaj para fillimit te vitit te ri shkollor. Kur ky vendim eshte pozitiv, ai duhet te miratohet me shkrim paraprakisht nga ministri i Arsimit.

Te njejtat kritere jane te vlefshme edhe ne rastin kur autoritetet e lartpermendura shqyrtojne e vendosin per mbylljen e nje njesie te shkollimit.

Ne rrethana te veçanta, kur numri i femijeve apo i nxenesve te pakicave eshte me i vogel se ai i kritereve te pergjithshme, funksionimi i njesive te shkollimit ku mesohet dhe gjuha amtare e pakicave behet me vendim te veçante te ministrit te Arsimit.

Per vitin shkollor 1994-1995 mesimi fakultativ i gjuhes amtare te filloje me procedure te pershpejtuar.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

ALEKSANDER MEKSI

V E N D I M

Nr. 502, date 5.8.1996

P E R

NJE SHTESE NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 396, DATE 22.8.1994 "PER ARSIMIN 8 VJECAR NE GJUHEN AMTARE TE PERSONAVE TE PAKICAVE"

Mbeshtetur ne nenin 10.4 te Ligjit Nr. 7952, date 21.6.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.396, date 22.8.1994 "Per arsimin 8-vjecar ne gjuhen amtare te personave te pakicave", pas pikes 5 shtohet pika 5/1 me kete permbajtje:

"Mbi bazen e kerkesave te prinderve ose kujdestareve te femijeve te pakices greke ne qytetet Sarande, Delvine dhe Gjirokaster, te funksionojne njesi shkollimi, ku nxenesit te mesojne edhe ne gjuhen amtare. Funksionimi i tyre te filloje me klasat e para ne vitin shkollor 1996-1997 prane shkollave tetevjecare, ku mesimi zhvillohet ne gjuhen shqipe, duke respektuar kriterin qe numri i nxenesve per klase te mos jete nen 20.

Kerkesat e prinderve ose kujdestareve te femijeve te pakices greke me vendbanim ne qytetin perkates, qe deshirojne te mesojne ne gjuhen amtare, paraqiten nga nje perfaqesues i tyre ne drejtorine arsimore te rrethit deri ne daten 5 shtator.

Kerkesat permban listen emerore te femijeve te pakices greke, sipas regjistrit te gjendjes civile, moshen e tyre, si dhe nenshkrimin e prindit ose te kujdestarit.

Pasi ben verifikimet e duhura, drejtori i drejtorise arsimore te rrethit dergon ne Ministrine e Arsimit dhe Sporteve liste-kerkesen, se bashku me mendimin e tij".

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

ALEKSANDER MEKSI

V E N D I M

Nr. 548, date 26.8.1996

P E R

VAZHDIMIN E MESIMIT TE GJUHES GREKE NE DISA SHKOLLA TE MESME

Ne zbatim te ligjit nr.7952, date 21.6.1995 "Per Sistemin Arsimor Parauniversitar", me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Per mesimin e gjuhes greke nga nxenesit e minoritetit ne shkollat e mesme Derviçan, Bularat te rrethit te Gjirokastres, ne shkollen e mesme Livadhja te rrethit te Sarandes dhe ne shkollen e mesme Aliko te rrethit te Delvines, mesimi i gjuhes greke te shtrihet ne klasat e para dhe te dyta me nga 2 (dy) ore ne jave.

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

ALEKSANDER MEKSI

L I G J

Nr.7895, date 27.1.1995

KODI PENAL I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PJESA E POSACME

Neni 73

Genocidi

Zbatimi i nje plani te paramenduar qe synon shkaterrimin teresisht apo pjeserisht te nje grupi nacional, etnik, racial apo fetar i drejtuar kunder anetareve te grupit dhe i shoqeruar me veprat qe vijojne, si:

vrasje me dashje te anetareve te grupit, demtime te renda fizike dhe psikike, vendosja ne kushte jetese te renda qe shkaktojne shkaterrimin fizik, zbatimi i masave qe synojne pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshem i femijeve te nje grupi ne nje grup tjeter,denohet me burgim jo me pak se dhjete vjet ose me burgim te perjetshem a me vdekje.

Neni 74

Krime kunder njerezimit

Vrasjet, shfarosjet, kthimi ne skllever, internimet dhe debimet, si dhe çdo lloj torture apo dhune tjeter çnjerezore te kryera per motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare, denohen jo me pak se pesembedhjete vjet ose me burgim te perjetshem a me vdekje.

(*Shenojme se me nenshkrimin e Protokollit 6, denimi me vdekje eshte hequr nga Shqiperia.)*

Neni 131

Pengimi i veprimtarive te organizatave fetare

Ndalimi i veprimtarive te organizatave fetare, si dhe krijimi i pengesave per ushtrimin e lire te veprimtarive te tyre, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne tre vjet.

Neni 132

Shkaterrimi ose demtimi i objekteve te kultit

Shkaterrimi ose demtimi me dashje i objekteve te kultit, kur ka shkaktuar humbjen plotesisht ose pjeserisht te vlerave te tyre, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne tre vjet.

Neni 133

Pengimi i ceremonive fetare

Ndalimi ose krijimi i pengesave qe u behen personave per te marre pjese ne ceremonite fetare, si dhe per te shprehur lirisht bindjet fetare, perben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne nje vit.

Neni 253

Shkelja e barazise se shtetasve

Kryerja per shkak te detyres e ne ushtrim te saj, nga ana e punonjesit ne funksion shteteror apo ne sherbim publik, te dallimeve mbi baze origjine, seksi, gjendjes shendetesore, bindjeve fetare, politike, te veprimtarise sindikale ose per shkak te perkatesise ne nje etni, komb race apo fe te caktuar, qe konsiston ne krijimin e privilegjeve te padrejta ose ne refuzimin e nje te drejte ose perfitimi qe buron nga ligji, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne 5 vjet.

Neni 265

Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve ndermjet kombesive, racave dhe feve

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe pergatitja, perhapja ose ruajtja me qellim perhapjeje e shkrimeve me permbajtje te tille, denohen me gjobe ose me burgim gjer ne dhjete vjet.

Neni 266

Thirrja per urrejtje nacionale

Venia ne rrezik e paqes publike duke bere thirrje per urrejtje kunder pjeseve te popullsise, duke i fyer ose shpifur per to, duke kerkuar perdorimin e dhunes ose te veprimeve arbitrare kunder tyre, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne 5 vjet.

L I G J
Nr.8116, date 29.3.1996

KODI I PROCEDURES CIVILE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 27

Perdorimi i gjuhes shqipe ne gjykim

Ne te gjitha fazat e gjykimit perdoret gjuha shqipe .

Personat qe nuk dine shqip, perdorin gjuhen e tyre. Ata marrin dijeni per provat dhe per gjithe zhvillimin e gjykimit me ane te perkthyesit.

FORMAT E AKTIT

Neni 115

Forma dhe gjuha e hartimit te aktit

Aktet proceduriale, per te cilat ligji nuk kerkon forma te caktuara mund te kryhen ne formen me te dobishme per arritjen e qellimit te tyre.

Neni 116

Aktet procedurale hartohen ne ghuhen shqipe.

Gjykata per pyetjen e personave qe nuk dine gjuhen shqipe ose per perkthimin e dokumenteve te shkruara ne gjuhe te huaj therret perkthyesin.

Perkthyesi qe nuk paraqitet per shkaqe te perligjura, thirret me detyrim. Ai mban pergjegjesi penale dhe civile sikurse eksperti.

Neni 137

Akti njoftohet ne gjuhen e vendit nga i cili eshte derguar, por marresi qe nuk e njeh gjuhen ne te cilen eshte perpiluar akti, ka te drejte te refuzoje njoftimin dhe te kerkoje qe ai te perkthehet ne gjuhen shqipe ose ne nje gjuhe tjeter te njohur prej pritesit per llogari te pales kerkuese dhe me shenzimet e saj.

L I G J

Nr. 8239, date 3.9.1997

PER NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7756, DATE 11.10.1993

"PER SHTYPIN"

Ne mbeshtetje te neneve 16 e 23 te Ligjit Nr.7491, date 29.4.1991 "Per Dispozitat Kryesore Kushtetuese", me propozimin e nje grupi deputetesh, Kuvendi Popullor i Republikes se Shqiperise

V E N D O S I:

Ne ligjin nr.7756, date 11.10.1993 "Per shtypin" behen ndryshimet e meposhtme:

Neni 1

Ne nenin 1 mbetet vetem paragrafi i pare me kete permbajtje:

- "Shtypi eshte i lire. Liria e shtypit mbrohet me ligj".

- Tre paragrafet e tjere te nenit 1 si dhe te gjitha nenet, duke filluar nga neni 2 dhe deri ne nenin e fundit (24) shfuqizohen.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere.

BIBLIOGRAFI

e akteve ligjore dhe nenligjore te perdorura per hartimin e Raportit te Pare te Republikes se Shqiperise per zbatimin e Konvente Kuader te Keshillit te Evropes per Mbrojtjen e Minoriteteve.

- Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, (perzgjedhje nenesh).
- Kodi Penal i Republikes se Shqiperise, (perzgjedhje nenesh).
- Kodi i Procedures Penale te Republikes se Shqiperise, (perzgjedhje nenesh).
- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise, (perzgjedhje nenesh).
- Kodi i Procedures Civile te Republikes se Shqiperise, (perzgjedhje nenesh).
- Ligji "Per te drejten e tubimeve", Nr.8485, date 12.05.1999, (perzgjedhje nenesh).
- Ligji "Per Partite Politike", Nr.8580, date.17.2.2000, (perzgjedhje nenesh).
- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr. 341, date 7.07.2000, (tekst i plote).
- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr. 248, date 28.05.1999, (tekst i plote).
- Ligji "Per Shtypin", Nr.7756, date 11.10.1993, ndryshuar me Ligjin Nr.8239, date 3.9.1997, (tekst i plote).
- Ligji "Mbi Radiotelevizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise", (perzgjedhje nenesh).
- Ligji "Mbi te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim" Nr. 8328 date 16.04.1998, (perzgjedhje nenesh).
- "Rregullorja e Burgjeve te Republikes se Shqiperise", Vendim i Keshillit te Ministrave, Nr. 96, date 09.03.2000, (perzgjedhje nenesh).
- Ligji "Per Sistemin e Arsimit Parauniversitar" Nr. 7952, date 21.06.1995, (perzgjedhje nenesh).
- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr. 396, date 22.08.1994, "Per arsimin 8-vjeçar ne gjuhen amtare te personave te pakicave", (tekst i plote).
- Udhezimi i Ministrise se Arsimit Nr.14, date 3.9.1994.
- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr 404, date 1.7.1998, (tekst i plote).
- Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise, Ligji Nr 8609, date 8.05.2000, (perzgjedhje nenesh).

- Traktati i Miqesise, Bashkepunimit, Fqinjesise se mire dhe Sigurimit midis Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Greqise, (perzgjedhje nenesh).
- Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise.
- Kodi i Punes, (perzgjedhje nenesh).
- Statuti i Organizates “Omonia”.